



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 96

Tiranë – E mërkurë, 4 qershor 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 293, datë 28.5.2025	Për organizimin, funksionimin dhe fushën e veprimit të policimit vullnetar..... 14111
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 294, datë 28.5.2025	Për miratimin e paraqitjes, formës dhe specifikimeve teknike të gradave, simboleve, uniformave dhe shenjave dalluese, dokumentit dhe medaljonit zyrtar të identitetit të Policisë së Shtetit..... 14165
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 17, datë 26.5.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 21, datë 15.10.2021, “Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara”, i ndryshuar..... 14203
Udhëzim i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 2, datë 21.5.2025	Për miratimin e formatit që do të përdoret për raportimin vjetor për vlerësimin e cilësisë së ajrit në mjedis..... 14204
Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 189, datë 21.5.2025	Për miratimin e formatit të raportit trevjeçar për zbatimin e ligjit nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar, dhe informacionin që duhet të përmbajë ky raport..... 14210
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 366/13, datë 28.5.2025	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruktion i segmentit të parë të linjës 110 kV Ballsh–Memaliaj”..... 14213
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë nr. 2796-800, datë 26.9.2024	Për shpalljen të zhdukur të shtetasit Sokol Prendi..... 14216
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Elvis Troqe..... 14216

**VENDIM****Nr. 293, datë 28.5.2025****PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN
DHE FUSHËN E VEPRIMIT
TË POLICIMIT VULLNETAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 128, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Ky vendim ka për objekt rregullimin e organizimit, funksionimit dhe fushës së veprimit të shërbimit të policimit vullnetar, në mbështetje të strukturave të Policisë së Shtetit.

2. Qëllimi i këtij vendimi është përmirësimi i sigurisë publike, forcimi i kapaciteteve të strukturave të Policisë së Shtetit dhe inkurajimi i angazhimit qytetar, duke promovuar bashkëpunimin ndërmjet policisë dhe komunitetit për rritjen e besimit dhe parandalimin e veprimtarive të kundërligjshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Policimi vullnetar është një shërbim publik, i cili përfshin veprimtaritë e kryera nga policët vullnetarë në mbështetje të strukturave vendore të Policisë së Shtetit.

4. Polici vullnetar është çdo person që plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara dhe që është pranuar në shërbimin e policimit vullnetar.

5. Kohëzgjatja ditore e vullnetarizmit është periudha kohore e angazhimit të vullnetarit në shërbimin e policimit vullnetar, e cila nuk tejkalon 5 (pesë) orë në ditë dhe 25 (njëzet e pesë) orë në javë.

6. Kontrata e vullnetarizmit është dokumenti ligjor, i lidhur ndërmjet vullnetarit dhe ofruesit të shërbimit të vullnetarizmit, i cili përcakton të drejtat, detyrimet, kushtet dhe kriteret për kryerjen e aktiviteteve dhe shërbimeve vullnetare, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

**II. ORGANIZIMI, FUNKSIONIMI DHE
FUSHA E VEPRIMIT TË SHËRBIMIT TË
POLICIMIT VULLNETAR**

1. Shërbimi i policimit vullnetar funksionon në mbështetje të strukturave vendore të Policisë së Shtetit dhe bashkëpunon me to, për:

a) Sigurimin dhe garantimin e rendit publik në aktivitetet me karakter masiv, si: tubime, koncerte, festivale, aktivitete sportive dhe organizime fetare, duke kryer këto detyra:

i. ruajtjen e perimetrit të jashtëm të ambienteve ku zhvillohen aktivitetet masive;

ii. kryerjen e shërbimit së bashku me punonjësit e Policisë së Shtetit në postblloqe/pika kontrolli në zona/rrugë me trafik të kufizuar ose ku ndalohet qarkullimi i automjeteve;

iii. drejtimin dhe disiplinimin e lëvizjeve të grupeve të tifozëve/spektatorëve/pjesëmarrësve në aktivitet gjatë hyrjes;

iv. mbledhjen e informacionit me interes për Policinë e Shtetit, veçanërisht për ndeshjet sportive me nivel të lartë rivaliteti, tubime, si dhe veprimtari të tjera publike me pjesëmarrje masive, për të cilat ekzistojnë të dhëna ose dyshime të arsyeshme se mund të ndikojnë në sigurinë ose në rendin publik;

v. informimin e policisë për situata shqetësuese, apo të rrezikshme, duke ndjekur nga afër dhe duke dhënë informacion në vijimësi, deri në mbërritjen e forcave policore;

vi. këshillimin e publikut dhe shuarjen e konflikteve të lehta ndërmjet palëve, që nuk kërkojnë ndërhyrje të specializuar të policisë;

vii. ndihmën në ruajtjen dhe mbajtjen e lirë të rrugëkalimeve të emergjencës dhe drejtimin e lëvizjes së njerëzve e të automjeteve, sipas korridoreve të caktuara;

viii. angazhimin për ruajtjen e zonave të parkimit të automjeteve të policisë, ambulancave dhe zjarrfikësve pranë vendit ku zhvillohet aktiviteti;

ix. këshillimin dhe drejtimin e tifozëve/spektatorëve/pjesëmarrësve në përfundim të aktivitetit gjatë shpërndarjes, sipas korridoreve të caktuara të lëvizjes;

x. ndihmën në ruajtjen e rendit në ditët e pazareve, festivaleve dhe festave lokale, ku ka grumbullime të mëdha njerëzish.

b) Dhënien e ndihmës për menaxhimin e trafikut rrugor në qendrat urbane dhe rurale, duke kryer këto detyra:

i. menaxhimin e qarkullimit të sigurt të nxënësve dhe qytetarëve në kryqëzime dhe pranë shkollave;

ii. bashkëpunimin me policinë për menaxhimin e kalimeve rrugore apo akseve ku ka një trafik të shtuar, duke përdorur tabelën apo sinjalistikën me duar;



iii. disiplinimin e mjeteve në stacionim apo lëvizje gjatë panareve dhe ditëve të pazareve;

iv. angazhimin në fushata ndërgjegjësuere dhe aktivitete parandaluese me shkollat dhe komunitetin.

c) Rritjen e sigurisë publike pranë institucioneve arsimore, duke kryer këto detyra:

i. patrullimin përreth institucioneve arsimore në këmbë ose me mjete patrullimi, veçanërisht gjatë periudhave të trafikut të rënduar;

ii. menaxhimin e trafikut pranë shkollave dhe mbështetjen në zbatimin e rregullave të qarkullimit;

iii. monitorimin e hyrjeve dhe të daljeve të fëmijëve për të parandaluar sjellje të rrezikshme;

iv. monitorimin e aktiviteteve të dyshimta në perimetrin e sigurisë së institucioneve arsimore, duke parandaluar hyrjen e paautorizuar në ambientet e tyre;

v. mbështetjen e aktiviteteve jashtë orarit mësimor, si ato sportive, artistike, kulturore, për të garantuar sigurinë e nxënësve/studentëve dhe pjesëmarrësve dhe garantimin e sigurisë;

vi. bashkëpunimin me oficerët e sigurisë pranë shkollave/institucioneve arsimore për reagimin në kohë ndaj situatave emergjente të konflikteve, dhunës apo incidenteve;

vii. mbështetjen në organizimin e simulimeve për reagimin ndaj situatave të emergjencave civile, ku kërkohet izolimi ose evakuimi dhe dhënia e ndihmës së parë;

viii. mbështetjen e punonjësve të policisë në rritjen e ndërgjegjësimin dhe informimin të nxënësve, studentëve, prindërve dhe personelit pedagogjik për çështjet e sigurisë;

ix. informimin e përgjegjësit të strukturës policore për probleme të ndryshme të sigurisë në shkolla, si shkeljet e ligjit apo identifikimi i personave, të cilët merren me shitjen e drogave të lehta, alkoolit dhe duhanit.

c) Kontrollin e territorit, mbështetjen e patrullimit policor për parandalimin e krimit dhe ndërhyrjen ndaj shkeljeve të ligjit, duke kryer këto detyra:

i. mbështetjen dhe angazhimin e të rinjve të marginalizuar në aktivitete parandaluese;

ii. patrullimin gjatë orëve të natës, veçanërisht në fundjavë në zonat e frekuentuara nga të rinjtë, si baret, klubet e natës, lokalet me muzikë *live* dhe vende të ngjashme, me qëllim këshillimin dhe ndërgjegjësimin për shmangien e konsumit të tepërt

të alkoolit, përfshirjes në konflikte dhe drejtimit të automjeteve nën ndikimin e tij;

iii. patrullimin pranë vendparkimeve, stacioneve të urbanëve, terminaleve të autobusëve, si dhe në zona të identifikuara me risk të shtuar për sigurinë publike, me qëllim parandalimin e vjedhjeve, sjelljeve të pahijshme, apo të dhunshme dhe rritjen e ndjenjës së sigurisë në mjedisin urban e në transportin publik;

iv. patrullimin me punonjësit e Policisë së Shtetit pranë lagjeve me popullsi heterogjene dhe të marginalizuar;

v. bashkëpunimin me organizata komunitare për çështjet e rendit dhe qetësisë publike, duke trajtuar problematika të komunitetit dhe duke mbledhur informacion në kuadër të parandalimit.

d) Mbështetjen e policisë në mbrojtjen e pronës, mjedisit dhe zonave të mbrojtura, duke kryer këto detyra:

i. informimin e autoriteteve për dëmtime të qëllimshme ndaj mjedisit, si prerja e paligjshme e pyjeve, ndotja e ujërave dhe djegia e mbeturinave, si dhe çdo dëmtim tjetër i qëllimshëm i mjedisit, që bie ndesh me legjislacionin përkatës;

ii. patrullimin me punonjësit e Policisë së Shtetit në rezervate natyrore dhe monumente të kulturës për parandalimin e aktiviteteve të paligjshme;

iii. sensibilizimin e komunitetit për ruajtjen e mjedisit.

dh) Mbështetjen e Policisë Kufitare, duke kryer këto detyra:

i. informimin e individëve që kalojnë në pikat e kalimit kufitar për procedurat dhe rregullat apo asistimin e tyre në plotësimin e formularëve të ndryshëm;

ii. mbështetjen në identifikimin e migrantëve të paligjshëm, asistimin dhe informimin e tyre për procedurat dhe legjislacionin në fuqi për trajtimin e tyre dhe azilkërkimin;

iii. ndihmën në shërbimet e emergjencës, menaxhimin e flukseve të larta migratore në rastet e krizave humanitare dhe garantimin e kushteve të sigurisë të vendstrehimeve të tyre të përkohshme;

iv. monitorimin e zonave në distancë në afërsi të kufirit dhe veçanërisht pikat e hyrjes në kufi, të ndryshme nga pikat e zakonshme të kalimit kufitar, duke identifikuar dhe duke parandaluar krimet ndërkufitare.



e) Menaxhimin e situatave të emergjencave civile, fatkeqësive natyrore, si dhe operacioneve të kërkim-shpëtimit me karakter masiv, duke kryer këto detyra:

i. përmbushjen e detyrave, të përcaktuara nga përgjegjësi i strukturës policore në lidhje me krijimin dhe administrimin e perimetrave të sigurisë në situatat e emergjencave civile, duke garantuar rendin dhe sigurinë publike;

ii. mbikëqyrjen dhe sigurimin e zonave të grumbullimit të qytetarëve dhe shpërndarjes së ndihmave humanitare, duke synuar shmangien e çdo rreziku që mund të cenojë sigurinë apo mirëfunksionimin e proceseve të ndihmës;

iii. mbledhjen e informacionit dhe udhëzimin e publikut, në raste emergjencash civile në lidhje me masat mbrojtëse dhe procedurat përkatëse;

iv. angazhimin në operacionet e kërkim-shpëtimit;

v. informimin e publikut për personat e zhdukur, si dhe mbledhjen e shkëmbimi të të dhënave me komunitetin për të ndihmuar në gjetjen e tyre;

vi. bashkëpunimin me Policinë e Shtetit dhe organet e tjera kompetente në sigurimin dhe mbrojtjen e vendngjarjeve të ndryshme, ruajtjen e provave, identifikimin dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve, si dhe çdo veprim tjetër që ndihmon hetimet dhe garanton integritetin e procesit hetimor;

vii. dhënien e ndihmës së parë në përputhje me protokollet e emergjencave mjekësore.

ë) Mbështetjen e ekipeve për gjetjen e personave të humbur ose në rrezik jete në zonat malore dhe bregdetare.

2. Polici vullnetar e kryen veprimtarinë e tij nën mbikëqyrjen e punonjësit të policisë, të caktuar nga drejtuesi i strukturës vendore të Policisë së Shtetit.

3. Kryerja e shërbimit të policimit vullnetar është i papajtueshëm me funksionet e gjyqtarit, prokurorit, përmbaruesit gjyqësor, drejtuesit në strukturat politike, punonjësit në institucionet e sigurisë kombëtare apo publike, të Shërbimit të Provës, të Policisë së Burgjeve dhe të Gardës së Republikës.

III. PROCEDURA E APLIKIMIT DHE E PËRZGJEDHJES SË SHKETASVE NË SHËRBIMIN E POLICIMIT VULLNETAR

1. Aplikantët që kërkojnë pranimin në shërbimin e policimit vullnetar duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Formularin e aplikimit, sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) Fotokopjen e kartës së identitetit;

c) Dokumentin zyrtar, që vërteton përfundimin e arsimit të mesëm;

ç) Raportin mjekoligjor, që vërteton aftësinë e aplikantit për të ushtruar detyrën e policit vullnetar.

2. Procedura e aplikimit fillon pas shpalljes së konkurrimit publik. Aplikanti plotëson formularin e aplikimit dhe e dorëzon së bashku me dokumentacionin e kërkuar në pikën 1, të këtij kreu, në Drejtorinë Vendore të Policisë, ku ka vendbanimin e përhershëm.

3. Pas aplikimit të shtetasit, struktura policore vendore siguron me ndërveprim dokumentet e mëposhtme:

a) Certifikatën e gjendjes gjyqësore;

b) Certifikatën familjare.

4. Struktura përgjegjëse policore shqyrton dokumentacionin e dorëzuar dhe verifikon nëse aplikanti plotëson kriteret e përgjithshme të përcaktuara në pikën 1, të kreut IV, të këtij vendimi.

5. Kjo strukturë administron dokumentacionin e paraqitur nga aplikantët brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga përfundimi i afatit të aplikimeve dhe kryen veprimet e mëposhtme:

a) Kur dokumentacioni shoqërues është në përputhje me pikën 1, të kreut IV, të këtij vendimi, e njofton aplikantin për vazhdimin e procedurës së verifikimit të kriterëve;

b) Kur dokumentacioni shoqërues nuk është në përputhje me pikën 1, të kreut IV, të këtij vendimi, e njofton kandidatin për plotësimin e të metave brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit.

6. Mosplotësimi i të metave brenda afatit 5-ditor përbën shkak për mospranimin e aplikimit.

7. Struktura përgjegjëse, brenda 7 (shtatë) ditëve nga përfundimi i afatit për plotësimin e të metave, verifikon dokumentacionin përkatës.

8. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kriterëve, nuk është i plotë e i saktë ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, struktura përgjegjëse mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga çdo organ publik apo persona të tjerë juridikë, vendës ose të huaj.

9. Në përfundim të procesit të verifikimit, sipas pikës 8, të këtij kreu, struktura përgjegjëse njofton me shkrim secilin aplikant për pranimin ose refuzimin e tij/saj.

10. Aplikantëve, të cilëve u është refuzuar aplikimi, kanë të drejtë të paraqesin ankim pranë



drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, duke bashkëlidhur argumentet dhe dokumentacionin që provon përmbushjen e kriterëve.

11. Pas përfundimit të afateve të ankimit dhe shqyrtimit të tyre, bëhet përfshirja e aplikantëve në listën e të kualifikuarve, nëse provohet përmbushja e kriterëve ose skualifikimi përfundimtar i tyre, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e paraqitjes së ankimit. Më pas hartohet lista përfundimtare e aplikantëve të kualifikuar dhe caktohet numri kodik i identifikimit për secilin aplikant nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore. Lista dërgohet zyrtarisht në Akademinë e Sigurisë.

12. Në rastet kur aplikanti ka shërbyer më parë në strukturat e Policisë së Shtetit dhe ka ndërprerë marrëdhënien e punës, por trajtohet me pagesë kalimtare deri në plotësimin e moshës për pension të plotë pleqërie, sipas legjislacionit në fuqi, ai/ajo paraqet dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Formularin e aplikimit;
- b) Fotokopjen e kartës së identitetit;
- c) Dokumentin zyrtar, që vërteton kohën e shërbimit dhe strukturën ku ka qenë i/e punësuar në Policinë e Shtetit.

13. Aplikanti nuk i nënshtrohet trajnimit në Akademinë e Sigurisë, nëse ndodhet para rastit të përcaktuar në pikën 12 të këtij kreu.

14. Aplikanti, që kualifikohet për të vazhduar procesin e trajnimit në Akademinë e Sigurisë, u nënshtrohet fazave të konkurrimit, sipas rendit të mëposhtëm:

- a) Testimit të aftësive fizike;
- b) Intervistës;
- c) Kontrollit shëndetësor dhe psikologjik;
- ç) Verifikimit të besueshmërisë.

15. Aplikanti, që kualifikohet për të vazhduar procesin e trajnimit të detyrueshëm në Akademinë e Sigurisë, i nënshtrohet procesit të verifikimit të besueshmërisë, që konsiderohet si verifikimi përfundimtar i aplikantit, nëpërmjet strukturave të hetimit të krimit, për të verifikuar faktin që aplikanti, apo pjesëtarë të familjes së tij, nuk janë të implikuar në veprimtari kriminale.

IV. KRITERET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN E POLICIMIT VULLNETAR

1. Kriteret e përgjithshme të pranimit të shtetasit në shërbimin e policimit vullnetar janë, si më poshtë vijon:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- c) Të mos jetë i përjashtuar nga Policia e Shtetit, strukturat e tjera të sigurisë kombëtare apo të jetë larguar nga shërbimi civil me masë disiplinore;
- ç) Të ketë përfunduar arsimin e mesëm;
- d) Të mos jetë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- dh) Të jetë i moshës nga 18 (tetëmbëdhjetë) deri në 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjeç, në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën.

2. Kriteret e veçanta të pranimit të shtetasit në shërbimin e policimit vullnetar janë, si më poshtë vijon:

- a) Të ketë përfunduar trajnimin e detyrueshëm me vlerësim pozitiv, si dhe të jetë i certifikuar nga Akademia e Sigurisë;
- b) Të jetë i pajisur me vërtetimin e besueshmërisë.

V. KONTRATA E VULLNETARIZMIT

1. Kontrata e vullnetarizmit lidhet në formë të shkruar ndërmjet policit vullnetar dhe drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë.

2. Kontrata e vullnetarizmit rregullon marrëdhënien ndërmjet palëve, duke përcaktuar të drejtat, detyrimet përkatëse, kohëzgjatjen dhe kushtet e ushtrimit të shërbimit, kriteret për përfshirje, si dhe shkaqet, procedurat dhe pasojat juridike, që lidhen me pezullimin, përfundimin apo zgjidhjen e saj.

3. Forma dhe përmbajtja e kontratës tip përcaktohen në shtojcën 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

VI. TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E POLICIT VULLNETAR

1. Polici vullnetar ka të drejtë:

- a) Të njihet paraprakisht me të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e shërbimit të policimit vullnetar, si dhe me sanksionet në rast të mospërmbushjes së detyrimeve, që rrjedhin nga ky vendim dhe nga kontrata individuale e vullnetarizmit;
- b) Të rimbursohet për shpenzimet e kryera gjatë orarit të shërbimit apo jashtë qendrës së banimit, kur ndihmon strukturat policore;
- c) Të pajiset me veshje, shenja dalluese dhe pajisje të tjera ndihmëse, në përputhje me natyrën e aktiviteteve të vullnetarizmit dhe shërbimeve që do të kryejë, sipas shtojcës 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi;



ç) Të kërkojë, në mënyrë individuale, vlerësim ose vërtetim pjesëmarrjeje për kontributin e dhënë në punën vullnetare nga struktura vendore e policisë;

d) Të ndjekë trajnime falas në Akademinë e Sigurisë, sipas shtojcës 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

dh) Të njihet dhe të konsultohet me proceset vendimmarrëse që lidhen me strategjitë, politikat, identifikimin e nevojave të komunitetit dhe çështje të tjera që ndikojnë në ushtrimin e detyrës së tij;

e) Të përfitojë këshillim ligjor për çështje që lidhen me etikën, integritetin, korrupsionin, konfliktin e interesit, konfidencialitetin dhe aspekte të tjera përkatëse, si dhe të marrë udhëzime praktike dhe shpjegime konkrete për legjislacionin në fuqi, sjelljen e pritshme nga policët vullnetarë, përfshirë edhe procedurat për trajtimin e shkeljeve disiplinore dhe ankimmimet e tyre;

ë) T'i njihet kontributi në komunitet përmes vlerësimeve publike ose medaljeve.

2. Polici vullnetar gjatë shërbimit dhe/ose jashtë tij ka përgjegjësi:

a) Të ndjekë programin e trajnimit të detyrueshëm;

b) Të marrë pjesë në trajnime që organizon Policia e Shtetit për të përmirësuar cilësinë e punës e të shërbimit;

c) Të kryejë aktivitetin e vullnetarizmit i paarmatosur, në përputhje me rregullat, udhëzimet dhe kërkesat e etikës së punonjësve të Policisë së Shtetit;

ç) Të ruajë sekretin profesional, si dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, me të cilat njihet gjatë angazhimit, si polic vullnetar;

d) Të zbatojë detyrat dhe udhëzimet e dhëna nga mbikëqyrësi, në nivel vendor të Policisë së Shtetit, përveç rasteve kur:

i. janë në kundërshtim me ligjin;

ii. paraqesin rrezik për jetën dhe shëndetin e vullnetarit, si dhe atë të njerëzve të tjerë;

iii. konsiderohen moralisht të papranueshme nga ana e vullnetarit;

iv. janë në kundërshtim me kontratën e vullnetarizmit.

dh) të njoftojë përfaqësuesin apo mbikëqyrësin e Policisë së Shtetit, në lidhje me pasojat kur ndodhet përpara zbatimit të urdhrave, që mund t'i shkaktojnë dëme shëndetit ose jetës së tij.

3. Gjatë shërbimit, polici vullnetar mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga veprimet e tij, të kryera në kundërshtim me ligjin.

4. Polici vullnetar kryen shërbime publike në mbështetje të punonjësve të Policisë së Shtetit.

5. Nëse gjatë shërbimit të tij, polici vullnetar përballet me kundërshtime nga shtetas të ndryshëm, ai e përcjell problemin për zgjidhje të mëtijshme te punonjësit e Policisë së Shtetit.

VII. PËRGJEGJËSITË E PËRFTITUESIT TË SHËRBIMIT

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është përgjegjëse për përzgjedhjen, trajnimin, organizimin, drejtimin dhe trajtimin e policit vullnetar, duke u siguruar që:

a) Të trajtojë paraprakisht kandidatët që do të certifikohen si të aftë për të kryer detyra në ndihmë të Policisë së Shtetit;

b) Të sigurojë kushte normale pune për policin vullnetar gjatë kryerjes së detyrave, në bazë të kontratës së shërbimit vullnetar;

c) Të ruajë dhe të sigurojë konfidencialitetin e të dhënave dhe mbrojtjen e privatësisë së policit vullnetar;

ç) Të rimburojë shpenzimet e kryera nga polici vullnetar gjatë punës vullnetare, sipas akteve nënligjore në fuqi, njëjloj si punonjësit e policisë, kur ai vepron jashtë qendrës së banimit;

d) Të lëshojë vërtetim me shkrim për kohën e punës që ai ka shërbyer si polic vullnetar;

dh) Të ofrojë bazën e nevojshme materiale për kryerjen e aktivitetit të vullnetarizmit;

e) Të sigurojë plotësimin e kushteve të nevojshme për respektimin e të drejtave të policit vullnetar;

ë) Të trajtojë policin vullnetar, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 16, të ligjit nr. 82/2024, "Për Policinë e Shtetit";

f) Të pajisë policin vullnetar me dokument identifikimi, lidhur me statusin që ai gëzon, sipas modelit të përcaktuar në shtojcat 2 dhe 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Çdo vit, në bazë të nevojave dhe të propozimeve të drejtorive vendore të policisë, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit përcakton numrin e policëve vullnetarë.



VIII. PLANIFIKIMI DHE PROCEDURAT E NDJEKURA PËR KRYERJEN E SHËRBIMIT TË POLICIMIT VULLNETAR

1. Planifikimi i shërbimit të policimit vullnetar përfshin:

a) Marrjen e masave për hartimin e planeve përkatëse për shërbimin e policëve vullnetarë nga drejtuesit e strukturave vendore të Policisë së Shtetit. Këto plane planifikohen në librat e shërbimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Procedurën Standarde të Operimit (PSO) “Planifikimi i shërbimeve të policisë” dhe PSO-së, “Planifikimi i shërbimeve të policisë për aktivitetet masive”;

b) Hapjen dhe administrimin e librit të planifikimit të shërbimit të policimit vullnetar, i cili është i posaçëm dhe i sekretuar, si dhe përmban të njëjtat rubrika, si libri i shërbimit të patrullës së përgjithshme dhe administrohet në përputhje me kërkesat e PSO-së “Planifikimi i shërbimeve të policisë”;

c) Marrjen e masave për mbikëqyrjen dhe mbështetjen e policëve vullnetarë gjatë kryerjes së detyrave të tyre nga drejtuesit e strukturave vendore të Policisë së Shtetit, ku policët vullnetarë kryejnë shërbimin.

2. Procedura përpara marrjes së shërbimit nga ana e policit vullnetar përfshin:

a) Kryerjen e përgatitjes vetjake, e cila konsiston në:

i. rregullimin e uniformës së shërbimit, kujdesin personal, pajisjen me bllok shënimesh dhe mjete për të shkruar;

ii. marrjen e dokumentit të identifikimit dhe të medaljonit zyrtar;

iii. kontrollin e shenjave të montuara në uniformë dhe pajisjet e shërbimit.

b) paraqitjen në orar dhe në vendin e caktuar për marrjen e shërbimit.

3. Personeli i shërbimit vullnetar instruktohet lidhur me masat që duhet të merren në fillim gjatë kryerjes dhe në përfundim të shërbimit.

4. Instrukta zhi i personelit zhvillohet nga specialisti i rendit publik (me gradë “Nënkomisar”), apo nga shefi i seksionit të rendit dhe përfshin:

a) Kontrollin e prezencës së personelit në bazë të planifikimit të shërbimit;

b) Gjendjen e tyre shëndetësore dhe fizike;

c) Pamjen e jashtme dhe uniformën e punonjësve;

ç) Dokumentin e identifikimit;

d) Pajisjet e shërbimit;

dh) Pajisjen me formularë të raportit të shërbimit/aktivitetit;

e) Masat për korrigjimin e të metave dhe mangësive të konstatuara për çështjet e mësipërme.

5. Instrukta zhi gjithashtu përfshin:

a) Ndarjen e sektorëve/vendit të shërbimit dhe të mënyrën së kryerjes së tij;

b) Përcaktimin e detyrave kryesore për secilin polic vullnetar dhe fushat në të cilat duhet të përqendrojnë vëmendjen kryesore gjatë kryerjes së shërbimit;

c) Zbatimin e procedurave standarde gjatë gjithë kohës së shërbimit, sipas trajnimit të kryer, mënyrën e veprimit dhe detyrat që duhet të kryejë në rast të ndodhjes së ndonjë incidenti, apo ngjarjeje kriminale/aksidentale në vendin e shërbimit;

ç) Mënyrën e informimit, bashkëveprimit dhe koordinimit me shërbimet e tjera policore, si dhe mënyrën e komunikimit e të raportimit gjatë shërbimit.

6. Specialisti i rendit publik (me gradë “Nënkomisar”), apo shefi i seksionit të rendit, në përfundim të shërbimit të policimit vullnetar, pret personelin dhe vijon me kryerjen e procedurave, të cilat përfshijnë:

a) Kërkimin e raportimit verbal për aktivitetin e kryer nga policët vullnetarë gjatë shërbimit;

b) Evidentimin e raporteve verbale për shërbimin e kryer nga policët vullnetarë, përfshirë ngjarjet dhe problematikat e hasura;

c) Plotësimin e një informacioni përmbledhës për të gjithë problematikat e evidentuara nga policët vullnetarë dhe informimin e eprorit për to;

ç) Nëse nga raportimi i mësipërm, evidentohen problematika me interes të veçantë për strukturën policore, kërkohet nga polici vullnetar plotësimi i një raporti të hollësishëm, i cili administrohet në regjistrin përkatës.

IX. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr. 641, datë 2.10.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për organizimin, funksionimin dhe fushën e veprimit të policimit vullnetar”, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



Shtojca 1

Formulari i aplikimit për pranim në shërbimin e policimit vullnetar**Udhëzime:**

- Plotësoni çdo kuti në këtë aplikim në mënyrë të plotë. Një aplikimi jo i plotë, skualifikon aplikantin nga procesi i përzgjedhjes.
- Përgjigjuni çdo pyetje duke thënë vetëm të vërtetën. Përgjigjet e rreme skualifikojnë automatikisht aplikantin.
- Plotësoni informacionin e kërkuar me stilolaps. Në rast se shkrimi nuk është i kuptueshëm, ju mund të skualifikoheni.
- Formulari i aplikimit i plotësuar, duhet të dorëzohet bashkë me dokumentacionin përkatës pranë Drejtorisë Vendore të Policisë (DVP), ku aplikanti ka vendbanimin e përhershëm.

1. INFORMACIONI PERSONAL

Mbiemri:			Emri:		Atësia:	
Adresa:			Nr. i telefonit:		Adresa e e-mailit:	
Datëlindja:	Mosha:	Vendlindja:	Gjatësia:	Pesha:	Gjinia: Mashkull ☐ Femër ☐	
Data/muaji/viti						
Gjendja Civile: i/e martuar ☐ i/e ve ☐ beqar/e ☐ i/e divorcuar ☐			Jeni shtetas shqiptar? Po ☐ Jo ☐		Keni leje drejtimi të kategorisë “B” apo më sipër? Po ☐ Nr. i Lejes së Drejtimit: _____ Jo ☐	

2. INFORMACIONI FAMILJAR

Lidhja me aplikantin	Mbiemri	Emri	Atësia	Datëlindja	Adresa & Nr. i telefonit
Babai					
Nëna					
Vëlla/Motër					
Vëlla/Motër					
Vëlla/Motër					
Bashkëshort/e					



Fëmijë					
Fëmijë					
Fëmijë					

3. Keni ndonjë të afërm të punësuar aktualisht në Policinë e Shtetit?

Po ☐	Nëse “Po”, plotësoni informacionin e mëposhtëm				
Jo ☐					
Mbiemri	Emri	Atësia	Lidhja që ka me ju	Grada & Pozicioni në Policinë e Shtetit	Vendi ku kryen detyrën

4. **Vendbanimi (Rendisni adresat në të cilat keni banuar gjatë 10 viteve të fundit. Filloni me adresën ku jetoni aktualisht. Përfshini edhe adresa ku keni jetuar përkohësisht.)**

Nga: Deri:	Adresa:	
Muaji/viti Aktualisht		
Nga: Deri:	Adresa:	Arsyeja e largimit:
Muaji/viti Muaji/viti		
Nga: Deri:	Adresa:	Arsyeja e largimit:
Muaji/viti Muaji/viti		
Nga: Deri:	Adresa:	Arsyeja e largimit:
Muaji/viti Muaji/viti		

5. ARSIMI

Shkollat që keni ndjekur (Rendisni shkollën e fundit që keni ndjekur, të parën)

Emri i shkollës	Fshati/Qyteti	Periudha kohore	Diplomuar
			Po ☐ Jo ☐
			Po ☐ Jo ☐
			Po ☐ Jo ☐

6. EKSPERIENCAT E PUNËS (Rendisni punën tuaj të fundit, të parën)

Datat	Emri i punëdhënësit	Adresa & Nr. i telefonit	Pozicioni	Arsyeja e largimit
Nga: Deri: Data/muaji/viti Data/muaji/viti				
Nga: Deri: Data/muaji/viti Data/muaji/viti				
Nga: Deri: Data/muaji/viti Data/muaji/viti				
Nga: Deri: Data/muaji/viti Data/muaji/viti				
Nga: Deri: Data/muaji/viti Data/muaji/viti				

7. SHËRBIMI USHTARAK

E keni kryer shërbimin ushtarak?

Po ☐	Nëse “Po”, plotësoni informacionin e mëposhtëm
Jo ☐	



Forca në të cilën keni shërbyer	Periudha kohore	Numri i repartit	Vendndodhja
Tokësore ☐	Nga: Deri:		
Garda ☐			
Detare ☐			
Ajrore ☐	Data/muaji/viti		

8. Keni shërbyer ndonjëherë në forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë?

Po ☐	Nëse “Po”, plotësoni informacionin e mëposhtëm		
Jo ☐			
Forca në të cilën keni shërbyer	Periudha kohore	Numri i repartit	Vendndodhja
Tokësore ☐	Nga: Deri:		
Garda ☐			
Detare ☐			
Ajrore ☐	Data/muaji/viti		

9. VEPRIMTARIA KRIMINALE

Jeni dënuar ndonjëherë për ndonjë krim?

Po ☐	Nëse “Po”, plotësoni informacionin e mëposhtëm		
Jo ☐			
Lloji i krimit	Data e dënimit	Vendndodhja	Gjykata

Jeni arrestuar ndonjëherë për një krim, pavarësisht nëse nuk jeni dënuar?

Po ☐	Nëse “Po”, plotësoni informacionin e mëposhtëm	
Jo ☐		
Lloji i krimit	Data e arrestimit	Vendndodhja

Jeni dënuar ndonjëherë kur keni qenë i mitur?

Po ☐	Nëse “Po”, plotësoni informacionin e mëposhtëm	
Jo ☐		
Lloji i krimit	Data e dënimit	Vendndodhja

A jeni aktualisht nën ndjekje penale apo prisni që kjo të fillojë së shpejti?

Po ☐	Nëse “Po”, plotësoni informacionin e mëposhtëm
Jo ☐	



Lloji i krimit	Data e arrestimit	Vendndodhja

10. REFERENCA

Rendisni emrat e tre personave që ju kanë njohur gjatë 5 viteve të fundit. (Mos përfshini emrat e personave që janë përmendur më sipër në këtë formular aplikimi).

Mbiemri	Emri	Atësia	Adresa & Nr. i telefonit

Emër, atësi, mbiemër, firmë e aplikantit

Data _____



Shtojca 2

**DOKUMENTI I IDENTIFIKIMIT TË
POLICIT VULLNETAR****Dokumenti i identifikimit të policit vullnetar:**

1. Departamenti për Sigurinë Publike, mbi bazën e kërkesës së drejtorive vendore të policisë, pajis me dokument identifikimi, çdo polic vullnetar, në momentin që ka lidhur kontratën e vullnetarizmit.

2. Drejtoria e Rendit Publik në Departamentin për Sigurinë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë së Menaxhimit Informacionit merr masa për prodhimin e dokumentit të identifikimit për policin vullnetar.

3. Drejtoria e Rendit Publik në Departamenti për Sigurinë Publike mban “Regjistrin e evidentimit të dokumentit të identifikimit për policët vullnetar”, ku evidentohet pajisja me dokument identifikimi të të gjithë të punonjësve të policisë vullnetare në shkallë vendi.

4. Kërkesa e drejtorive vendore të policisë për pajisjen me dokumentin e identifikues si polic vullnetar, duhet të përmbajë këto të dhëna:

a) Emër, atësi, mbiemër, ditëlindje, nr. identifikues sipas regjistrit ku është evidentuar, nr. personal të identifikimit të letërnjoftimit dhe CD me fotografi të çdo polici vullnetar, sipas listës që dërgohet.

b) Materialet e mësipërme të dërgohen me shkresë zyrtare së bashku me CD-në e fotografive pranë Drejtorisë së Rendit Publik në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Shtetit. Drejtoria e Rendit Publik, mbasi verifikon dokumentacionin, dërgon në Drejtorinë e Teknologjisë së Menaxhimit të Informacionit për prodhim të dokumentit të identitetit.

5. Dokumenti i identifikimit të punonjësit të policisë vullnetare, përmban:

a) Në anën e majtë, fotografinë e punonjësit të policisë vullnetare;

b) Në pjesën e mbetur në sfond vendoset shenja dalluese (logo) e Policisë Vullnetare;

c) Në pjesën e djathtë: emër, mbiemër, numri i identifikimit, DVP-ja ku është në detyrë punonjësi i Policisë Vullnetare;

ç) Në pjesën e pasme: në të gjithë sfondin në mes të saj të jetë shkruar “POLICIA VULLNETARE” dhe në sfond shenja dalluese (logo) e Policisë Vullnetare.

6. Forma e dokumentit të identifikimit për policët vullnetarë të jetë:

a) Material kartonçinë e përforcuar;

b) Ngjyrë e bardhë;

c) Përmasat 10x6 cm;

ç) Shkrimi në ngjyrë të zezë.

7. Shpërndarja e dokumenteve të identifikimit për punonjësit e policisë vullnetare të strukturave vendore bëhet nga strukturat e rendit, duke bërë më parë evidentimin në regjistrin përkatës, pjesë e kësaj lidhje.

8. Polici vullnetar e mban dokumentin e identifikimit në vend të dukshëm dhe vetëm gjatë kryerjes së detyrës ai detyrohet ta paraqesë atë sa herë i kërkohet për identifikim nga strukturat e policisë dhe organet e tjera ligjzbatuese.

9. Në rast të ndërprerjes të marrëdhënieve kontraktuale me strukturat e policisë, polici vullnetar dorëzon dokumentin e identifikimit policor pranë strukturës vendore të policisë, duke evidentuar në regjistrin përkatës.

10. Nëse një dokument i policit vullnetar deklarohet i humbur, vjedhur, apo dëmtuar, duhet të raportohet menjëherë, sipas procedurave ligjore. Në asnjë rast strukturat e vendore të policisë nuk duhet të kryejnë ripajisjen me dokument identifikimi të policit vullnetar, pa bërë më parë shpalljen e dokumentit të pavlefshëm.



FORMA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT TË IDENTIFIKIMIT TË POLICIT VULLNETAR



- Dokumenti i identifikimit të punonjësit të policisë vullnetare, përmban:
 - Në anën e majtë: fotografinë e punonjësit të policisë vullnetare;
 - Në pjesën e mbetur në sfond vendoset shenja dalluese (logo) e Policisë Vullnetare;
 - Në pjesën e djathtë: emër, mbiemër, numri i identifikimit, DVP-ja ku është në detyrë punonjësi i Policisë Vullnetare;
 - Në pjesën e pasme: NË të gjithë sfondin në mes të saj të jetë shkruar “POLICIA VULLNETARE” dhe në sfond shenja dalluese (logo) e Policisë Vullnetare.
- Forma e dokumentit të identifikimit për policët vullnetarë të jetë:
 - Material kartoninë e përforcuar;
 - Ngjyrë e bardhë;
 - Përmasat 10x6 cm;
 - Shkrimi në ngjyrë të zezë.

(Aplikimi për pajisjen me dokumentin e identifikimit të policit vullnetar)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DREJTORIA VENDORE E POLICISË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.

Lënda: Për pajisjen me dokument identifikues për polic vullnetar.

DEPARTAMENTIT PËR SIGURINË PUBLIKE
DREJTORISË SË RENDIT PUBLIK

Tiranë

Në mbështetje, të pikës __, kreut __, të vendimit nr. __, datë __.2025 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin, funksionimin dhe fushën e veprimit të Policisë Vullnetare”, si kërkojmë pajisjen me dokumente identifikues të policëve vullnetarë, si më poshtë:

Nr.	Emër, Atësi, Mbiemër	Datëlindja	Nr. Personal (NID)	Adresa	DVP
1.					
2.					
3.					
4.					

Mbyllet me nr. rendor (_____)

DREJTORI



(Regjistri i shpërndarjes së dokumentit të identifikimit të policëve vullnetarë)

N r.	Emër, Atësi, Mbiemër	Nr.	Nr. telefonit	Data e dhënies së dokumentit	Firma e marrësit	Data e kthimit të dokumentit	Emri, mbiemri i Specialis ti t të sektorit të rendit	Firma
1.								
2.								
3.								
4.								
5.								
6.								
7.								
8.								
9.								
10.								
11.								
12.								
13.								
14.								
15.								
16.								
17.								
18.								
19.								
20.								

Shtojca 3

SHENJA DALLUESE (LOGO)
“POLICIA VULLNETARE”



**Shpjegime për shenjë dalluese (logon) e Policisë Vullnetare:**

1. Shenja dalluese (logo) e Policisë Vullnetare është simbol i identitetit të këtij shërbimi.
2. Ajo përdoret vetëm nga policët vullnetarë pas nënshkrimit të kontratës dhe kur kryen një shërbim.
3. Shenja dalluese (logo) e Policisë Vullnetare, përbëhet nga mburojë e ndarë vertikalisht në dy pjesë të barabarta në ngjyrat blu dhe të kuqe që simbolizon ngjyrat kombëtare dhe të Flamurit të Policisë së Shtetit. Në qendër janë vendosur tri duar të bashkuara, simbol i paqes dhe i vullnetarizmit.
4. Në pjesën e sipërme të shenjes dalluese (logos) është shkrimi “POLICIA VULLNETARE”, shkronjat e të cilit janë me ngjyrë ari. Përreth shenjes dalluese është kompozuar një kornizë ngjyrë ari.
5. Shenja dalluese (logo) e Policisë Vullnetare lejohet të përdoret në xhaketën fluoreshente, kapelën dhe dokumentin e identifikimit të policit vullnetar.

Shtojca 4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DREJTORIA VENDORE E POLICISË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ .

**KONTRATË INDIVIDUALE VULLNETARIZMI
PËR
PUNONJËSIN E POLICIMIT VULLNETAR**

Neni 1

Baza ligjore e kontratës

Kjo kontratë lidhet në bazë Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, të nenit 128, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, dhe të VKM-së nr. _____, datë ____ . ____ . 2025, “Për organizimin, funksionimin dhe fushën e veprimit të policimit vullnetar”.

Neni 2

Palët

Kjo kontratë lidhet sot më datë ____ . ____ . ____, midis Drejtorisë Vendore të Policisë _____, përfaqësuar nga Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë, Drejtues si ofrues i shërbimit të vullnetarizmit dhe punonjësit të policimit vullnetar z./znj. me nr. id., banues në _____, si vullnetar.

Neni 3

Objekti

Kjo kontratë shërben për rregullimin e marrëdhënieve juridike midis policit vullnetar dhe strukturave vendore të Policisë së Shtetit, i cili bashkëpunon me to, për:

- a) Sigurimin dhe garantimin e rendit publik në aktivitetet me karakter masiv, si tubime, koncerte, festivale, aktivitete sportive dhe organizime fetare, duke kryer këto detyra:
 - i. ruajtja e perimetrit të jashtëm të ambienteve ku zhvillohen aktivitetet masive;
 - ii. kryerja e shërbimit së bashku me punonjësit e Policisë së Shtetit në postblloqe/pika kontrolli në zona/rrugë me trafik të kufizuar, ose ku ndalohet qarkullimi i automjeteve;



iii. drejtimi dhe disiplinimi i lëvizjeve të grupeve të tifozëve/spektatorëve/pjesëmarrësve në aktivitet, gjatë hyrjes;

iv. mbledhja e informacionit me interes për Policinë e Shtetit, veçanërisht për ndeshjet sportive me konkurrencë të fortë, tubimet etj.;

v. informimi i policisë për situata shqetësuese, apo të rrezikshme, duke ndjekur nga afër dhe duke dhënë informacion në vijimësi, deri në mbërritjen e forcave policore;

vi. këshillimi i publikut dhe shuarja e konflikteve të lehta mes palëve që nuk kërkojnë ndërhyrje të specializuar të policisë;

vii. ndihma në ruajtjen dhe mbajtjen e lirë të rrugëkalimeve të emergjencës dhe drejtimi i lëvizjes së njerëzve dhe automjeteve sipas korridoreve të caktuara;

viii. angazhimi për ruajtjen e zonave të parkimit të automjeteve të policisë, ambulancave dhe zjarrfikësve pranë vendit ku zhvillohet aktiviteti;

ix. këshillimi dhe drejtimi i tifozëve/spektatorëve/pjesëmarrësve në përfundim të aktivitetit, gjatë shpërndarjes, sipas korridoreve të caktuara të lëvizjes;

x. ndihma në ruajtjen e rendit në ditët e pazareve, festivaleve dhe festave lokale, ku ka grumbullime të mëdha njerëzish.

b) Dhënia e ndihmës për menaxhimin e trafikut rrugor në qendrat urbane dhe rurale, duke kryer këto detyra:

i. menaxhimi i qarkullimit të sigurt të nxënësve dhe qytetarëve në kryqëzime dhe pranë shkollave;

ii. bashkëpunimi me policinë për menaxhimin e kalimeve rrugore apo akseve ku ka një trafik të shtuar, duke përdorur duke përdorur tabelën apo sinjalistikën me duar;

iii. disiplinimi i mjeteve në stacionim apo lëvizje gjatë panairëve dhe ditëve të pazareve;

iv. angazhimi në fushata ndërgjegjësuese dhe aktivitete parandaluese me shkollat dhe komunitetin.

c) rritjen e sigurisë publike pranë institucioneve arsimore, duke kryer këto detyra:

i. patrullimi përreth institucioneve arsimore më këmbë ose me mjete patrullimi, veçanërisht gjatë periudhave të trafikut të rënduar;

ii. menaxhimi i trafikut pranë shkollave dhe mbështetja në zbatimin e rregullave të qarkullimit;

iii. monitorimi i hyrjeve dhe i daljeve të fëmijëve për të parandaluar sjellje të rrezikshme;

iv. monitorimi i aktiviteteve të dyshimta në perimetrit e sigurisë së institucioneve arsimore, duke parandaluar hyrjen e paautorizuar në ambientet e tyre;

v. mbështetja e aktiviteteve jashtë orarit mësimor si ato sportive, artistike, kulturore për të garantuar sigurinë e nxënësve/studentëve dhe pjesëmarrësve dhe garantimi i sigurisë;

vi. bashkëpunimi me oficerët e sigurisë pranë shkollave/institucioneve arsimore për reagimin në kohë ndaj situatave emergjente të konflikteve, dhunës apo incidenteve;

vii. mbështetja në organizimin e simulimeve për reagimin ndaj situatave të emergjencave civile, ku kërkohet izolimi ose evakuimi dhe dhënia e ndihmës së parë;

viii. mbështetja e punonjësve të policisë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit të nxënësve, studentëve, prindërve dhe personelit pedagogjik për çështjet e sigurisë;

ix. informimi i përgjegjës të strukturës policore për probleme të ndryshme të sigurisë në shkolla si shkeljet e ligjit, apo identifikimi i personave të cilët merren me shitjen e drogave të lehta, alkoolit dhe duhanit.

ç) Kontrollin e territorit, mbështetjen e patrullimit policor për parandalimin e krimit dhe ndërhyrjen ndaj shkeljeve të ligjit, duke kryer këto detyra:

i. mbështetja dhe angazhimi i të rinjve të marginalizuar në aktivitete parandaluese;

ii. patrullimi gjatë orëve të natës, veçanërisht në fundjavë, në afërsi të bareve, klubeve të natës, tavernave me muzikë live etj., duke synuar këshillimin dhe parandalimin e konsumit të tepërt të alkoolit, përfshirjes në konflikte, si dhe drejtimit të mjeteve motorike nën efektin e tij;

iii. patrullimi pranë vendparkimeve, stacioneve të urbanëve, terminaleve të autobusëve etj., për të parandaluar vjedhjet apo sjelljet antishoqërore, duke rritur ndjenjën e sigurisë tek udhëtarët dhe në transportin publik;



iv. patrullimi me punonjësit e policisë së shtetit, pranë lagjeve me popullsi heterogjene dhe të marginalizuar;

v. bashkëpunimi me organizata komunitare mbi çështjet e rendit dhe qetësisë publike, duke trajtuar problematika të komunitetit dhe mbledhur informacion në kuadër të parandalimit.

d) Mbështetjen e policisë në mbrojtjen e pronës, mjedisit dhe zonave të mbrojtura, duke kryer këto detyra:

i. informimi i autoriteteve për dëmtime të qëllimshme ndaj mjedisit, si prerja e paligjshme e pyjeve, ndotja e ujërave dhe djegia e mbeturinave etj.;

ii. patrullimi me punonjësit e policisë së shtetit në rezervate natyrore dhe monumente të kulturës për parandalimin e aktiviteteve të paligjshme;

iii. sensibilizimi i komunitetit për ruajtjen e mjedisit.

dh) Mbështetjen e policisë kufitare, duke kryer këto detyra:

i. informimi i individëve që kalojnë në pikat e kalimit kufitar mbi procedurat dhe rregullat, apo asistimin e tyre në plotësimin e formularëve të ndryshëm;

ii. mbështetje në identifikimin e migrantëve të paligjshëm, asistimin dhe informimin e tyre mbi procedurat dhe legjislacionin në fuqi për trajtimin e tyre dhe azilkërkimin;

iii. ndihma në shërbimet e emergjencës, menaxhimin e flukseve të larta migratore në rastet e krizave humanitare dhe garantimin e kushteve të sigurisë të vendstrehimeve të tyre të përkohshme;

iv. monitorimi i zonave në distancë në afërsi të kufirit dhe veçanërisht pikat e hyrjes në kufi, të ndryshme nga pikat e zakonshme të kalimit kufitar duke identifikuar dhe parandaluar krimet ndërkufitare;

e) Menaxhimin e situatave të emergjencave civile, fatkeqësive natyrore, si dhe operacioneve të kërkim-shpëtimit me karakter masiv, duke kryer këto detyra:

i. përmbushja e detyrave të përcaktuara nga përgjegjësi i strukturës policore, në lidhje krijimin dhe administrimin e perimetrave të sigurisë në situatat e emergjencave civile, duke garantuar rendin dhe sigurinë publike;

ii. mbikëqyrja dhe sigurimi i zonave të grumbullimit të qytetarëve dhe shpërndarjes së ndihmave humanitare, duke synuar shmangien e çdo rreziku që mund të cenojë sigurinë apo mirëfunksionimin e proceseve të ndihmës;

iii. mbledhja e informacionit dhe udhëzimi i publikut në raste emergjencash civile në lidhje me masat mbrojtëse dhe procedurat përkatëse;

iv. angazhimi në operacionet e kërkim-shpëtimit;

v. informimi i publikut për personat e zhdukur, si dhe mbledhja e shkëmbimi i të dhënave me komunitetin për të ndihmuar në gjetjen e tyre;

vi. bashkëpunimi me Policinë e Shtetit dhe organet e tjera kompetente, në sigurimin dhe mbrojtjen e vendngjarjeve të ndryshme, ruajtjen e provave, identifikimin dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve, si dhe çdo veprim tjetër që ndihmon hetimet dhe garanton integritetin e procesit hetimor;

vii. dhënia e ndihmës së parë në përputhje me protokollet e emergjencave mjekësore;

ë) Mbështetjen e ekipeve për gjetjen e personave të humbur ose në rrezik jete në zonat malore dhe bregdetare.

Neni 4

Qëllimi

Polici vullnetar kryen shërbimet publike të përcaktuara në nenin 3 të kësaj kontrate, pa pagesë, në mbështetje dhe nën mbikëqyrjen e punonjësve të Policisë së Shtetit në nivel vendor.

Neni 5

Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit në shërbimin vullnetar

1. Kriteret e përgjithshme të pranimit të shtetasit në shërbimin e policimit vullnetar janë, si më poshtë vijon:



- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- c) Të mos jetë i përjashtuar nga Policia e Shtetit, strukturat e tjera të sigurisë kombëtare, apo të jetë larguar nga shërbimi civil me masë disiplinore;
- ç) Të ketë përfunduar arsimin e mesëm;
- d) Të mos jetë i dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një krimi, apo kryerjen dh) Një kundërvajtjeje penale me dashje;
- e) Të jetë i moshës nga 18 deri në 65 vjeç, në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën.

2. Kriteret e veçanta të pranimit të shtetasit në shërbimin e policimit vullnetar janë, si më poshtë vijon:

- a) Të ketë përfunduar trajnimin e detyrueshëm me vlerësim pozitiv, si dhe të jetë i certifikuar nga Akademia e Sigurisë;
- b) Të jetë i pajisur me vërtetimin e besueshmërisë;

Neni 6

Papajtueshmëria e shërbimit

Kryerja e shërbimit të policimit vullnetar është i papajtueshëm me funksionet gjyqtarit, prokurorit, përmbaruesit gjyqësor, drejtuesit në strukturat politike, punonjësit në institucionet e sigurisë kombëtare apo publike, të shërbimit të provës, të policisë së burgjeve dhe të Gardës së Republikës.

Neni 7

Të drejtat e policit vullnetar

1. Polici vullnetar ka të drejtë:

- a) Të njihet paraprakisht me të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e shërbimit të policimit vullnetar, si dhe me sanksionet në rast të mospërbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim dhe nga kontrata individuale e vullnetarizmit;
- b) Të rimbursohet për shpenzimet e kryera gjatë orarit të shërbimit apo jashtë qendrës së banimit, kur ndihmon strukturat policore;
- c) Të pajiset me veshje, shenja dalluese dhe pajisje të tjera ndihmëse, në përputhje me natyrën e aktiviteteve të vullnetarizmit dhe shërbimeve që do të kryejë, sipas shtojcës 6, bashkëlidhur;
- ç) Të kërkojë, në mënyrë individuale, vlerësim ose vërtetim pjesëmarrjeje për kontributin e dhënë në punën vullnetare nga struktura vendore e policisë;
- d) Të ndjekë trajnime falas në Akademinë e Sigurisë, sipas shtojcës 5, bashkëlidhur;
- dh) Të njihet dhe të konsultohet me proceset vendimmarrëse që lidhen me strategjitë, politikat, identifikimin e nevojave të komunitetit dhe çështje të tjera që ndikojnë në ushtrimin e detyrës së tij;
- e) Të përfitojë këshillim ligjor për çështje që lidhen me etikën, integritetin, korrupsionin, konfliktin e interesit, konfidencialitetin dhe aspekte të tjera përkatëse, si dhe të marrë udhëzime praktike dhe shpjegime konkrete mbi legjislacionin në fuqi, sjelljen e pritshme nga policët vullnetarë, përfshirë edhe procedurat për trajtimin e shkeljeve disiplinore dhe ankimimet e tyre;
- ë) T'i njihet kontributi në komunitet përmes vlerësimeve publike ose medaljeve.

Neni 8

Përgjegjësitë e policit vullnetar

1. Polici vullnetar gjatë shërbimit dhe/ose jashtë tij ka përgjegjësi:

- a) Të ndjekë programin e trajnimit të detyrueshëm;
- b) Të marrë pjesë në trajnime që organizon Policia e Shtetit, për të përmirësuar cilësinë e punës e të shërbimit,



c) Të kryejë aktivitetin e vullnetarizmit i paarmatosur, në përputhje me rregullat, udhëzimet dhe kërkesat e etikës së punonjësve të Policisë së Shtetit;

ç) Të ruajë sekretin profesional, si dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, me të cilat njihet gjatë angazhimit, si polic vullnetar;

d) Të zbatojë detyrat dhe udhëzimet e dhëna nga mbikëqyrësi në nivel vendor i Policisë së Shtetit, përveç rasteve kur:

i. janë në kundërshtim me ligjin;

ii. paraqesin rrezik për jetën dhe shëndetin e vullnetarit, si dhe atë të njerëzve të tjerë;

iii. konsiderohen moralisht të pa pranueshme nga ana e vullnetarit;

iv. janë në kundërshtim me kontratën e vullnetarizmit.

dh) Të njoftojë përfaqësuesin apo mbikëqyrësin e Policisë së Shtetit, në lidhje me pasojat, kur ndodhet përpara zbatimit të urdhrave që mund t'i shkaktojnë dëme të shëndetit ose jetës së tij.

2. Gjatë shërbimit, polici vullnetar mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga veprimet e tij të kryera në kundërshtim me ligjin.

Neni 9

Përgjegjësitë e përfituesit të shërbimit

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është përgjegjëse për përzgjedhjen, trajnimin, organizimin, drejtimin dhe trajtimin e policit vullnetar, duke u siguruar që:

a) Të trajnojë paraprakisht kandidatët që do të certifikohen si të aftë për të kryer detyra në ndihmë të Policisë së Shtetit;

b) Të sigurojë kushte normale pune për policin vullnetar, gjatë kryerjes së detyrave në bazë të kontratës së shërbimit vullnetar;

c) Të ruajë dhe të sigurojë konfidencialitetin e të dhënave dhe mbrojtjen e privatësisë së policit vullnetar;

ç) Të rimbursojë shpenzimet e kryera nga polici vullnetar gjatë punës vullnetare, sipas akteve nënligjore në fuqi, njëjloj si punonjësit e policisë, kur ai vepron jashtë qendrës së banimit;

d) Të lëshojë vërtetim me shkrim për kohën e punës që ai ka shërbyer si polic vullnetar;

dh) Të ofrojë bazën e nevojshme materiale për kryerjen e aktivitetit të vullnetarizmit;

e) Të sigurojë plotësimin e kushteve të nevojshme për respektimin e të drejtave të policit vullnetar;

ë) Të trajtojë policin vullnetar sipas përcaktimeve të bëra në nenin 16 të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”.

f) Të pajisë policin vullnetar me dokument identifikimi, lidhur me statusin që ai gëzon.

Neni 10

Koha e punës

1. Kohëzgjatja e punës për policin vullnetar është jo më shumë se 5 orë pune në ditë dhe jo më shumë se 25 orë pune në javë.

2. Orët e fillimit dhe të mbarimit të punës përcaktohen në urdhrin e titullarit të strukturës policore ku shërben.

Neni 11

Efektet e kontratës

Me lidhjen e kontratës për policimin vullnetar, të drejtat që kanë lindur nga papunësia nuk humbasin.



Neni 12

Përfundimi i kontratës

1. Kontrata e policimit vullnetar përfundon në rastet si më poshtë:

- a) Mbaron periudha për të cilën është lidhur;
- b) Polici vullnetar bëhet i paafte për të kryer vullnetarizëm;
- c) Me marrëveshje ndërmjet dy palëve;
- ç) Zgjidhje të njëanshme të kontratës.

Neni 13

Zgjidhja e njëanshme

1. Polici vullnetar dhe Drejtoria Vendore e Policisë (DVP) mund të zgjidhin në çdo kohë, në mënyrë të njëanshme kontratën vullnetare, për shkaqe të justifikuara.

2. DVP-ja mund të zgjidhë kontratën përpara mbarimit të saj, kur:

- a) Nuk ka më nevojë për vullnetarizëm;
- b) Nuk siguron kushtet e nevojshme për kryerjen e vullnetarizmit;
- c) Vërteton se vullnetari nuk përmbush detyrimet e kontratës;

3. Polici vullnetar mund të zgjidhë kontratën përpara mbarimit të afatit, kur:

- a) Nuk është i aftë të përmbushë detyrimet objekt kontrate;
- b) Nuk ka më vullnet për të kryer vullnetarizëm;
- c) DVP-ja nuk përmbush detyrimet e kontratës.

3. Kur zgjidhja e kontratës sipas përcaktimit të pikës 3/b, të këtij neni sjell pasoja të rënda për vazhdimësinë e punës së DVP-së, ose sjell pasoja të rënda mbi palët e treta, polici vullnetar është i detyruar të vazhdojë marrëdhënien kontraktore deri në përfundim të afatit të saj.

4. Zgjidhja e njëanshme e kontratës në çdo rast, bëhet me shkrim. Pala e cila kërkon zgjidhjen, i dërgon njoftim me shkrim palës tjetër 10 ditë përpara datës së kërkuar për zgjidhjen e kontratës.

Neni 14

Të ndryshme

1. Mosmarrëveshjet që lindin gjatë zbatimit të kësaj kontrate, palët i zgjidhin me mirëkuptim. Në rast të kundërt i drejtohen Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, si gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

2. Palët bien dakord për ndryshime në këtë kontratë, duke njoftuar me shkrim paraprakisht njëri tjetrin për një afat 30-ditor.

3. Kontrata hyn në fuqi pas nënshkrimit nga palët dhe është me afat të caktuar (1 vit).

4. Kontrata pasi u lexua, u nënshkrua, u mbajt në dy kopje origjinale, nga të cilat një kopje për punëdhënësin dhe një kopje për punëmarrësin.

PALET NËNSHKRUESE**Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë****Polici Vullnetar**

(grada, emër, mbiemër)

(emër, atësia, mbiemër)



PROGRAMI MËSIMOR

1. Përmbajtja e planit mësimor

Plani mësimor i Programit të “Kursit mbi aftësimin e Policisë Vullnetare”, përmban:

- Temat mësimore për çdo modul e nënmodul;
- Kohëzgjatjen e tyre;
- Synimin e çdo plani mësimor;
- Objektivat e çdo plani mësimor;
- Bazën materiale dhe referencat për zhvillimin e planit mësimor.

Plani mësimor është i detyrueshëm për zbatim nga instruktorët (lektorët), pas miratimit të tij, sipas përcaktimeve konkrete.

2. Parimet e vendosjes së planeve mësimore në Program

Renditja në Program e temave (planeve) mësimore është bërë duke pasur parasysh disa parime:

- Kalimi nga temat më të thjeshta tek ato më të përbëra;
- Kalimi nga temat më të lehta tek ato më të vështira;
- Ndarja dhe integrimi i temave me karakter të formimit të përgjithshëm me ato të karakterit profesional.

3. Bashkëpunimi për zhvillimin e planeve mësimore

Për realizimin e Programit në përgjithësi dhe të zhvillimit të temave mësimore në veçanti, duhet të mbahet në vëmendje që, disa prej temave mësimore të zhvillohen nga bashkëpunimi me:

- Specialistë hetimit të krimit;
- Specialistë të policisë rrugore;
- Specialistë të rendit publik dhe policimit në komunitet;
- Specialistë të policisë shkencore;
- Specialistë të dhunës në familje;
- Psikologë, sociologë;
- Përfaqësues të Projektit PAMECA V, Projektit Suedez SCPA, apo aktorë të tjerë, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Akademia e Sigurisë.

Përmbledhja e Programit Mësimor

Titulli i kursit	Kursi mbi aftësimin e Policisë Vullnetare
Qëllimi i kursit	Programi Mësimor “Kursi mbi aftësimin e Policisë Vullnetare”, ka për qëllim: Të ofrojë një sistem trajnimi që do të formojë dhe zhvillojë punonjës policie vullnetare të disiplinuar, me njohuri dhe aftësi të plota profesionale, të aftë për t’i shërbyer komunitetit, për të ndihmuar në garantimin e rendit dhe sigurisë publike, duke njohur e respektuar njëkohësisht të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, mbi bazën e parimeve të policimit demokratik.
Objektivat e kursit	Në fund të kursit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje: - Të mësojnë dhe zbatojnë përgjegjësitë e punonjësit të policisë vullnetare për të mbështetur strukturat policore vendore në rritjen e sigurisë publike, duke mbrojtur liritë dhe të drejtat e qytetarëve, si dhe për të zbatuar ligjet. - Të arrijnë të shfaqin një autoritet të zbatuesit të ligjit, si shërbim i vijës së parë në kontakte të përditshme me qytetarët duke bashkëpunuar me strukturat policore, për të krijuar një perceptim pozitiv të publiku. (Marrja e njohurive të nevojshme për legjislacionin, për procedurat dhe përgjegjësitë e përgjithshme, për Kodin Rrugor, për patrullimin dhe bazat e hetimit, për menaxhimin e incidenteve nga policimi vullnetar dhe bashkëpunimi me strukturat policore etj., janë në funksion të arritjes së këtij objekti.) - Të sigurojnë dhe shfaqin aftësinë për gjykim dhe vendimmarrje të shëndoshë, të mbështetur në etikën dhe vlerat e kërkuara, për të bërë të mundur ndërhyrjen e parë në përshtatje me mjedisin, rrethanat, shpesh të ndjeshme për komunitetin dhe grupe të ndryshme si të miturit, viktimat e ngjarjeve kriminale etj. - Të arrijnë të fitojë aftësi dhe shkathtësi praktike profesionale për të përballuar dhe t’u japë zgjidhje e



	përgjigje situatave tipike, me teknika të sprovuara, si për të mbrojtur qytetarët, për t'u shërbyer atyre, ashtu edhe për të mbështetur strukturat policore. - Të arrijë të krijojë marrëdhënie bashkëveprimi me Oficerët e Sigurisë në Shkollë, duke bërë të mundur krijimin e një klime të sigurt në ambientet jashtë shkollës duke drejtuar trafikun rrugor dhe këmbësorët, po ashtu në ambientin e brendshëm të shkollës, duke bashkëvepruar në marrjen e informacionit dhe zgjidhjen e konflikteve të ndryshme që mund të lindin në këto ambiente. - Të fitojë aftësi menaxhuese për ngritjen e grupeve vullnetare të qytetarëve për kërkimin e personave të shpallur të humbur në rastet e fatkeqësive natyrore, si dhe të personave të shpallur të humbur nga familjarët e tyre. Këto aftësi përfshijnë përdorimin e pajisjeve, komunikimin, vetëmënaxhimin, kryerjen e kërkimit, si dhe ndërhyrjen e parë në situatë që lidhen me rendin e sigurinë publike.
Metodologjia	Metodologjia e trajnimit është e orientuar drejt pjesëmarrësve dhe bazohet në: diskutime në klasë, punë në grup/individuale, ushtrime praktike.
Metoda e vlerësimit	Vlerësim me shkrim, test nëpërmjet sistemit "Scantron". Vlerësim praktik gjatë zhvillimit të kursit.
Certifikimi	Kursantët që mbarojnë me sukses Programin Mësimor do të certifikohen.
Kohëzgjatja	Trajnimi realizohet në një afat kohor prej 2 javësh , gjithsej 71 orë mësimore .

Struktura e Programit nëpërmjet planeve mësimore

Nr. i Temës	Titulli i Temës	Orët
Prezantim	Prezantim i Kursit/procedurat administrative	1 orë
Tema # 01	Roli i punonjësit të policisë vullnetare për mbështetjen e strukturave policore, përgjegjësitë e tij.	6 orë
Tema # 02	Të drejtat e njeriut.	2 orë
Tema # 03	Kodi rrugor dhe komandat për rregullimin e trafikut në zonat urbane dhe rurale.	4 orë
Tema # 04	Menaxhimi i Stresit.	2 orë
Tema # 05	Gjakderdhja, fashimi, shoku, djegia.	6 orë
Tema # 06	Etika në administratën publike.	2 orë
Tema # 07	Policimi në komunitet, patrullimi dhe parandalimi i krimit.	6 orë
Tema # 08	Mbrojtja nga zjarri.	3 orë
Tema # 09	Menaxhimi i emergjencave civile, operacionet e kërkim-shpëtimit.	4 orë
Tema # 010	Krimet e urrejtjes, mosdiskriminimi dhe diversiteti.	3 orë
Tema # 011	Shërbimi policor në aktivitetet sportive.	6 orë
Tema # 012	Shërbimi policor në aktivitetet masive (tubime, manifestime).	6 orë
Tema # 013	Teknikat e kontrollit të butë vetëm me duar.	4 orë
Tema # 014	Identifikimi i lëndëve narkotike (psikotrope).	4 orë
Tema # 015	Rritja e sigurisë publike në institucionet arsimore.	4 orë
Tema # 016	Vepra penale.	5 orë
Tema # 018	Dhuna në familje.	5 orë
TOTALI		71 orë



Shtojca 6

**PAJISJET, SHENJAT DALLUESE DHE VESHJET IDENTIFIKUESE
TË POLICIT VULLNETAR.**

Me qëllim që polici vullnetar të jetë sa më komod dhe i sigurtë gjatë punës vullnetare, është parashikuar që ai të ketë pajisjet, shenjat dalluese dhe veshjet identifikuese të tij. Efektet financiare të tyre, do të mbulohen nga buxheti i Policisë së Shtetit, si pjesë e programi buxhetor “Policia e Shtetit”, sipas njësisë shpenzuese.

Efektet financiare të pajisjeve, shenjave dalluese dhe veshjeve identifikuese të policit vullnetar, do të mbulohen nga buxheti i Policisë së Shtetit.

Pajisjet, shenjat dalluese dhe veshjet identifikuese për një polic vullnetar paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi	Afati i përdorimit	Njësi (copë)	Çmimi për njësi
A. Veshje identifikuese				
1.	Xhaketë fluoreshente me mënge të çmontueshme mbishkrimin —POLIC VULLNETAR	2 vjet	1	5,000 lek
2.	Kapele sportive ngjyrë blu me mbishkrimin —POLIC VULLNETAR	2 vjet	2	804 lek
SHUMA A:				
B. Veshje të emergjencës				
3.	Mushama shiu	6 vjet	1	5,670 lek
4.	Çizme shiu (llastiku)	5 vjet	1 (palë)	800 lek
SHUMA B:				
C. Shenja dalluese				
5.	Shenjë dalluese —POLIC VULLNETAR (logo e cila vendoset në xhaketë, kapele dhe në dokumentin e identifikimit)	-	-	-
SHUMA C:				
D. Dokument identifikimi				
6.	Dokument identifikimi me logo	-	-	-
SHUMA D:				
E. Pajisje				
7.	Bilbil	2 vjet	1	400 lek
8.	Elektrik dore	5 vjet	1	1,200 lek
9.	Tabelë dore —STOP	5 vjet	1	1,000 lek


	SHUMA E:			
	SHUMA A+B+C+D+E:			14,874 lek

Kostoja specifike për një polic vullnetar, është **14,874** (katërmbëdhjetëmijëtetëqindshatëdhjetëekater) lekë.

1. XHAKETA FLUORESHENTE E POLICITVULLNETAR



Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit *xhaketë fluoreshente* duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	e gjelbërt (green lime) spektri sipas CIELCH 79, 89.881, 119.910	
Përbërja	100% <i>poliamid</i>	e veshur me shtresë poliuretani
Thurja	Oxford	
Masa (± 5%)	155 gr/m ²	



Përshkueshmëria e ujit	mbi 20,000 mm	$\geq$ ISO 5	
Përshkueshmëria e ujit (presioni mbi 50 mbar/min hidrostatik)			
Aftësia ajërosëse e tekstilit	mbi 15,000 gr/m ² /24h	ajërosje shumë e mirë	Ret ≤ 7
Përshkueshmëria e ajrit	≤ 5 l/m ² /s		
Hollësia e fijes	300D * 300D		
Rezistenca ndaj hidrokarbureve (padepërtueshmëria ndaj vajërave)	Fillestare ≥ 5 Pas 3 larjesh ≥ 4 (temp 40°C, tharje në ajër)		
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4 $\square$ 5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.	
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.	
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 50,000 cikle		
Efekti pilling (kokërrzimi)	nota 5		
Azo Ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm		
pH	4.0 - 9.0		
Kujdes! Tekstili nuk duhet të ketë aroma të pakëndshme dhe nuk duhet të jetë i ashpër.			

Ngjyra e tekstileve të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me atë të kampionit të tekstilit që shoqëron ofertën teknike të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provave të rezistencës ndaj fërkimit në gjendje të thatë dhe të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe ekspozimit ndaj dritës (rrezatimit UV).

Vlerat e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jenë si më poshtë:

- Qëndrueshmëri e mirë — nota 4
 - Qëndrueshmëri shumë e mirë — nota 5
- Ndërsa qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës nuk duhet të jetë më e ulët se nota 6 (shumë e mirë).

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në ofertën teknike do të kryhet testi fizik i mëposhtëm: kampioni i tekstilit me ngjyrë të gjelbër do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati do të konsiderohet pozitiv nëse ngjyra e gjelbër nuk njollos tekstin e bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve që shfaqin këto defekte (lista nuk është gjithëpërfshirëse):

- Elementë Velcro që konsumohen shpejt gjatë përdorimit
- Papastërti me origjinë bimore
- Njolla vaji ose boje
- Diferenca në tonalitetin e ngjyrës
- Oksidime



- Rudhosje
- Mungesë ose trashje të fijeve të indit dhe bazës
- Vrima në sipërfaqe
- Çdo parregullsi tjetër që cenon funksionalitetin dhe estetikën e uniformës

Materialet ndihmëse dhe aksesorët që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit:

Xhakëtë fluoreshente:


Astarët			
Astar në formë rrjete për xhaketën. 	Përbërja	90% poliester	10% <i>spandex</i>
	Pesha	90 gr/m ²	
	Ngjyra	e gjelbër	
	Thurja	trikotazh rrjetë	
Astar për xhepat dhe mëngët e xhaketës	Përbërja	50% pambuk	50% poliestër
	Pesha	80 gr/m ²	
	Ngjyra	e gjelbër	
	Thurja	diagonale	
Përforcues			
Frazelinë termoadezive me ngjyrë të errët për jakën, kapakët e xhepave dhe ylykët.			
Tekstil			
Tekstil tubolar për manshetat e mëngëve	Përbërja	100 % Poliestër	
	Ngjyra	E gjelbër	
	Thurja	Llastik 1:1	
	Ndërtimi	Tubolar (pa qepje)	
	Gjerësia	rreth 7.5 cm e relaksuar	
	Lartësia e manshetit	7 cm (e palosur)	
	Veti	Elastike shumë e mirë	
Aksesorë të tjerë			
Element <i>Velcro</i> femër/mashkull për xhepat.	Përmasat <i>Velcro</i> , xhepat	2.5 x 2 cm	
	Përbërja	100% fibra poliamide	
	Trashësia	2.2 mm	
	Masa lineare	41 g/m ± 5%	
	Ngjyra	njësoj si xhaketa	
	Qëndrueshmëria në temperatura ekstreme		
E ftohtë	- 30° C		



	E nxehtë	pika e dobësimit	180° C
		pika e shkrirjes	210—250° C
	Qëndrueshmëria e ngjyrës		
	Në larje	jo më pak se 3	
	Në ujë të nxehtë		
Në detersë			
Në fërkim			
	Shirit për termosaldimin e qepjeve kryesore të xhakëtës.		Poliamid
	Me 3 shtresa		PTFE
			shtresë termoadezive
	Ngjyra	e bardhë	
	Gjerësia	2 cm	
	Trashësia	0.35 mm	
	Me ajërosje të mirë dhe rezistencë të lartë ndaj ujit.		
Filli			
Fill qepës për qepjet primare dhe të dukshme.	Përbërja	100% poliestër	
	Numri metrik	50 Nm ± 5%	
	Qëndrueshmëria ndaj tërheqjes	jo më pak se 12 N	
	Ngjyra	njësoj si xhaketa	
Fill qepës për qepjet dytësore (astari i xhepave, astarët e xhakëtës etj.).	Përbërja	100% poliestër	
	Numri metrik	75 Nm± 5%	
	Qëndrueshmëria ndaj tërheqjes	jo më pak se 12 N	
	Ngjyra	njësoj si xhakëtëi	
Perçina			
	1 copë Nr. 27 (d 17 mm)		
	Përbërja	tunxh (aliazh zinku dhe bakri)	
	Ngjyra	e zezë pa shkëlqim	
	Kujdes! Perçina duhet të jetë e përshtatshme për tekstin e produktit ku do të montohen.		
Zinxhiri			
Zinxhir për mbylljen e xhakëtës	Standard, me fund të hapur, me rezistencë maksimale ndaj ujit		
	Madhësia e dhëmbëzave		8 VF
	Shiriti prej tekstili	Poliester i veshur me poliuretan	
	Dhëmbët	100% poliamid	



		Ngjyra	e zezë
Zinxhir për montimin dhe çmontimin e mëngëve të xhaketës		Standard, me fund të hapur, për aplikime në linja të harkuara dhe me rezistencë maksimale ndaj ujit.	
		Madhësia e dhëmbëzave	8 VF
		Shirit prej tekstili	poliester i veshur me poliuretan
		Dhëmbët	100% poliamid
		Ngjyra	e zezë
Etiketa			
Etiketë prej tekstili për identifikimin e fabrikës, masës, gjinisë, mirëmbajtjes dhe përbërjes.		Përbërja	100% poliester
		Ngjyra	e bardhë

Stampa		
Shkrimi POLICIA VULLNETARE, mbrapa. POLICIA VULLNETARE	Ngjyra	gri, argjend
	Lloji i bojës	reflektive
	Lartësia e shkronjës	5 cm
	Gjerësia e shkronjës	≈ 1 cm
	Lloji i shkronjës	Myriad Pro Bold
	Stampa duhet të rezistojë mbi 105 cikle larjeje.	
Stampë reflektive në formë shiritash 	Ngjyra	gri
	Gjerësia	5 cm
	Përbërja	100 % poliester
	Ky produkt duhet të jetë i certifikuar për aftësi të lartë reflektive sipas standardit EN ISO 20471	
	Stampa duhet t'i rezistojë mbi 105 cikleve të larjes në kushte shtëpie me temperaturë 60 °C.	
	Shiritat e stampuar duhet të duken nga një distancë prej mbi 150 m.	
Stampë e shenjës dalluese "Polic Vullnetar"	Ngjyrat	Sipas formatit zyrtar
	Përmasat	7 x 8 cm
	Stampa duhet t'i rezistojë mbi 105 cikleve të larjes në kushte shtëpie me temperaturë 60 °C.	

Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit *xhaketë fluoreshente*: Fotografia e mëposhtme shërben vetëm si shembull ilustrues.



1 qese polietileni për xhaketë

1 kuti kartoni për paketimin e xhaketave

Të gjithë mjetet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli *xhaketë fluoreshente* do të porositet dhe do të prodhohet në masat XS – XXXL për femra dhe në masat S – XXXL për meshkuj dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të policëve vullnetarë të Policisë së Shtetit.

NGJYRAT REFERENCË



Ngjyra e gjelbër e tekstilit për xhaketën, astarët dhe elementët Velcro duhet të përputhet me spektrin CIELCH 79, 89.881, 119.910. Ngjyra gri e argjendtë për stampat reflektive duhet të përputhet me spektrin CIELCH 73, 0.743, 200.028. Ngjyrat e specifikuar në këtë dokument shërbejnë si referencë për prodhuesin. Aprovimi i tyre do të bëhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të miratohet paraprakisht nga grupi i punës së specialistëve teknikë, përmes një kërkesë zyrtare.

PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e saktë e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse është themelore për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike gjatë prodhimit të xhakës fluoeshente.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të produktit duhet të kenë përputhshmëri të saktë dhe të shënohen me shenjat përkatëse të prerjes dhe bashkimit. Gjithashtu, të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil sipas drejtimit të fijeve të bazës.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fle të të fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 80 fle të. Kujdes i veçantë duhet të tregohet në pjesët e harkuara të detajeve, duke siguruar që buzët e prera të mos kenë dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detajet e produktit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.

Aplikimi i frazelinës

Ngjitja e frazelinës duhet të bëhet me presë speciale në presion 2—3 bar, me avull, në temperaturën 130—140 °C, me kohëzgjatje 8—10 sekonda. Ky proces duhet të kryhet sa më saktë, në mënyrë që produkti të mos humbasë formën fillestare pas hekurosjes me avull, larjes dhe lagies nga shiu. Nuk lejohe aplikimi i frazelinës me shtesa. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet prerjes së detajeve. Nuk duhet të mbeten shenja të hekurit ose presës në tekstil. Adezivi nuk duhet të depërtojë në anën tjetër të tekstilit.

NDËRTIMI I XHAKETËS

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të xhakës fluoeshente



Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.

Khaketat fluoreshente për femra dhe për meshkuj janë identikë përveç masave, të cilat duhet të jenë sipas gjinive. Gjatësia e saj duhet të jetë deri në linjën e vitheve. Khaketa është me mëngë të çmontueshme për t'u kthyer në jelek.



Pjesët përbërëse të khaketës

- Jaka
- Dy pjesët e përparme
- Pjesa e pasme
- Mëngët
- Dy xhepa të përparmë
- Xhepi i gjoksit
- Shirita reflektive të stampuar
- Stampat

Jaka duhet të jetë në formë rrethore, rreth 8 cm e lartë. Ajo duhet të përbëhet nga dy shtresa me tekstil të njëjtë si khaketa dhe të përforcohet me frazelinë termoadezive. Buzët e jakës duhet të përshkohen nga tre tegela lineare perimetrale një gjilpërësh sipërfaqësorë: një tegel në buzën e sipërme dhe dy tegela në buzën e poshtme.

Pjesa e përparme përbëhet nga dy pjesë. Mbyllja e khaketës duhet të bëhet me anë të zinxhirit. Në anën e djathtë të gjoksit, mbi shiritin reflektiv, do të qepet një ylyk me përmasa 2 x 6 cm, me të njëjtin tekstil si khaketa. Ylyku duhet të përforcohet nga brenda me frazelinë termoadezive.

Xhepat e përparmë duhet të jenë të brendshëm dhe me kapak. Kapakët duhet të përbëhen nga dy shtresa me tekstil të njëjtë si khaketa dhe të përforcohen me frazelinë termoadezive. Buzët e lira të kapakut të xhepit duhet të përshkohen nga tegela lineare perimetrale një gjilpërësh



sipërfaqësorë. Kapakët e xhepave duhet të kenë përmasa rreth 20 x 6 cm, ndërsa astarët e xhepave duhet të jenë me përmasa 20 x 25 cm. Mbyllja e xhepave duhet të bëhet me element Velcro femër/mashkull.

Përmasat e xhepave mund të ndryshojnë te masat e mëdha dhe të vogla. Xhepi i gjoksit duhet të jetë i tipit cargo, me përmasa të përshtatshme për transportin e radiove të përdorura nga Policia e Shtetit. Ky xhep është me kapak dhe mbyllet me perçinë.

Pjesa e pasme duhet të jetë e vetme. Në të duhet të stampohen shiritat reflektivë dhe fjala POLICIA VULLNETARE me bojë reflektive.

Ndërkohë, fundi i xhakëtës duhet të ketë një palosje të dyfishtë me lartësi rreth 2 cm dhe të qepet me tegel linear një gjilpërësh.

Mëngët duhet të jenë të lëvizshme dhe të hiqen ose të vendosen sipas dëshirës me anë të zinxhirit. Zinxhiri duhet të qepet në të gjithë perimetrin e gavaturës së mëngës dhe fillimi e fundi i tij duhet të jenë të puthitur. Ai duhet të jetë i cilësisë së lartë, të mos hapet vetë gjatë përdorimit dhe të mbyllet mirë deri në fund. Mëngët duhet të ndërtohen me një pjesë të vetme dhe në fund të mbyllen me një manshet të trikotuar methurje llastik 1:1, me lartësi rreth 7 cm, të palosur një herë dhe të qepur me tegel linear një gjilpërësh dhe një tegel syzator me 5 gjilpëra.

Shiritat reflektivë duhet të përfshijnë një shirit të stampuar përgjatë perimetrit tërthor të trupit, dy shirita reflektivë të stampuar në mënyrë vertikale tek zona e klavikulës dhe shpatullave, si dhe dy shirita perimetralë tek krahët. Shiriti duhet të jetë 5 cm i gjerë. Stampimi duhet të jetë prej materiali reflektiv fluoreshent ngjyrë gri dhe i cilësisë më të lartë. Ai duhet të jetë i rregullt, uniform dhe i aplikuar sipas ilustrimit teknik. Nuk duhet të fshihet apo të humbasë efektin reflektiv gjatë përdorimit, të pësojë plasaritje apo dëmtime të tjera.

Astari duhet të jetë në formë rrjete për pjesën e trupit dhe prej tekstili për pjesën e mëngëve. Ai duhet të qepet tek paramontura.

Në pjesën e pasme të xhakëtës, në qendër të shpatullave, duhet të stampohet fjala POLICIA VULLNETARE. Përmasat e shkrimit duhet të jenë njësoj për të dyja gjinitë, me lartësi të shkronjës 5 cm dhe gjerësi rreth 1 cm. Përmasat e shkrimit duhet të jenë sipas ilustrimit teknik. Shkrimi nuk duhet të shtrembërohet ose të deformohet horizontalisht ose vertikalisht. Proporcionet e tij duhet të jenë rreptësisht sipas raporteve të përcaktuara për llojin e shkronjës.

Shkronjat duhet të jenë kapitale dhe të përdoret Myriad Pro Bold. Stampimi duhet të jetë prej materiali reflektiv fluoreshent ngjyrë gri, i cilësisë së parë dhe nuk duhet të humbasë efektin reflektiv gjatë përdorimit. Ai duhet të jetë i drejtë, i rregullt, pa deformime dhe nuk duhet të krijojë tendosje të tekstilit.

Kujdes! Përmasat e stampave mund të ndryshojnë proporcionalisht për masat e vogla dhe të mëdha.

2. STAMPA E SHENJËS DALLUESE TË POLICIT VULLNETAR

Në pjesën e përparme të xhaketës, në anën e djathtë të gjoksit, duhet të stampohet shenja dalluese e Policit Vullnetar, duke respektuar ngjyrat dhe skicimin sipas formatit të saj zyrtar, me përmasa 7x8 cm. Stampa duhet të pozicionohet midis shiritit reflektiv dhe bordurës së zinxhirit.

Ajo nuk duhet të shtrembërohet apo të deformohet horizontalisht ose vertikalisht. Stampimi duhet të jetë i cilësisë më të lartë, i rregullt, uniform dhe i aplikuar sipas ilustrimit teknik. Ngjyrat e stampës nuk duhet të zbehen gjatë përdorimit dhe larjes, dhe nuk duhet të pësojnë plasaritje apo dëmtime të tjera.

Stampimi duhet të jetë i drejtë, i saktë, pa deformime dhe nuk duhet të krijojë tendosje në tekstil.



KUSHTET E DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar.
- Filli i qepjes duhet të ketë saktësisht karakteristikat e përcaktuara në Specifikimet Teknike.
- Tegelat e qepjes duhet të kenë hap 4 shpime në 1 cm, të jenë të drejtë, uniformë, simetrikë dhe pa shqepje ose defekte.
- Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen kur tërhiqen me dorë. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12N.
- Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Tegelat qepës të gavaturat e mëngëve, pjesa e supëve, para dhe pas duhet të jenë të termosaldura.
- Të gjitha elementet e produktit duhet të jenë simetrikë.
- Përpara fillimit të prodhimit, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional, duke siguruar që tekstili të ruajë formën pas prerjes, qepjes, larjes dhe hekurosjes.
- Tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose të specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu, tekstili nuk duhet të ftojë shkëlqim gjatë hekurosjes.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit ultraviolett.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj konsumit dhe përdorimit.
- Tekstili nuk duhet të krijojë rrudha gjatë përdorimit.
- Produkti duhet të jetë i lehtë për mirëmbajtje.
- Produkti duhet të'i rezistojë mbi 25 larjeve në kushte shtëpie me temperaturë 60°C pa pësuar ndryshime.



- Kufiri i lejuar i gabimit në përmasat e produktit është $\pm 2\%$. Te qepja e jakës nuk lejohet asnjë kufi gabimi.
- Vendosja e perçinave duhet të bëhet rreptësisht sipas përshkrimit në Specifikimet Teknike.
- Perçinat duhet të kenë pamje të rregullt. Nëse hidhen me forcë në tokë nga një lartësi prej 2 metrash, nuk duhet të thyhen, plasariten, gërvishten ose të dëmtohen.
- Elementet Velcro nuk duhet të zbuten ose t'u dalin fijet anësore gjatë përdorimit të shpeshtë.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruar.
- Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e testimeve sipas standardeve:
- EN ISO 14362-1:2017
- EN ISO 14362-3:2017
- EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet me kontakt direkt me lëkurën: 4.0–7.5; për veshjet pa kontakt direkt me lëkurën: 4.0–9.0)
- Prodhuesi duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

- Xhaketa duhet të ketë një etiketë prej tekstili ku të shënohet emri i fabrikës, viti i prodhimit, masa, gjinia, përbërja dhe instruksionet e mirëmbajtjes.
- Etiketa duhet të qepet në brendësi të xhaketës, tek astari, në anën e majtë, rreth 20 cm nga fundi i xhaketës.
- Në momentin e dorëzimit, xhaketat duhet të jenë të pastra, të hekurosura dhe pa njolla.
- Xhaketat e palosura duhet të futen në qese polietileni.
- Çdo kuti duhet të përmbajë xhaketa të së njëjtës masë dhe gjinie, me sasi të barabartë për secilën kuti.
- Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 g/m²) duhet të sigurojë transportin e sigurt të produkteve.
- Çdo kuti duhet të ketë një etiketë ngjitëse ku të shënohet masa e xhaketës, gjinia, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese.
- Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).

Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Ana lizat kimike sasiore ose CEN ISO/TR 11827:2016 Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa g/m ²	ISO 3801:1977/EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes. EN ISO 2286-2:2016 Tekstile të gomuar ose të plastifikuara - Pjesa 2: Metodatat për përcaktimin e masës së përgjithshme për njësi të sipërfaqes, masës për njësi të veshjes të sipërfaqes dhe masës për njësi të shtresave
Përshkueshmëria e ujit (presioni hidrostatik)	EN ISO 4920:2012 Pëlhura tekstili - Përcaktimi i qëndrueshmërisë në njomjen sipërfaqësore (prova me sprucim) EN 20811/ EN ISO 811:2018 Tekstile - përcaktimi i qëndrueshmërisë ndaj depërtimit të ujit - testi nën presionin hidrostatik
Aftësia ajrosëse e tekstilit	EN ISO 11092:2014 Tekstile - Efektet fiziologjike - Matja e qëndrueshmërisë termike nën ndikimin e avujve të ujit në kushte të qëndrueshme (prova e pjatës së nxehtë të mbrojtur nga djersitja)
Përshkueshmëria e ajrit	EN ISO 9237 :1995

	Tekstilet - Përcaktimi i depërtueshmërisë së pëlhurave nga ajri
Hollësia e fijes	ISO 7211-5: 1984 Tekstilet - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 5: Përcaktimi i dendësisë lineare të fijeve të hequra nga pëlhura.
Rezistenca ndaj hidrokarbureve (padepërtueshmëria ndaj vajrave)	EN ISO 14419:2010 Tekstilet - Padepërtueshmëria ndaj vajrave - Testi i rezistencës ndaj hidrokarbureve
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi.
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04 :2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në fërkim me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
Materialet reflektive	EN ISO 20471: 2013/A1:2016 Standardi për shiritat reflektive dhe veshjet për sigurinë në punë.
AZO ngjyrues	Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve: EN ISO 14362-1:2017 EN ISO 14362-3:2017
ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

3. KAPELË SPORTIVE NGJYRË BLU



**MATERIALET**

Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit *kepele sportive* duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	blu e errët CIELCH 18, 14.587,295.349.			
Përbërja % (± 5%)	50% pambuk + 50 % poliamid			
Thurja	ripstop (reps i kombinuar me garniturë 1:1)			
Masa gr/m ²	210 - 220 gr/m ²			
Dendësia/10 mm	baza	46-48	indi	24-26

Hollesia e fijes	baza	14x2tex 16tex x2 max	min indi	14x2tex min 16tex x2 max
Qëndrueshmëria në N	baza	> 900 N	indi	> 450 N
Zgjatimi terheqje	Baza	> 25%	Indi	>15%
Qëndrueshmëria e ngjyrës:	4-5 Shkalla gri		Ngjyrosja duhet te jete ne fije	
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	Nota ≥ 6 (Shkalla Blu)		Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë	
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 50,000 cikle			
Kendi i rikuperimit pas ngjeshjes	Baza: > 90°		Indi > 90 °	
Efekti pilling (kokërrzimi)	Nota 4 – 5			
Rezistenca ndaj ujit (Minimum)	Kryesore: 5(100), Mbas 5 larjeve: 4(90)			
Ndryshimi i dimensioneve në larje me 60°	≤ -3% ne gjatësi dhe gjerësi ≤ +1% ne gjatësi dhe gjerësi			
Rezistenca ndaj Hidrokarbureve (padepërtushmeria ndaj vajrave) (Minimum)	Kryesore: 5(100), Mbas 5 larjeve: 4(90)			
AZO Ngjyrues	Nuk duhet te jene te pranishëm			
ph	4.0 - 7.5			



NGJYRA DHE QËNDRUESHMËRIA E TEKSTILIT

- Ngjyra e tekstilit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me kampionin e tekstilit të depozituar në ofertën teknike nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim.

- Tekstili duhet t'u nënshtrohet testeve të rezistencës ndaj:
- Fërkimit në të thatë dhe në të njomë;
- Larjes me solucion sapuni;
- Djersës;
- Dritës (rrezatimit UV).
- Vlerat minimale të qëndrueshmërisë së ngjyrës duhet të jenë:
- Qëndrueshmëri e lartë – nota 4;
- Shumë e qëndrueshme – nota 5;
- Qëndrueshmëri ndaj dritës – jo më pak se nota 6 (shumë e mirë);

Testi i qëndrueshmërisë së ngjyrës

- Kampioni i tekstilit me ngjyrë blu do të fërkohej për një kohë të caktuar me një cohë të bardhë.
- Testi konsiderohet i suksesshëm nëse tekstili i bardhë nuk njolloset nga ngjyra blu.

KONTROLI I CILËSISË

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë tekstilet ose materialet që paraqesin defekte të mëposhtme (lista nuk është gjithëpërfshirëse):


- Papastërti me origjinë bimore;
- Njolla vaji ose boje;
- Tonacione të ndryshme të ngjyrës;
- Oksidime;
- Rudhosje;
- Mungesë fijesh në ind dhe bazë;
- Trashim të fijeve në ind dhe bazë;
- Vrima në sipërfaqe;
- Lëkundje në gjerësi;
- Çdo defekt tjetër që cenon cilësinë funksionale dhe estetike të uniformës.

Këto kushte janë të detyrueshme dhe çdo devijim nga specifikimet e mësipërme do të rezultojë në mospranimin e produktit.

Materialet ndihmëse dhe aksesorët që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *kapelë sportive*.

Fileto		Ngjyra	blu e errët
Fileto për fshehjen e tegelave bashkues të kapelës.		Përbërja	100% <i>viskoze</i>
		Thurja	garniturë
		Gjerësia	12 mm
Përforcues			
Frazelinë e hollë për rrethin e brendshëm të kapelës.		Lartësi	35 mm
		Ngjyra	e bardhë
Shtresë sfungjeri për pjesën e brendshme të rrethit të kapelës.		Trashësi:	2 mm
		Lartësi:	35 mm
Shirit plastik PVC me ngjyrë të zezë për përforcimin e rrethit të brendshëm të kapelës.		Gjerësia	5 mm
		Trashësia	0.5 mm
Tekstil i kollarisur adesiv për përforcimin e pjesës ballore të kupolës së kapelës.		Përbërja	100% pambuk
		Pesha	220 g/m ² ± 3%



Streha			
Shtresë plastike e harkuar me elasticitet të lartë për strehën e kapelës.		Përbërja	polivinil kloruri (PVC)
		Trashësia	± 2 mm
		Përmasat	18 x 7 cm
Filli			
Fill qepës.	Përbërja	100% poliestër	
	Numri	75 Nm	
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12 N	
Fije për qëndisje	Ngjyra:	njësoj si kapela	
	Përbërja	100% poliestër	
	Numri	75 Nm	
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12 N	
	Ngjyra:	Sipas imazhit zyrtar	
	Aksesorë të tjerë		
1 një kopsë e veshur me të njëjtin tekstil si kapela.		Diametri	15 mm
Mekanizëm plastik për shtrëngimin e kapelës.		Përmasa	2 x 8 cm
		Përbërja	polivinil kloruri (PVC)
		Ngjyra	e zezë
Etiketa			
Etiketë prej tekstili për identifikimin e firmës prodhuese, masës, mirëmbajtjes dhe përbërjes.	Përbërja	100% poliestër.	
	Ngjyra	e bardhë	
Shenja dalluese e Policit Vullnetar			
	Përmasa	5 x 4 cm	
	Ngjyrat	Sipas ilustrimit zyrtar (ngjyrë e artë, e kuqe, blu e errët)	
Qëndisje	Përmasat	17 x 1.5 cm	
POLICIA VULLNETARE	Ngjyra	Gri argjendi	

Produkti final do t'i nënshtrohet kontrollit fizik të thjeshtë për të vërtetuar që plotësohen kushtet teknike për secilin element, si:

- Materialet e përdorura, të cilat duhet të jenë të përshtatshme për produktin;
- Pamja dhe konstruksioni i përgjithshëm;
- Stilizimi dhe vlerat estetike etj.

Ky kontroll do të kryhet me sy të lirë dhe me mjete të caktuara për këtë qëllim.

Materialet për paketimin e artikullit “kapelë sportive” duhet të jenë:

- 1 qese polietileni për kapela;
- 1 kuti kartoni për paketimin e kapelave.


Të gjitha mjetet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara, por çdo ndryshim, përshtatje apo zëvendësim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës të specialistëve teknikë, përmes një kërkesë zyrtare.

Masat dhe sasia e prodhimit:

Artikulli “kapelë sportive” do të prodhohet në masat S, M, L dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të policëve vullnetarë të Policisë së Shtetit.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:



Meshkuj



Femra

1 Perimetri i kokës

cm.

NGJYRA REFERENCE

Ngjyra e tekstilit të kapelës dhe aksesorëve të tjerë duhet të jetë blu e errët spektri sipas CIELCH 18, 14.587,295.349.

Ngjyra e paraqitur në këtë dokument shërben si referencë për prodhuesin.

Aprovimi i saj do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampionëve.



Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknikë nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit *kapelë sportive*.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut.

Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 100 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera që të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e produktit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.

Frazelina

Ngjitja e frazelinës duhet të bëhet me presë speciale në presion 2–3 bar, me avull, në temperaturën 150–170 °C, me kohëzgjatje 12–14 sekonda. Ky proces duhet të kryhet sa më i saktë, në mënyrë që produkti mos të humbasë formën fillestare pas hekurosjes me avull, larjes dhe lagies nga shiu. Nuk lejohet aplikimi i frazelinës me shtesa. Kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet prerjes së detaleve. Nuk duhet të mbeten shenja të hekurit/presës në tekstil. Adezivi nuk duhet të depërtojë në anën tjetër të tekstilit.

NDËRTIMI I KAPELËS

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të kapelës sportive.

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet te dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.

NDËRTIMI I KAPELËS

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të kapelës sportive.

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet te dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.



Kapela sportive duhet të jetë e tipit baseball cap, me mekanizëm plastik shtrëngues me kunjja. Pjesët përbërëse të saj janë:

- Kupola;
- Streha;
- Mekanizëm plastik shtrëngues;
- Shenja dalluese Policia Vullnetare.

KUPOLA

Lartësia e kupolës duhet të jetë 17 cm. Ajo duhet të jetë e ndërtuar me pesë pjesë: katër pjesë trekëndore prej tekstili me përmasa të barabarta dhe pjesa ballore, e përforcuar me tekstil të kollarisur, që duhet të jetë sa dy pjesë të bashkuara. Pjesët duhet të qepen me njëra-tjetrën me anë të tegelave linearë njëgjilpërësh, ndërsa te pjesa e ballore qepja duhet të bëhet vetëm te buzët e lira, duke formuar kështu një pencë me gjatësi rreth 8 cm. Tegeli i pencës duhet të jetë sipërfaqësor.

Në anën e brendshme, tegelat qepës duhet të mbulohen me fileto prej tekstili me ngjyrë të zezë me gjerësi rreth 12 mm. Buzët e filetove duhet të përshkohen nga një tegel linear njëgjilpërësh sipërfaqësor, të cilët duhet të duken edhe nga sipër. Me fileto me gjerësi rreth 8 mm duhet të mbulohet edhe tegeli i hapjes së harkuar të mekanizmit plastik shtrëngues.

Katër pjesët duhet të kenë nga një vrimë të vogël për ajrosje me diametër 8 mm dhe buzë të qëndisura me fill ngjyrë blu.

Në pikën kulmore të kupolës, atje ku puthiten këndet e të gjitha pjesëve, duhet të qepet një kopsë e veshur me të njëjtin tekstil si kapela.

Kapela duhet të pajiset në pjesën e pasme me mekanizëm plastik shtrëngues me kunjja.

Te buza e poshtme perimetrale e kupolës duhet të qepet një shirit përforcues plastik me ngjyrë të errët dhe gjerësi 5 mm që ka si funksion ruajtjen e formës së kapelës.

Po tek i njëjti vend duhet të qepet edhe një shirit me gjerësi 3 cm. Shiriti duhet të qepet te buza e poshtme, ndërsa buza e sipërme duhet të jetë e lirë.

Shiriti duhet të jetë i përbërë nga një shtresë tekstili të njëjtë me filetот, i prerë me kënd 45° dhe një shtresë sfungjer dhe frazelinë të ngjitura bashkë.



STREHA

Streha duhet të ketë përmasa 18x7 cm. Ajo duhet të jetë e përbërë nga një shtresë e harkuar plastike me ngjyrë të zezë dhe trashësi 2 mm e veshur me dy shtresa tekstili të njëjtë me kapelën. Shtresa plastike duhet të jetë relativisht e fortë dhe elastike.

Shtresat prej tekstili duhet të qepen me shtresën plastike nëpërmjet 4 ose më shumë tegelave linearë njëgjilpërësh sipërfaqësorë me distancë 5 mm nga njëri-tjetri dhe distancë rreth 15 mm nga buza e lirë e strehës.


Streha duhet të qepet te perimetri kupolës.

SHENJA DALLUESE

Shenja dalluese Policia Vullnetare duhet të ketë përmasa 5x4 cm dhe duhet të qëndiset te pjesa ballore e kapelës. Modeli i shenjës duhet të ketë pamjen e saj zyrtare, ashtu siç është paraqitur në ilustrimin e këtij dokumenti. Gjatë prodhimit, ajo nuk duhet të pësojë ndryshime në model, ngjyrë, raportet mes elementeve dhe në përmasa.

Qëndisja duhet të jetë e drejtë, e plotë, e rregullt, pa deformime dhe nuk duhet të krijojë tendosje të tekstilit.



Përmasat e kapelës për masën M		
Lartësia e kupolës	17cm	
Perimetri i poshtëm i kurorës	57 cm	
Gjerësia e strehës	18 cm	
Gjatësia e strehës përpara	7 cm	

FJALA “POLICIA VULLNETARE”

Fjala “POLICIA VULLNETARE” duhet të qëndiset te pjesa ballore e kapelës, poshtë shenjës dalluese. Qëndisja duhet të jetë e drejtë, e plotë, e rregullt, pa deformime dhe nuk duhet të krijojë tendosje të tekstilit. Qëndisja duhet të jetë me fije poliestër prej materiali reflektiv fluoreshent ngjyrë gri.

Shkrimi nuk duhet të shtrembërohet ose të deformohet horizontalisht ose vertikalisht. Proporcionet e fjalës duhet të jenë rreptësisht sipas raporteve të përcaktuara të lloji i germës.

Germat duhet të jenë kapitale dhe lloji i germës duhet të jetë *Myriad Pro Bold*.

Fjala POLICIA VULLNETARE	Gjerësi	17 cm
	Lartësi	1.5 cm
	Lloji i germës	Myriad Pro Bold
	Ngjyra	Gri reflektive

KUSHTE TË DOMOSDOSHME

Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.

- Filli qepës duhet të ketë karakteristikat ekzakte të përcaktuara në specifikimet teknike;
- Tegelat e qepjes së kapelës duhet të jenë me hap 3 shpime në 1 cm;
- Tegelat duhet të jenë të drejta, uniforme, simetrike dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte;
- Tegelat duhet të jenë të forta dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12N;
- Tegelat duhet të jenë të përforcuara në ekstremitete;
- Të gjithë elementet e kapelës duhet të jenë simetrikë;
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstilit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, hekurosjes etj.);
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument;
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.



- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.

- Kufiri i lejuar i gabimit të përmasat e kapelës është $\pm 2\%$.

- Stema nuk duhet të pësojë ndryshime në model, ngjyrë, raporte dhe përmasa.

- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut, apo AZO ngjyres. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:

- EN ISO 14362-1:2017;

- EN ISO 14362-3:2017;

- EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0–9.0);

Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

Kapela duhet të pajiset me një etiketë prej tekstili, tek e cila duhet të shkruhet emri i fabrikës, viti i prodhimit, masa, përbërja, dhe instruksionet e mirëmbajtjes. Etiketa duhet të qepet te shiriti prej tekstili, në brendësi.

Në momentin e dorëzimit, kapelat duhet të jenë të pastra dhe të rregullta. Ato duhet të palosen dhe të paketohen në qese polietileni.

Artikulli duhet të pakëtohet me nga 50 kapela për kuti. Në çdo kuti duhet të vendosen kapela të së njëjtës masë. Çdo kuti duhet të ketë sasi të barabartë kapelash.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e kapelës, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluar me shirit ngjites (natriban).

ANEKS

Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve.

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore
	ose CEN ISO/TR 11827:2016 Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m ²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes.
Hollsia e fijeve	ISO 7211-5: 1984 Tekstilet - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 5: Përcaktimi i dendësisë lineare të fijeve të hequra nga pëlhura.



Dendësia	EN 1049-2 1993/ ISO 7211-2: 1984 Tekstile - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodën e analizës - Pjesa 2: Përcaktimi i numrit të fijeve për njësi të gjatësisë.
Qëndrueshmëria në N	EN ISO 13934-1:2013 Tekstile - Vetitë e pëlhurave në tërheqje - Pjesa 1: Përcaktimi i forcës maksimale dhe zgjatimit në forcën maksimale duke përdorur metodën shirit.
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06:2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi. (pas 5 cikle të larjes)
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04:2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 -X11 hekurosja 150°
	EN ISO 105-D01 Pastrimi kimik
	EN ISO 105 - X12 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2:2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në fërkim me metodën Martindale.
Këndi i rikuperimit pas ngjeshjes	EN 22313
Ndryshimi i dimensioneve në larje 60°	EN ISO 5077 pas 5 larjesh sipas EN ISO 6330 metoda 2A
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
Rezistenca ndaj ujit (Minimum)	EN 24920
Rezistenca ndaj Hidrokarbureve (padepertueshmëria ndaj vajrave) (Minimum)	EN ISO 14419
AZO Ngjyruet	EN ISO 14362-1:2017 EN ISO 14362-3:2017
pH	EN ISO 3071
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

4. MUSHAMA SHIU

**MATERIALET**

Materiali bazë që do të përdoret për prodhimin e artikullit *mushama shiu* duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	Blu të errët (evening blue) Spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349		
Përbërja %	100% poliamid	e veshur me shtresë poliuretani	
Thurja	Oxford		
Masa gr/m ² (± 5 %)	130 g/m ²		
Hollësia e fijos (± 5 %)	210D * 210D		
Përshkueshmëria e ujit	mbi 20,000 mm	≥ ISO 5	
Aftësia ajrosëse e tekstilit	mbi 15,000 g/m ² /24h	ajrosje shumë e mirë	Ret ≤ 6
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4 - 5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.	
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	Nota ≥ 6 (Shkalla blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.	
Qëndrueshmëria në fërkim	Mbi 50000 cikle		
Efekti pilling (kokërrzimi)	Nota 5		
AZO ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm		
pH	4.0–9.0		
Kujdes! Tekstili nuk duhet të ketë aroma të pakëndshme dhe nuk duhet të jetë i ashpër.			

Ngjyra e tekstilit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron ofertën teknike të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë e në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: e qëndrueshme – nota 4 – dhe shumë e qëndrueshme – nota 5. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: jo më pak se – nota 6: shumë e mirë.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në ofertën teknike do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë blu do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra blu nuk transferohet te tekstili i bardhë.


Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- Elemente Velcro që konsumohen shpejt gjatë përdorimit;
- Papastërtitë me origjinë bimore;
- Njolla vaji ose boje;
- Tonalitete të ngjyrës;
- Oksidime;
- Rudhosje;
- Mungesë të fijeve të indit dhe të bazës;
- Trashim të fijeve të indit dhe të bazës;
- Vrima në sipërfaqe;
- Dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

Materialet ndihmëse dhe aksesorët që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit mushama shiu.

Astarë			
Astar për xhepat	Përbërja	E zezë	
	Ngjyra	100% poliestër	
Aksesorë të tjerë			
 Elemente Velcro femër - mashkull	Përmasat Velcro për gjuhëzën e jakës 4 cm x 2 cm		
	Përbërja	100% fibra poliamide	
	Trashësia	2.2 mm	
	Masa lineare	41 g/m ± 5%	
	Ngjyra	njësoj si tekstili	
	Qëndrueshmëria në temperatura ekstreme		
	E ftohtë	- 30 °C	
	E nxehtë	pika e dobësimit	180 °C
		pika e shkrirjes	210–250°C
	Qëndrueshmëria e ngjyrës		
Në larje	jo më pak se 3		
Në ujë të nxehtë			
Në djersë			



Në fërkim		
Shirit për termosaldimin e qepjeve kryesore të mushamasë.	Shirit duhet të jetë me 3 shtresa: poliamid, PTFE, shtresë termoadesive	
	Ngjyra:	si tekstili
	Gjerësia:	2 cm
	Trashësia:	0.2 mm
	Shirit duhet të ketë ajrosje dhe rezistencë të lartë ndaj ujit.	
Filli		
Fill qepës për të gjitha qepjet, duhet të ketë këto të dhëna teknike:	Përbërja:	100% <i>poliamid</i>
	Numri metrik	80 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12 N
	Ngjyra	njësoj si tekstili
Perçina		
	10 copë + 1 rezervë	Nr. 27 (d 17 mm)
	Përbërja:	Tunxh (material aliazh bakër + zink)
	Ngjyra e perçinës:	Blu e erret pa shkëlqim.
	Kujdes! Perçina duhet të jetë e përshtatshme për tekstilin e produktit ku do të aplikohet.	
Shirit reflektiv		
Shirit reflektiv:	Ngjyra	gri argjendi
	Gjerësia	5 cm
	Përbërja	100 % poliamid
	Ky produkt duhet të jetë i certifikuar për aftësi të lartë reflektive sipas standardit EN ISO 20471	
	Shiriti duhet të rezistojë mbi 105 cikle larjeje në kushte shtëpie me temperature 60°C.	
	Shiriti duhet të duket nga një distancë prej mbi 150 mt	
Llastik tubolar		
	Përbërja e llastikut	100% poliestër



Llastik tubolar me element plastikë, për kapuçin e mushamasë. 	Përbërja e elementeve plastike	100% PVC
	Ngjyra	e zezë
	Perimetri	3 mm
Etiketa		
Etiketë prej tekstili për identifikimin e firmës prodhuese, masës, mirëmbajtjes dhe lëndës së parë.	Përbërja	100% palestër
	Ngjyra	e bardhë

Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit *mushama shiu*. Fotografitë e mëposhtme shërbejnë vetëm si shembull ilustrues.

	
1 qese polietilene për paketimin e mushamasë	1 qese polietilene për paketimin e perçinës metalike
1 kuti kartoni për paketimin e 30 mushamave	

Të gjithë mjetet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknikë nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli mushama shiu do të porositet dhe do të prodhohet në masat: XS–4XL, në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të policëve vullnetarë të Policisë së Shtetit. Mushamaja duhet të jetë e llojit unisex.

NGJYRAT REFERENCË



Ngjyra blu spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349 për tekstilin e mushamasë.

Ngjyra gri spektri sipas CIELCH 73, 0.743, 200.028 për shiritin reflektiv (fluoreshent).

Ngjyrat e paraqitura në këtë dokument shërbejnë si referencë për prodhuesin.

Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampionëve.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit mushama shiu.

MODELIMI (NDËRTIMI I KALLËPEVE)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën. Të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil në drejtim të fijeve të bazës.

PRERJA

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 100 fletë. Kujdes duhet të bëhet edhe në pjesët e harkuara të detajeve, që buzët e prera të mos jenë me dhëmbëza.

MARKIMI I PJESËVE PËRBËRËSE TË ARTIKULLIT

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detajet e mushamasë të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonalitete të dukshme.

NDËRTIMI I MUSHAMASË

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të mushamasë së shiut

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet në dokumentin e specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.



Mushama e Shiut

Mushamaja e shiut duhet të ketë prerje pardsyje dhe të qepet me tekstil prej 100% poliamidi, të padepërtueshëm nga uji dhe era.

Pjesët përbërëse të mushamasë:

- Dy pjesët e përparme;
- Pjesa e pasme;
- Jaka;
- Dy mëngë të gjata të tipit raglan;
- Një kapuç i lëvizshëm.

Mushamaja e shiut duhet të përmbushë standardet ndërkombëtare për përdorim nga punonjësit e policisë ose të sigurisë. Ajo duhet të jetë e pajisur me shirita fluoreshentë ngjyrë gri të hapur për vizibilitet



të lartë të trupi dhe krahët. Të gjithë tegelat qepës të mushamasë duhet të përforcohen me shirita termosaldimi.

Jaka e mushamasë duhet të jetë 10 cm e lartë, me gjuhëz, dhe mbyllja e saj duhet të bëhet me element Velcro femër/mashkull. Përmasat e gjuhëzës duhet të jenë 10x2.5 cm, ndërsa ato të elementit Velcro 4x2 cm.

Mbyllja e mushamasë duhet të bëhet me anë të 5 perçinave metalike. Bordura e perçinave duhet të jetë e mbuluar me kapak me gjerësi 6 cm. Buza e kapakut duhet të përshkohet nga një tegel linear njëgjilpërësh me distancë 5 mm. Mbi kapak duhet të qepet shiriti reflektiv me gjerësi 5 cm.

Xhepat

Mushamaja duhet të pajiset me dy xhepa të brendshëm me kapak dhe me gjerësi 19 cm. Përmasat e astarit të xhepit duhet të jenë 19x20 cm. Kapuçi duhet të kapet te jaka me 3 perçina metalike. Ai duhet të jetë i pajisur me llastik tubolar dhe me rregullator plastik për shtrëngimin e tij.

Mëngët duhet të jenë të llojit raglan dhe të qepen me trupin me tegel linear njëgjilpërësh.

Mëngët duhet të pajisen me perçina te parakrahët për shtrëngim. Te zona e manshetave duhet të qepet shiriti reflektiv me gjerësi 5 cm.

Mëngët dhe fundi i mushamasë duhet të mbyllen me një palosje të brendshme me lartësi 2 cm dhe me tegel linear njëgjilpërësh.

KUSHTE TË DOMOSDOSHME

Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit. Filli qepës duhet të ketë karakteristikat e përcaktuara në Specifikimet Teknike:

- Tegelat e qepjes të mushamasë duhet të jenë me hap 5 shpime në 1 cm;
- Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniforme, simetrike dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte;
- Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12 N;
- Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete;
- Tegelat qepës duhet të jenë me termosaldim;
- Të gjitha elementet e mushamasë duhet të jenë simetrike.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstilit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes etj.);
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument;
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit ultraviolett;
- Tekstili duhet të ketë veti hidrofobike;
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit;
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përshkueshmërisë së erës dhe ujit dhe të sigurojë ajrim të mirë të trupit (EN 343, klasa 3);
- Mushamaja duhet të jetë e lehtë për t'u mirëmbajtur;
- Kufiri i lejuar i gabimit të përmasat e mushamasë është $\pm 2\%$;
- Elementeve Velcro nuk duhet t'u dalin fijet anësore gjatë përdorimit të shpeshtë;
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruar. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:
- EN ISO 14362-1:2017;
- EN ISO 14362-3:2017;
- EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0–9.0).

Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.



AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

Mushamaja duhet të pajiset me një etiketë prej tekstili, në të cilën duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, masa, përbërja, dhe instruksionet e mirëmbajtjes.

Etiketa duhet të qepet poshtë, në anën e djathtë të mushamasë, te tegeli që bashkon pjesën e përparme dhe pjesën e pasme të saj. Etiketa duhet të jetë e palosur. Në njëërën anë duhet të shënohen instruksionet e mirëmbajtjes dhe në anën tjetër duhet të shënohet ky informacion: emri i firmës prodhuese, viti i prodhimit, emri i artikullit, masa dhe gjinia.

Një perçinë rezervë do të futet në një qese të vogël polietileni dhe do të kapet me një shirit të hollë plastik, në etiketën e mirëmbajtjes.

Në momentin e dorëzimit, mushamatë duhet të jenë të pastra, pa njolla dhe të palosura.

Mushama e palosur duhet të futet në një qese polietileni. Në çdo kuti duhet të vendosen mushama të së njëjtës masë. Çdo kuti duhet të ketë një sasi të barabartë mushamash.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 g/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet të shënuar masa e mushamasë, viti i prodhimit, sasia dhe emri i kompanisë furnizuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).

ANEKS

Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve.

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore ose CEN ISO/TR 11827:2016 Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura
Hollësia e fijes	ISO 7211-5: 1984 Tekstilet - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 5: Përcaktimi i dendësisë lineare të fijeve të hequra nga pëlhura.
Masa g/m ²	ISO 3801:1977/EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes EN ISO 2286-2:2016 Tekstile të gomuar ose të plastifikuara - Pjesa 2: Metodat për përcaktimin e masës së përgjithshme për njësi të sipërfaqes, masës për njësi të veshjes të sipërfaqes dhe masës për njësi të shtresave
Përshkueshmëria e ujit (presioni hidrostatik)	EN ISO 4920:2012 Pëlhura tekstili - Përcaktimi i qëndrueshmërisë në njomjen sipërfaqësore (prova me sprucim) EN 20811/ EN ISO 811:2018 Tekstile - përcaktimi i qëndrueshmërisë ndaj depërtimit të ujit - testi nën presionin hidrostatik
Aftësia ajrosëse e tekstilit	EN ISO 11092:2014 Tekstile - Efektet fiziologjike - Matja e qëndrueshmërisë termike nën ndikimin e avujve të ujit në kushte të qëndrueshme (prova e pjatës së nxehtë të mbrojtur nga djersitja)



Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi (pas 5 ciklesh të larjes)
	EN ISO 105 - E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01:
	Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04:2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në fërkim me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
Materialet reflektive	EN ISO 20471: 2013/A1:2016 Standardi për shiritat reflektive dhe veshjet për sigurinë në punë.
AZO Ngjyrues	Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve: EN ISO 14362-1:2017 EN ISO 14362-3:2017
pH	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

5. ÇIZME SHIU (LLASTIKU)



Artikulli çizme shiu (llastiku) do të porositet dhe do të prodhohet në masat: 36–47 në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të policëve vullnetarë të Policisë së Shtetit. Çizmet duhet të jenë të llojit unisex.

Çizmet

Çizmet duhet të plotësojnë kërkesat dhe karakteristikat fiziko-mekanike dhe kimike të specifikuara në standardet ndërkombëtare për veshjet profesionale, si EN ISO 20347 ose ekuivalentet.

Materiali i çizmeve

Çizmet e shiut duhet të prodhohen prej materialit 50% Polivinil Kloruri (PVC) dhe 50% Nitrile. Pjesa e brendshme duhet të jetë e veshur me astar prej tekstili me përbërje 100% Poliamid. Sipërfaqja e jashtme duhet të trajtohet me një shtresë antihidrokarbureve dhe kundër ujit, duke mundësuar që pastërtitë dhe balta të mos ngjiten lehtë.

Karakteristikat e çizmeve

Çizmet duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme:


- Thembrë të mbuluar;
- Maje mbrojtëse çeliku 200 joule;
- Vetë antistatike;
- Vetë absorbuese të energjisë të zona e thembrës;
- Rezistencë ndaj shpimeve;
- Rezistencë ndaj përshkueshmërisë dhe thithjes së ujit;
- Rezistenca e shollës ndaj kontaktit në të nxehtë;
- Rezistenca e shollës ndaj hidrokarbureve, vajrave dhe acideve;
- Rezistenca e shollës ndaj rrëshqitjes;
- Ngjyra e çizmeve duhet të jetë e zezë;
- Gjatësia e çizmeve duhet të jetë rreth 40 cm;
- Testimi i Materialeve dhe Aksesorëve.

Materialet dhe aksesorët e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyrues. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve:

- EN ISO 17234-1:2015;
- EN ISO 17234-2:2011;
- EN ISO 4045:2018.

Afati i dorëzimit

Afati i dorëzimit në magazinë nga data e prodhimit të këpucës nuk duhet të jetë më i lartë se 12 muaj.

6. BILBIL

Bilbili duhet të jetë prej materiali çelik i pandryshkshëm dhe të ketë ngjyrë argjendi. Duhet të jetë i pajisur me një lidhëse me ngjyrë të zezë me material me përbërje 100% Poliamid. Përmasat e bilbilit duhet të jenë 45 x 18 x 20 mm.

Pesha e tij të jetë rreth 12 gram.

Niveli i zërit ≥ 120 Db.


7. ELEKTRIK DORE



Elektrik dore i karikueshëm me 2 bateri. Përbëhet nga material rezistent alumini. Burimi i dritës: LED BULB

Me mundësi: ZOOM Distanca e hedhjes së dritës: 500 metra fuqia: 3800 lumen, i pajisur me karikues për bateritë kohëzgjatja e baterisë: 30 orë.

8. TABELË DORE “STOP”



Lidhur me karakteristikat dhe modelin, tabela e dorës “STOP”, do të ketë të shkruar “POLICIA VULLNETARE” (ose poshtë përcaktimit “POLICIA E SHQIPERISE”, ose në vend të këtij përcaktimi).

**VENDIM****Nr. 294, datë 28.5.2025****PËR MIRATIMIN E PARAQITJES,
FORMËS DHE SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE TË GRADAVE, SIMBOLEVE,
UNIFORMAVE DHE SHENJAVE
DALLUESE, DOKUMENTIT DHE
MEDALJONIT ZYRTAR TË
IDENTITETIT TË POLICISË
SË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 67 e 135, pikat 2 e 4, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e paraqitjes, formës dhe specifikimeve teknike të gradave, simboleve, uniformave dhe shenjave dalluese, dokumentit dhe medaljonit zyrtar të identitetit të Policisë së Shtetit, sipas albumit me 87 (tetëdhjetë e shtatë) faqe, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Paraqitja, forma dhe specifikimet teknike të gradave janë përcaktuar dhe janë përshkruar në lidhjen nr. 1 të albumit.

3. Simbolet e Policisë së Shtetit janë flamuri dhe stema, të përcaktuara e të përshkruara në lidhjen nr. 2 të albumit.

4. Uniformat që përdoren nga punonjësit e Policisë së Shtetit janë:

a) uniforma bazë në detyrë:

i. dimërore;

ii. verore;

b) uniforma për stërvitje dhe shërbime;

c) uniforma për shërbimet e veçanta;

ç) uniforma për struktura të veçanta;

d) uniforma ceremoniale;

dh) veshja civile që konvertohet në vlerë monetare;

e) uniforma civile për zyrat e pritjes së qytetarëve.

Llojet e uniformës dhe normat e furnizimit me uniformë janë të përcaktuara në lidhjen nr. 3 të albumit dhe në aneksin nr. 1, pjesë përbërëse e kësaj lidhjeje.

5. Shenjat dalluese sipas shërbimeve të Policisë së Shtetit do të jenë, si më poshtë vijon:

a) Shenjë në krah “Logo e Policisë së Shtetit”;

b) Shenjë në krah “Policia e Rendit”;

c) Shenjë në krah “Shqiponjat”;

ç) Shenjë në krah për kufirin dhe migracionin “Policia Kufitare”;

d) Shenjë në krah “Policia Rrugore”;

dh) Shenjë në krah e Njesisë Speciale “RENEA”;

e) Shenjë në krah e Njesisë Speciale të NEGOCIIMIT;

ë) Shenjë në krah e Njesisë speciale “ANTIEXPLOZIV”;

f) Shenjë në krah e Forcës Kombëtare të Sigurisë – FKS;

g) Shenjë në krah e Njesisë Speciale “Antiterrori”;

gj) Shenjë në krah e Policisë Shkencore;

h) Shenjë në krah e Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale;

i) Shenjë në krah e Policisë Kriminale;

j) Shenjë në krah e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare;

k) Shenjë në krah “Akademia e Sigurisë”;

l) Shenja për studentin/kursantin;

ll) Shenja për mbiemrin/numrin e identifikimit (RMIS);

m) Shenja e kapelës “Emblema”;

n) Shenja e jakës “Përkrenare e Skënderbeut e stilizuar”;

nj) Shiriti i kapelës dhe kopsat me ngjyrë të artë;

o) Shiriti i medaljeve.

Shenjat dalluese të Policisë së Shtetit, të përmendura më sipër, janë të përcaktuara dhe të përshkruara në lidhjen nr. 4 të albumit.

6. Punonjësi i Policisë së Shtetit pajiset me dokumentin dhe medaljonin zyrtar të identifikimit. Forma, përmasat dhe të dhënat që përmban dokumenti identifikues dhe medaljoni zyrtar i identitetit të punonjësit të Policisë së Shtetit janë të përcaktuara dhe të përshkruara në lidhjen nr. 5 të albumit.

7. Gradat, simbolet, uniformat, shenjat, dokumenti dhe medaljoni zyrtar identifikues të Policisë së Shtetit, të miratuara sipas këtij vendimi, për nga qëllimi i përdorimit, janë pronë e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe përdoren vetëm gjatë shërbimit ose për shkak të tij nga punonjësit e Policisë së Shtetit.

8. Gradat, simbolet, uniformat, shenjat, dokumenti dhe medaljoni zyrtar identifikues i Policisë së Shtetit janë të patjetërsueshme.



9. Ndalohen shumëfishimi dhe realizimi i modeleve e ngjyrave të tyre për përdorues të organizatave të tjera publike apo private, që trajtohen me uniformë, të cilat nuk kanë të njëjtin mision dhe detyra që ka Policia e Shtetit.

10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për programin “Policia e Shtetit”.

11. Vendimi nr. 55, datë 27.1.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e paraqitjes, formës dhe specifikimeve teknike të gradave, simboleve, uniformave dhe shenjave të Policisë së Shtetit”, të ndryshuar, shfuqizohet.

12. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

GRADAT, SIMBOLET, UNIFORMAT DHE SHENJAT E POLICISË SË SHETIT

PARATHËNIE

“Uniformat e policisë si vlerë shpirtërore e një kombi, si vlera më e rëndësishme e Policisë së Shtetit”.

Përdorimi i uniformës përbën prezantimin publik të strukturave të Policisë së Shtetit.

Kjo sjell detyrime si në mënyrën e paraqitjes së uniformës ashtu dhe në qëndrimin, dhe veprimin personal të mbajtësit.

PËRMBAJTJA

Lidhja nr. 1 Paraqitja, forma dhe specifikimet teknike të gradave të Policisë së Shtetit

Lidhja nr. 2 Simbolet e Policisë së Shtetit

Lidhja nr. 3 Llojet e uniformave të Policisë së Shtetit

Lidhja nr. 4 Shenjat e Policisë së Shtetit

Lidhja nr. 5 Dokumenti dhe medaljoni zyrtar identifikues i Policisë së Shtetit

Aneksi nr. 1, i lidhjes nr. 3 Normat e furnizimit me uniformë dhe veshje civile

Lidhja nr. 1

GRADAT E POLICISË SË SHETIT

PARAQITJA, FORMA DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE TË GRADAVE TË POLICISË SË SHETIT

Gradat sipas nenit nr. 65, të ligjit nr. 82/2024, datë 26.7.2024, “Për Policinë e Shtetit”, ndahen sipas rendit hierarkik rritës dhe emërtohen si më poshtë:

1. Inspektor;
2. Nënkomisar;
3. Komisar;
4. Kryekomisar;
5. Drejtues;
6. Drejtues i Parë;
7. Drejtues i Lartë;
8. Drejtues Madhor.


PARAQITJA DHE FORMA

Modelet e gradave në Policinë e Shtetit sjellin përmirësime cilësore në vlerat estetike e përdoruese të uniformës së policisë, duke rritur dinjitetin e punonjësve të Policisë së Shtetit.

Gradat e Policisë së Shtetit nga paraqitja dhe forma janë të ndara, si më poshtë:

- Grada spaleti shërbimi;
- Grada spaleti ceremoniale;
- Grada gjoksi shërbimi.

NGJYRAT REFERENCË



Ngjyra blu për bazën e gradës sipas spektrit CIELCH 18, 14.587, 295.349.

Ngjyra e kuqe për kornizën anësore sipas spektrit CIELCH 41, 70.780, 28.754.

Ngjyra e artë për elementet plastike, elementet me qëndisje dhe tekstilin prej mëndafshi sipas spektrit CIELCH 72, 63.619, 74.057.

PËRMASAT E GRADAVE

Bazamenti i gradës ka pamje të sipërme trapezoidale dhe duhet të ketë këto përmasa:

- nga rangu *Inspektor* deri tek rangu *Drejtues i Parë*, gjatësia e gradës duhet të jetë 90 mm ndërsa gjerësia e trapezit – 60 mm baza e madhe dhe 52 mm baza e vogël;
- për rangjet *Drejtues i Lartë* dhe *Drejtues Madhor*, gjatësia e gradës duhet të jetë 105 mm ndërsa gjerësia e trapezit – 60 mm baza e madhe dhe 52 mm baza e vogël.

Kujdes!!! Toleranca e dimensionit apo e pozicionimit të elementeve të gradave është ± 1 mm.

GRADË SPALETI SHËRBIMI “INSPEKTOR”



GRADË SPALETI CEREMONIALE “INSPEKTOR”



GRADË GJOKSI “INSPEKTOR”





GRADË SPALETI SHËRBIMI “NËNKOMISAR”



GRADË SPALETI CEREMONIALE “NËNKOMISAR”




GRADË GJOKSI “NËNKOMISAR”



GRADË SPALETI SHËRBIMI “KOMISAR”



GRADË SPALETI CEREMONIALE “KOMISAR”







GRADË GJOKSI “KOMISAR”



GRADË SPALETI SHËRBIMI “KRYEKOMISAR”





GRADË SPALETI CEREMONIALE “KRYEKOMISAR”



GRADË GJOKSI “KRYEKOMISAR”



GRADË SPALETI SHËRBIMI “DREJTUES”





GRADË SPALETI CEREMONIALE “DREJTUES”



GRADË GJOKSI “DREJTUES”



GRADË SPALETI SHËRBIMI “DREJTUES I PARË”



GRADË SPALETI CEREMONIALE “DREJTUES I PARË”




GRADË GJOKSI “DREJTUES I PARË”






GRADË SPALETI SHËRBIMI “DREJTUES I LARTË”




GRADË SPALETI CEREMONIALE “DREJTUES I LARTË”



GRADË GJOKSI “DREJTUES I LARTË”



GRADË SPALETI SHËRBIMI “DREJTUES MADHOR”



GRADË SPALETI CEREMONIALE “DREJTUES MADHOR”



GRADË GJOKSI “DREJTUES MADHOR”



Lidhja nr. 2

SIMBOLET E POLICISË SË SHTETIT

FLAMURI I POLICISË SË SHTETIT



Flamuri i Policisë së Shtetit është i përbërë nga dy pjesë.

- Pjesa valëvitëse e flamurit:

Ka formë drejtkëndore me përmasa në raport 1:1.4, i ndarë vertikalisht në dy pjesë të barabarta blu dhe e kuqe. Në qendër është vendosur shqiponja dykrenare, sipas modelit të flamurit kombëtar, e ndarë vertikalisht në dy pjesë të barabarta, e kuqe dhe e zezë. Mbi shqiponjë është vendosur përkrenarja e Skënderbeut, me ngjyrë të artë, e stilizuar sipas figurës.

Poshtë shqiponjës, shkrimi “**POLICIA E SHTETIT**” me ngjyrë të artë.**Pjesa jovalëvitëse e flamurit:**

Përbëhet nga një shtizë cilindrike, me majë, sipas figurës ngjyrë ari.

STEMA E POLICISË SË SHTETIT



Kompozimi i stemës përbëhet nga mburoja (shqyt), e cila është e ndarë vertikalisht në dy pjesë të barabarta blu dhe të kuqe. Në qendër të shqytit shqiponja dykrenare me përkrenaren e Skënderbeut të vendosur sipër saj, të dyja me relief dhe të stiluara sipas figurës. Në gjoks të shqiponjës është vendosur një mburojë (shqyt) e vogël, e kuqe, e cila në qendër ka shqiponjën e zezë të flamurit kombëtar.

Në pjesën e sipërme të mburojës (shqytit), është vendosur shkrimi “**POLICIA E SHTETIT**”, ngjyrë ari.

Përreth mburojës (shqytit) kornizë ari.

Lidhja nr. 3

UNIFORMAT E POLICISË SË SHTETIT

4.1 Uniforma bazë në detyrë

4.1 Uniforma ndahet në:

- a) dimërore;
- b) verore.

4.1.a Uniforma bazë në detyrë dimërore, përbëhet nga artikujt e mëposhtëm:

- xhup shërbim treçereksh me veshje të ngrohtë;
- xhup shërbimi (me veshje të ngrohtë);
- kostum uniforme meshkuj (2 kapela, 1 xhaketë, 2 palë pantallona);
- kostum uniforme meshkuj/femra (2 kapela, 1 xhaketë, 1 palë pantallona dhe 1 fund);
- pulovër e trikotuar jakë “V”/pulovër me jakë gjysmë golf;
- këmishë bojë qielli me mëngë të gjata për meshkuj/femra;
- kravatë blu uniforme;
- këpucë dimërore për meshkuj dhe femra;
- rrip pantallonash;
- rrip multifunksional;
- jelek multifunksional;
- pelerinë shiu;
- doreza lëkure.

4.1 a) UNIFORMA DIMËRORE

Xhup shërbimi treçereksh me veshje të ngrohtë;



Xhup shërbimi (me veshje të ngrohtë)





Kostum uniforme meshkuj
(2 kapele, 1 xhaketë, 2 palë pantallona)



Kostum uniforme femra
(2 kapele, 1 xhaketë, 1 palë pantallona dhe 1 fund)



Pulovër e trikotuar Jakë "V"



Pulovër e trikotuar jakë gjysëm golf



Këmishë bojqielli me mëngë të gjata meshkuj/femra



Kravatë blu uniforme



Rrip pantalloni



Këpucë dimërore Meshkuj/femra



Pelerin shiu



Jelek multifunksional



Doreza lëkurë



Rrip multifunksional



4.1.b Uniforma bazë në detyrë verore, përbëhet nga artikujt e mëposhtëm:

- këmisha bojë qelli me mëngë të shkurtra meshkuj/femra;
- bluzë polo me mëngë të shkurtra për punonjësit e Policisë së Shtetit;
- pantallona vere për meshkuj/femra;
- fund për femra;
- kapelë klasike verore meshkuj/femra;
- këpucë verore për meshkuj/femra.

Këmishë bojëqelli me mëngë të shkurtra
meshkuj/femraPantallona vere
meshkuj/femra

Fund për femra



Bluzë POLO me mëngë të shkurtra meshkuj/femra



Kapele verore meshkuj/femra



Meshkuj

Femra

Këpucë verore meshkuj/ femra



Meshkuj



Femra

4.2 UNIFORMA PËR STËRVITJE E SHËRBIME

Uniforma për stërvitje e shërbime përbëhet si nga artikujt, si më poshtë:

- kostum doku stërvitjeje (xhaketë, pantallona, kapelë tip sport);
- këmishë doku me mëngë të shkurtra rip stop;
- bluzë pambuku me jakë të rrumbullakët m. të gjata;
- bluzë pambuku me jakë të rrumbullakët m. të shkurtra;
- këpucë taktike dimërore.

Kostum doku stërvitje
(Xhaketë, pantallona, kapele tip sport)



Këmishë doku mëngë të shkurtra rip stop;



Bluzë pambuku jakë rrumbullakët,
mëngë të gjata



Bluzë pambuku jakë rrumbullakët
mëngë të shkurtra



Këpucë taktike dimërore



4.3. UNIFORMA PËR SHËRBIME TË VEÇANTA

1. Uniforma për Patrullën e Përgjithshme, Policinë Rrugore dhe Patrullën “Shqiponja” ndahet në dimërore dhe verore

a) Uniforma dimërore përbëhet, si më poshtë:

- kostum dimëror për patrullat dhe motoçiklistët (xhup me veshje të ngrohtë, pantallona rip stop dhe kapelë tip sport);
- pulovër me jakë rrumbullake;
- xhup me vizibilitet të lartë (vetëm për policinë rrugore);
- aksesore me vizibilitet të lartë mëngore dhe mbulesa e kapelës (vetëm për policinë rrugore);
- doreza motoçiklisti (për patrullat me motoçikleta);
- këpucë taktike dimërore;

b) Uniforma verore përbëhet si më poshtë:

- Pantallona doku rip stop;
- Bluzë polo, mëngë e shkurtër;
- Bluzë polo, mëngë e gjatë;
- Jelek me vizibilitet të lartë sipas shërbimeve (blu për patrullë të përgjithshme, i gjelbër për policinë rrugore dhe i kuq për shqiponjat);
- Kapelë tip sport;
- Këpucë taktike vere.



1. a) UNIFORMA DIMËRORE

**Kostum dimëror
për patrulla dhe motoçiklistët**
(xhup, pantallona rip stop dhe kapele tip sport);




Pulovër me jakë rrumbullake



Xhup me vizibilitete të lartë
(vetëm policinë rrugore)



Mëngore dhe mbulesë kapeleje
(vetëm policinë rrugore)



Këpuçë taktike dimërore.



Doreza motoçilisti



1. b) UNIFORMA PËR SHËRBIME TË VEÇANTA VERORE

Pantallona doku rip stop



Bluzë Polo mëngë e shkurtër



Bluzë Polo mëngë e gjatë



Kapele tip sport



Jelek me vizibilitet të lartë sipas shërbimeve (blu, i gjelbër dhe i kuq i cili vishet në çdo stinë).

Patrullë e Përgjithshme



Policia Rrugore



Patrullë Shqiponja



Këpuçë taktike vere



2. UNIFORMA PËR PATRULLË QË KRYEJNË SHËRBIMIN NË PLAZHE GJATË SEZONIT TURISTIK VEROR

Uniforma për patrullat që kryejnë shërbimin në plazhe përbëhet si më poshtë:

- Bluzë Polo e bardhë;
- Pantallona të shkurtra ripstop;
- Këpucë taktike për patrulla në plazhe
- Kapele tip sport

Bluzë Polo e bardhë



Pantallona të shkurtra ripstop meshkuj/femra



Këpucë taktike për patrulla në plazhe



Kapele tip sport

**3. UNIFORMA PËR MJETET UJORE**

Uniforma për patrullat që kryejnë shërbimin në plazhe përbëhet si më poshtë:

- a) Jelek Shpëtimi për mjetet ujore
- b) Uniforma për mjetin lundrues “Jet-Ski”

a) Jelek Shpëtimi për mjetet ujore



b) Uniforma për mjetin lundrues “Jet-Ski”

- Kostum për “Jet ski”;
- Jelek shpëtimi;
- Kapele tip sport

Kostum për “Jet ski**Jelek shpëtimi****Kapele tip sport****4.4 UNIFORMA TË STRUKTURAVE TË VEÇANTA**

1. Uniforma e Forcave Speciale “RENEA” është e ndarë, si më poshtë:

a) Uniforma operationale:

- xhup dimri;
- xhup shiu;
- pantallona shiu;
- xhup taktik;
- xhaketë taktike (2 modele);
- pantallona taktike (2 modele);
- bluzë taktike (2 modele);
- doreza taktike;
- maskë operationale;
- kapuç leshi;
- rrip operational;
- rrip taktik;
- këpucë taktike dimërore;
- këpucë me qafa;

b) Uniforma për trajnime:

- xhup trajnimi;
- xhaketë trajnimi;
- pantallona trajnimi;
- bluzë trajnimi;
- kapelë trajnimi;
- këpucë trajnimi;

c) Uniforma civile:

- jelek operational civil;
- pantallona operationale civile.



a) UNIFORMA OPERACIONALE

Xhup dimri



Xhup shiu



Pantallona shiu



Xhup taktik



Xhaketë taktike
modeli 1



modeli 2



Pantallona taktike
modeli 1



modeli 2



Bluzë taktike
modeli 1



modeli 2



Doreza taktike



Maskë operacionale



Kapuç leshi



Rrip operacional



Rrip taktik



Këpuçë taktike dimërore



Këpuçë me qafa



b) UNIFORMA OPERACIONALE PËR TRAJNIME

Xhup trajnimi



Xhakëtë trajnimi



Pantallona trajnimi



Bluzë trajnimi



Kapele trajnimi



Këpucë trajnimi



c) UNIFORMA OPERACIONALE CIVILE

Jelek operacional civil



Pantallona operationale civile



2. UNIFORMA FORCA KOMBËTARE E SIGURISË (FKS)

Uniformat e Forcës Kombëtare të Sigurisë ndahen në uniformë dimërore dhe verore

a) Uniforma dimërore:

- xhup shërbimi me veshje të ngrohtë;
- kostum doku rip-stop (xhakëtë, pantallona dhe kapelë tip sport);
- bluza pambuku me mëngë të gjata, jakë rumbullake;
- pulovër e trikotuar me jakë 1/2 golf;
- këpucë taktike dimërore;
- rrip multifunksional;
- jelek multifunksional;
- kapuç leshi;
- maska operationale;

b) Uniforma verore:

- bluza polo me mëngë të shkurtra;

- pantallonat doku rip stop;
- bluza pambuku jakë rrumbullake me mëngë të shkurtra;
- kapelë tip sport;
- këpucë taktike verore me qafa.

a) UNIFORMA DIMËRORE :

Xhup shërbimi me veshje të ngrohtë;

Kostum doku rip-stop,
(xhaketë, pantallona dhe kapele tip sport)Bluza pambuku, jakë rrumbullake
me mëngë të gjata

Pulovër e trikotua me jakë ½ golf,



Kapuç leshi,



Jelek multifunksional, ;



Rripi multifunksional,;



Maska operacionale



Këpucë taktike dimërore





b) UNIFORMA VERORE :

Bluza Polo me mëngë të shkurtra;



Pantallonat doku rip stop;

Bluza pambuku jakë rumbullakë;
me mëngë të shkurtra

Kapele tip sport;



Këpucë taktike verore me qafa



3. UNIFORMA PREZANTUESE E POLICISË KRIMINALE

Uniforma prezantuese e Policisë Kriminale është si më poshtë

- a) Jelek prezantues i Policisë Kriminale;
- b) Kapele tip sport.

Jelek prezantues i Policisë Kriminale



Kapele tip sport



4.5 UNIFORMA CEREMONIALE

1. Pjesët përbërëse të uniformës ceremoniale janë si vijon:

- a) Këmishë e bardhë ceremoniale meshkuj/femra
- b) Doreza ceremoniale
- c) Rrip ceremoniali.

1.1 Dekoracionet janë si vijojnë:

- a) Gradat spaleti ceremoniali;
- b) Kordon kapele dhe supi sipas shërbimeve dhe gradave.



Këmishë e bardhë ceremoniale meshkuj / femra



Doreza ceremoniale



Rrip ceremoniali



KORDON KAPELE DHE SUPI CEREMONIALE SIPAS SHËRBIMEVE DHE GRADAVE.

Ngjyrat e kordonëve sipas strukturave nga grada Inspektor - Kryekomisar				
Ngjyra e kordonit të Strukturave të Sigurisë Publike në Policinë e Shtetit	Ngjyra e kordonit të Policisë Rrugore	Ngjyra e kordonit të Policisë Kufitare dhe Migracionit	Ngjyra e kordonit të Repartit dhe Trupës Ceremoniale	Ngjyra e kordonit të Akademisë së Sigurisë, Policisë Kriminale, Drejtorisë së Përgjithshme të Hetimit të Krimit dhe Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse
Bojëqielli	E verdhë	E gjelbër	E artë	E argjendtë
				

Ngjyrat e kordonëve sipas strukturave nga grada Drejtues -Drejtues Madhor				
Ngjyra e kordonit metalik të kapeles për rangun Drejtues-Drejtues i Parë	Ngjyra e kordonit metalik të kapeles të rangut Drejtues i Lartë-Drejtues Madhor	Ngjyra e kordonit metalik të supit të Rangut Drejtues -Drejtues Madhor	Elementë dekorativ për strehën e kapeles	
E artë	E artë	E artë	E artë	
				

4.6 Veshja civile

Veshja civile, e cila konvertohet në vlerë monetare, përbëhet nga këta artikuj:

- pallto/xhup;
- kostum civil (xhaketë dhe pantallona);
- këmishë me mëngë të gjata;
- këmishë me mëngë të shkurtra;
- kravatë;
- këpucë gjysma.

4.7 UNIFORMA CIVILE

Uniforma civile për Zyrat e Shoqërimit të Qytetarëve (Z.SH.Q.) përbëhet nga këta artikuj:

- Kostum civil për meshkuj (xhakët dhe pantallona);
- Kostum civil për femra (xhakët dhe fund);
- Këmishë civile me mëngë të gjata meshkuj/femra;
- Këmishë civile me mëngë të shkurtra meshkuj/femra;
- Kravatë;
- Shall për femra.



Lidhja nr. 4

SHENJAT E POLICISË SË SHTETIT

6.1 Shenjat dalluese të Policisë së Shtetit që vendosen në objektet e uniformës, sipas shërbimeve

a. SHENJË KRAHU “LOGO E POLICISË SË SHTETIT”

Mburoja (shqyti) blu me kornizë të kuqe. Në pjesën e sipërme të mburojës (shqytit) në fushë të kuqe fjala “POLICIA”.

Në fushë shqiponja dykrenare dhe përkrenarja e Skënderbeut me profil djathtas me ngjyrë të artë të shndritshme.



b. SHENJË KRAHU “POLICIA E RENDIT”



Mburojë (shqyt) e ndarë vertikalisht në dy pjesë, e kuqe dhe e zezë, me kornizë të artë. Në pjesën e sipërme të mburojës (shqytit) janë shkruar fjalët “**POLICIA E RENDIT**” të arta.

Brenda mburojës (shqytit) një mburojë (shqyt) më e vogël blu me kornizë të artë. Brenda tij në qendër një shpatë e argjenditë e vendosur vertikalisht dhe përkrenarja e Skënderbeut e artë.

c. SHENJË KRAHU “SHQIPONJAT”



Mburojë (shqyt) e kuqe, në qendër kokë shqiponje e zezë me shikim majtas, me sqep dhe gjuhë të artë. Në pjesën e sipërme të mburojës (shqytit) fjala “**SHQIPONJAT**” e artë.

Në 1/3 e poshtme të mburojës (shqytit), trekëndësja blu dhe të kuq të ndërhurur.



d. SHENJË KRAHU- KUFIRIN DHE MIGRACIONIN



Mburojë (shqyt) e zezë, me kornizë të artë. Në pjesën e sipërme të mburojës (shqytit) në fushë të kuqe fjalatë **“POLICIA KUFITARE”** me ngjyrë të artë.

Në qendër një mburojë (shqyt), më i vogël i blertë, me hartën e Shqipërisë, ngjyrë gri.

e. SHENJË KRAHU “POLICIA RRUGORE”



Mburojë (shqyt) e zezë, me kornizë të kuqe. Në pjesën e sipërme të shqytit motiv shahu bardhë e zi.

Në pjesën e poshtme të mburojës (shqytit), fjalatë **“POLICIA RRUGORE”** ngjyrë e verdhë flurishente.

Në qendër, një mburojë (shqyt) më e vogël ngjyrë e verdhë flurishente me një pishtar blu me flakë të kuqe dhe një rrotë.



f. SHENJË KRAHU- E NJËSISË SPECIALE – RENE A



Mburojë (shqyt) jeshile me kornizë me ngjyrë të zezë dhe gri, me cepin e sipërm të majtë të ngrënë.

Në fushë, krah i majtë që del nga e djathta, i armuar, gri, që shtrëngon një rrufë me ngjyrë gri.

Poshtë, në shirit horizontal gri, inicialet “RENEA” me ngjyrë të zezë.

g. SHENJË KRAHU-NJËSIA SPECIALE E NEGOCIMIT



Mburojë (shqyt) jeshile me kornizë me ngjyrë të zezë dhe gri, me cepin e sipërm të majtë të ngrënë.

Në fushë, shqiponja e flamurit kombëtar me ngjyrë të zezë, dy duar të bardha të bashkuara, rrufeja e vendosur mbi duar, në pjesën e parakrahut me ngjyrë të zezë është vendosur aparati telefonik dhe valët me ngjyrë ari.

Poshtë në shirit horizontal gri, fjala “NEGOCIMI” me ngjyrë të zezë.

h. SHENJË KRAHU-NJËSIA SPECIALE ANTIEKSPLOZIV



Mburojë (shqyt) me ngjyrë blu me kornizë ngjyrë gri. Në pjesën e sipërmë fjala “POLICIA” dhe në pjesën e poshtme fjala

“ANTI EKSPLOZIV” me ngjyrë të bardhë.

Në brendësi të shqytit ndodhet një shqyt më i vogël me ngjyrë jeshile të hapur i kornizuar me shirit të hollë me ngjyrë të kuqe. Në krah të shqytit janë vendosur dy yje të bardhë.

Në qendër të shqytit të vogël vendoset harta e Shqipërisë me ngjyrë gri, Shqiponja e zezë dykrenare, një predhë me ngjyrë gri, një rrufë me ngjyrë të verdhë dhe dy degë ulliri të kryqëzuara me ngjyrë gri në pjesën e poshtme të shqiponjës.



i. Shenjë krah- FORCA KOMBËTARE E SIGURISË – FKS



Mburojë (shqyt) e kuqe me kornizë të artë, me cepin e sipërm të majtë të ngrënë.

Në fushë, krah i majtë që del nga e djathta, i armuar, ngjyrë gri, që shtrëngon një shigjetë ngjyrë e artë me majën lart.

Poshtë, në shirit horizontal blu inicialet “F K S” me ngjyrë të artë.

j. SHENJË KRAHU-NJËSIA SPECIALE ANTITERRORI



Mburoja (shqyt) blu e kornizuar me ngjyrë të artë. Në pjesën e sipërmë fjala “ANTITERRORI” dhe në pjesën e poshtme fjalët “POLICIA E SHTETIT”, me ngjyrë të artë.

Në brendësi të shqytit ndodhet një shqyt më i vogël ngjyrë të kuqe, Shqiponja dykrenare me krahë të hapur anash, në gjoksin e saj një mburojë (shqyt), në qendër dielli që shkëlqen dhe Përkrenarja e Skënderbeut, në profil djathtas.

Shqiponja në kthetrën e djathtë mban një shpatë e drejtë me dy tehe dhe në kthetrën e majtë mban një degë ulliri me ngjyrë të artë.



k. Shenjë krahu- POLICIA SHKENCORE



Mburojë (shqyt) me ngjyrë blu dhe të kuqe e kornizuar me ngjyrë të artë.

Në pjesën e sipërme fjalët: **“POLICIA SHKENCORE”** në ngjyrë të artë.

Në brendësi të shqytit ndodhet një shqyt më i vogël me tonalitet ngjyrë të zezë, një gjurmë papilare gishti, peshorja e drejtësisë ku si trup ka simbolin e zinxhirit të AND-së, mikroskopi dhe shifrat “0100001101”.

l. Shenjë krahu- DREJTORIA E FORCËS SË POSAÇME OPERACIONALE



Mburojë (shqyt) me ngjyrë të kuqe dhe e kornizuar me dy shirita të hollë me ngjyrë të artë dhe në mes tyre një shirit me ngjyrë të zezë. Në pjesën e sipërme janë vendosur 7 (shtatë) yje me ngjyrë blu, poshtë yjeve fjalët **“POLICIA KRIMINALE”** dhe në pjesën e poshtme inicialet **“DFPO”** me ngjyrë të zezë.

Brenda shqytit një panterë me ngjyrë të zezë dhe rreth panterës në anën e majtë fjalët **“DREJTORIA FORCËS”** dhe në anën e djathtë fjalët **“POSAÇME OPERACIONALE”** me ngjyrë të zezë.

m. SHENJË KRAHU-POLICIA KRIMINALE



Mburojë (shqyt) me ngjyrë blu e kornizuar me ngjyrë të artë. Në pjesën e sipërme fjalët “POLICIA KRIMINALE” me ngjyrë të artë. Në fushë ylli me tetë cepa dhe rreze, në qendër të diellit një mburojë rrethore me sfond me ngjyrë të kuqe e kornizuar me ngjyrë të artë. Përreth tij në një sipërfaqe me fushë blu të shkruhet në pjesën e sipërme fjalët “POLICIA E SHQIPËRI”, në pjesën e poshtme fjala “SHQIPËRI” dhe dy kallinj gruri me ngjyrë të artë. Në mes një mburojë shqiptonja dykrenore dhe Përkrenarja e Skënderbeut, në profil djathtas me ngjyrë të zezë. Në mbështetje të shqiptonjës dhe përkrenares, janë dy luanë të artë.

n. SHENJË KRAHU-DEPARTAMENTI I MARRËDHËNIEVE NDËRKOMBËTARE



Mburojë (shqyt) me ngjyrë blu të errët e kornizuar me tre shirita të hollë, shiriti i jashtëm me ngjyrë blu të errët, shiriti i dytë me ngjyrë blu e hapur dhe shiriti i tretë me ngjyrë të artë. Në qendër të shqytit shqiptonja dykrenore me krahët e hapur në formë harku, Përkrenarja e Skënderbeut me ngjyrë të artë. Në qendër të mburojës mbi sfond është një rreth i kornizuar me ngjyrë të artë, ku brenda tij është globi në ngjyrë të artë dhe në mes stema e Policisë së Shtetit. Në pjesën e sipërme të globit janë fjalët “SË BASHKU PËR NJË BOTË TË SIGURTË” dhe në pjesën e poshtme “Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare” me gërma me ngjyrë të artë.



o. SHENJË KRAHU-AKADEMIA I SIGURISË



Mburojë (*shqyt*) e ndarë në mes me dy ngjyra, ngjyrë të kuqe dhe të zezë, e kornizuar me shirit me ngjyrë të artë.


Në pjesën e sipërme fjalët “AKADEMIA E SIGURISË” dhe anash poshtë dy kordonët e uniformës policore, me ngjyrë të artë.

Në qendër të shqytit të madh ndodhet një shqyt më i vogël me ngjyrë blu i kornizuar me një shirit me ngjyrë të artë. Në mes qëndrojnë libri dhe pena me ngjyrë të artë dhe inicialet “A S” të vendosur në qendër të kapakut me ngjyrë blu si shqyti.

Në fund të shqytit viti 1971 me ngjyrë të artë.

p. SHENJA E *STUDENT/KURSANT*

SHENJA E SPALETIT SHËRBIMI - KURSANT/STUDENT




SHENJA E SPALETIT CEREMONIALE – KURSANT/STUDENT



SHËNJË GJOKSI KURSANT/STUDENT



q. SHENJA MBIEMRI, NUMËR IDENTIFIKIMI (RMIS)

r. SHENJA E KAPELES (EMBLEMA)



Shqiponjë dykrerëshe me përkrenaren e Skënderbeut, të vendosur sipër saj. E gjitha e artë, me relief dhe e stilizuar sipas figurës.

s. SHENJA E JAKËS PÛRKRENARE E STILIZUAR



t. SHIRITI KAPELES DHE KOPSAT ME NGJYRË TË ARTË

SHIRITI I KAPELES



KOPSAT

Kopsat e vogla
Ø 15 mm



Kopsat e mesme
Ø 23 mm




Kopsat e mëdha
Ø 25 mm





u. SHIRITI I MEDALJEVE

Shembull ilustrues



Shiriti i medaljes është material plastik me përmasa: gjatësi 35 mm dhe lartësi 10 mm, ngjyrat janë të përcaktuara sipas ngjyrës së medaljeve.



Pamja e kapses e mbyllur



Pamja e kapses e hapur

Në pjesën e pasme tek shiritit të medaljes është vendosur një kapsë e cila shërben për vendosjen në uniforme të shiritit me material inoks, me përmasa gjatësi 33mm dhe gjerësi 8mm

Lidhja nr. 5

DOKUMENTI DHE MEDALJONI ZYRTAR I IDENTIFIKIMIT

1. DOKUMENTI I IDENTIFIKIMIT

➤ Forma, përmasat dhe të dhënat e Dokumentit i Identifikimit të Punonjësit të Policisë së Shtetit :



Përmasat e dokumentit të identifikimit janë 8,5 cm x 5,5 cm, me rumbullakim të katër cepat.

Në anën e majtë, fotografinë me uniformë policie të punonjësit të Policisë ose me uniformë zyrtare për punonjësit që nuk trajtohen me uniformë policie.

Në pjesën e mbetur në sfond vendoset "Stema e Policisë së Shtetit".

Në pjesën e sipërme në mes vendoset mbishkrimi: "Republika e Shqipërisë; Ministria e Brendshme; Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit".

Në pjesën e djathtë: emër, mbiemër, numri i identifikimit, grada dhe struktura qendrore apo vendore, ku është në detyrë punonjësi i Policisë së Shtetit.

Në pjesën e pasme: Në të gjithë sfondin të jetë "Logo e Policisë së Shtetit" dhe në mes të saj "POLICIA".

2. MEDALJONI ZYRTAR I IDENTITETIT

➤ Forma, përmasat dhe të dhënat e Medaljonit Zyrtar të Identifikimit të punonjësit të Policisë së Shtetit:



Medalioni zyrtar i identifikimit të punonjësit të Policisë së Shtetit përmban:

a) Medaljonin i cili përbëhet nga një pllakë metalike që përfaqëson stemën e Policisë së Shtetit, me ngjyrë të artë. Përmasat e pllakës metalike janë 6 cm bazë dhe 6.5 cm në lartësi. Mbi pllakën e mburojës metalike vendoset një pllakë tjetër e zezë që përfaqëson numrin e Identifikimit të Punonjësit të Policisë (RMIS) të personalizuar (numrat me ngjyrë të artë), dhe shkrimin SHQIPERI - ALBANIA me ngjyrë të artë

b) Mbajtësen, e cila është realizuar në formë kulete me material lëkure, me ngjyrë të zezë në formë drejtkëndore. Mbajtësja e medalionit duhet të jetë me material prej lëkure me trajtim kundra ujit dhe me cilësi të lartë në realizimin e produktit. Mbajtësja hapet si një libër. Në anën e majtë jep akses për kartën e policisë e cila futet në një xhep plastik transparent, ndërsa në anën e djathtë ka një kapak të fiksuar të qepur horizontalisht në kapakun e brendshëm prej lëkure që mban medalionin metalik dhe të identifikimit dhe mbulon kartat për konfidencialitet. Mbajtësja kompletohet me:

- 1 ndarje kartash për dokumente të fshehura brenda, me 3 vende për karta të ndryshme
- 1 mbajtëse pllake metalike të stemës së "Policisë së Shtetit", numrit të identifikimit të punonjësit të policisë.



Aneksi nr. 1 i Lidhjes nr. 3

NORMAT E FURNIZIMIT ME UNIFORMË DHE VESHJE CIVILE

TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHITETIT

SEKSIONI

Nr.	Emertimi i artikujve të uniformes	Nj/m	STRUKTURAT E RENDIT						Shënime
			Roli parë, i mesëm drejtues dhe roli madhor		Roli zbatues		Njësia e Ceremonialit		
			Sasia	Afati vite	Sasia	Afati vite	Sasia	Afati vite	
I	Uniforma baze në detyrë								
a.	Uniforma dimërore								
1	Xhup shërbimi (3/4) (me veshje të ngrohtë)	copë	1	3	-	-	1	3	Opsion për gradën Kryekomisar deri Drejtues Madhor/ Shef komisarjat/Shef njësie
2	Xhup shërbimi (me veshje të ngrohtë)	copë	1	2	1	2	1	2	Inspektor deri Komisar
3	Kostum uniforme Femra / Meshkuj (1 Xhakët, 2 pantallona, 2 kapele)	kompl	1	2	1	2	1	2	
4	Fund për femra	copë	1	2	1	2	1	2	Opsion për femrat në vend të pantallonave
5	Pulover e trikotuar jakë "V"	copë	1	2	1	2	1	2	
6	Këmishë bojçelli me mëngë të gjata femra/meshkuj	copë	3	1	3	1	3	1	
7	Kravatë blu uniforme	copë	2	2	2	2	2	2	
8	Rrip pantalloni	copë	1	2	1	2	1	2	
9	Rrip multifunksional	copë	1	5	1	3	1	3	
10	Jelek multifunksional	copë	1	5	1	5	1	5	
11	Pelerina e shiut	copë	1	5	1	3	1	3	
12	Doreza lëkure	palë	1	5	1	5	1	5	
13	Kapuç leshi	copë	-	-	1	2	-	-	Opsion për zonat e flojta
b.	Uniforma verore								
1	Pantallona vere femra/meshkuj	palë	3	2	3	2	3	2	
2	Fund për femra	copë	1	2	1	2	1	2	Opsion për femrat në vend të pantallonave
3	Këmishë bojçelli me mëngë të shkurtra, për femra/meshkuj	copë	3	1	3	1	3	1	
4	Bluzë polo, me mëngë të shkurtra për femra/meshkuj	copë	3	2	3	2	3	2	
5	Kapele uniforme verore uniforme femra/meshkuj	copë	2	2	2	2	2	2	
II	Uniforma për stervitje e shërbime								
1	Kostum doku stervitje (Xhakët, pantallona+2kapele tip sport).	komplet	1	5	1	5	1	5	
2	Këmishë doku (blu) me mëngë të shkurtera	copë	1	5	1	5	1	5	
3	Bluzë jakë rumbullakët m' gjata	copë	2	5	2	5	2	5	
4	Bluzë jakë rumbullakët m' shkurtra	copë	2	5	2	5	2	5	
III	Uniforma e veçantë verore për punonjësit e policisë që kryejnë shërbimin në plazhe,								
1	Bluze Polo bardhë	copë	-	-	2	1	-	-	Opsion për punonjësit patrullë në plazhe
2	Pantallona doku ripstop të shkurtra	palë	-	-	2	1	-	-	Opsion për punonjësit patrullë në plazhe
3	Kapele tip sport	copë	-	-	2	1	-	-	Opsion për punonjësit patrullë në plazhe
IV	Uniforma ceremoniale								
1	Kostum uniforme Femra / Meshkuj (1 Xhakët, 2 pantallona, 2 kapele) për ceremoni.	komplet	-	-	-	-	1	2	Vetëm për trupën ceremoniale
2	Rrip ceremoniali	copë	-	-	-	-	1	2	Vetëm për trupën ceremoniale
3	Këmishë ceremoniale me mëngë të gjata, femra/meshkuj	copë	2	4	1	6	1	6	për trupën ceremoniale 2 cop /2vite
4	Doreza (të bardha) ceremoniale	palë	-	-	-	-	2	1	vetëm për trupën ceremoniale
5	Kordonë ceremonial supi	copë	1	4	1	6	1	6	Për gradën madhore dhe trupën ceremoniale 1/2vite
6	Kordonë ceremonial kapele	copë	1	4	1	6	1	6	Për gradën madhore dhe trupën ceremoniale 1/2vite
V	Gradat, stema, shenjat								
1	Grada spaleti shërbimi	palë	2	2	2	2	2	2	
2	Gradat spaleti CEREMONIALE	palë	2	4	1	6	1	6	
3	Gradat gjoksi shërbimi	copë	2	2	2	2	2	2	
4	Stema e Policisë së Shtetit	copë	2	2	2	2	2	2	
5	Shenja e krahut sipas shërbimit	copë	2	2	2	2	2	2	
6	Shenjë Mbiemri	copë	2	2	-	-	2	2	opsion vetëm për gradën kryekomisar deri Drejtues Madhor
7	Shenja numër identifikimi RMIS	copë	2	2	2	2	2	2	
VI	Këpuçë								
1	Këpuçë ceremoniale për femra/meshkuj	palë	-	-	-	-	1	1	vetëm për trupën ceremoniale
2	Këpuçë dimërore për femra dhe meshkuj	palë	1	1	1	1	1	1	
3	Këpuçë verore për femra/meshkuj	palë	1	1	1	1	1	1	
4	Këpuçë taktike dimërore	palë	1	5	1	5	1	5	
VII	Veshja Civile e cila konvertohet në vlerë monetare								
1	Pallto/xhup	Copë	1	4	-	-	-	-	
2	Kostum civil (Xhakët, pantallona)	komplet	1	4	-	-	-	-	



3	Këmisha me mëngë të gjata	Copë	2	4	-	-	-	-
4	Kravatë	Copë	1	4	-	-	-	-
5	Këpuce gjysma	palë	1	4	-	-	-	-

SEKSIONI II

Nr.	Emertimi i artikujve të uniformes	Nj/m	STRUKTURAT E VEÇANTA TË RENDIT						Shënime
			Policia RRUGOR E		Patrulla e Përgjithshme		Njësia Operacionale e Rendit Publik - "SHQIPONJA"		
			S as ia	Afati vite	Sasia	Afati vite	Sasia	Afati vite	
I	Uniforma baze në detyrë								
a.	Uniforma dimërore								
1	Xhup shërbimi (3/4)(me veshje të ngrohtë)	copë	1	3	-	-		Opsion vetëm për gradën kryekomisar e lart	
2	Kostum uniforme Femra / Meshkuj (1 Xhakete, 2 pantallona, 2 kapele)	kompl	1	5	1	5	1	5	
3	Këmishë bojçelli me mëngë të gjata femra/meshkuj	copë	1	5	1	5	1	5	
4	Kravatë blu uniforme	copë	1	5	1	5	1	5	
5	Rrip pantalloni	copë	1	2	1	2	1	2	
6	Rrip multifunksional	copë	1	3	1	3	1	3	
7	Jelek multifunksional	copë	-	-	1	5	1	5	
8	Pelerina e shiut	copë	-	-	1	3	1	3	
9	Doreza lëkure	palë	1	5	1	5	1	5	
10	Pulovër e trikotuar me jakë rumbullake	copë	1	2	1	2	1	2	
II	Uniforma për shërbime								
1	Kostum doku shërbime (Xhakete, pantallona+2 kapele tip sport).	komplet	1	5	1	5	1	5	
2	Këmishë doku (blu) me mëngë të shkurtra	copë	1	5	1	5	1	5	
3	Bluzë pambuku jakë rumbullakët m/ gjata	copë	1	5	1	5	1	5	
4	Bluzë pambuku jakë rumbullakët m/ shkurtra	copë	1	5	1	5	1	5	
III	Uniforma të veçanta								
a.	Uniforma dimërore dhe verore								
1	Kostum dimëror për patrullë e policisë dhe motoçiklistët (xhup, pantallona, 2 kapele tip sport)	komplet	1	2	1	2	1	2	
2	Bluzë polo, me mëngë të gjata	copë	2	1	2	1	2	1	
3	Bluzë polo me mëngë të shkurtra	copë	3	1	3	1	3	1	
4	Pantallona doku rip-stop vere	palë	2	1	2	1	2	1	
5	Kapele tip sport	copë	2	1	2	1	2	1	
6	Xhup fosforiscent (me vizibilitet të lartë)	copë	1	3	-	-	-	-	
7	Aksesorë reflektive (mbulose kapele, mëngore)	copë	1	3	-	-	-	-	
8	Jelek me Vizibilitet të lartë (sipas ngjyrave)	copë	1	1	1	1	1	1	
9	Doreza motoçiklisti	palë	1	3	-	-	1	3	
								Opsion për punonjësit me motoçikletë	
IV	Uniforma ceremoniale								
1	Këmishë ceremoniale më mëngë të gjata, femra/meshkuj	copë	1	6	1	6	1	6	
2	Kordonë ceremonial supi	copë	1	6	1	6	1	6	
3	Kordonë ceremonial kapele	copë	1	6	1	6	1	6	
V	Gradat, stema, shenjat								
1	Grada spaleti shërbimi	palë	2	2	2	2	2	2	
2	Gradat spaleti CEREMONIALE	palë	1	6	1	6	1	6	
3	Gradat gjoksi	copë	2	2	2	2	2	2	
4	Stema e Policisë së Shtetit	copë	2	2	2	2	2	2	
5	Shenja e krahut sipas shërbimit	copë	2	2	2	2	2	2	
6	Shenjë Mbiemri	copë	2	2	2	2	2	2	
7	Shenja numer identifikimi RMIS	copë	2	2	2	2	2	2	
VI	Këpuce								
1	Këpuce dimërore për femra dhe meshkuj	palë	1	5	1	5	1	5	
2	Këpuce taktike dimërore	palë	1	1	1	1	1	1	
3	Këpuce taktike verore për strukturat e veçanta	palë	1	1	1	1	1	1	
VII	Veshja Civile e cila konvertohet në vlerë monetare								
1	Palto/xhup	Copë	1	4	1	4	1	4	
2	Kostum civil (Xhakete, pantallona)	komplet	1	4	1	4	1	4	
3	Këmisha me mëngë të gjata	Copë	2	4	2	4	2	4	
4	Këmisha me mëngë të shkurtra	Copë	1	4	1	4	1	4	
5	Kravatë	Copë	1	4	1	4	1	4	
6	Këpuce gjysma	palë	1	4	1	4	1	4	
								Opsion vetëm për gradën kryekomisar deri Drejtues Madhor	



SEKSIONI III

Nr.			Njësitë e Sigurisë Publike (FKS)		Njësia Speciale për K&M "DELTA"		Njësia Speciale e mbrojtjes së Veçantë "NJSMV"		Shënime
			Sasia	Afati vite	Sasia	Afati vite	Sasi a	Afati vite	
I	Uniforma bazë në detyrë								
a.	Uniforma dimërore								
1	Xhup shërbimi (3/4) me veshje të ngrohtë	copë	1	3	1	3	1	6	Opsion vetëm për gradën Kryekomisar deri Drejtues Madhor
2	Xhup shërbimi (me veshje të ngrohtë)	copë	1	2	1	2	1	6	
3	Kostum uniforme Femra / Meshkuj (1 Xhakëtë, 2 pantallona, 2 kapele)	kompl	1	6	1	6	1	6	
4	Këmishë bojçelli me mëngë të gjata femra/meshkuj	copë	1	6	1	6	1	6	
5	Kravatë blu uniforme	copë	1	6	1	6	1	6	
6	Rrip pantalloni	copë	1	2	1	2	1	6	
7	Rrip multifunksional	copë	1	2	1	2	1	6	
8	Jelek multifunksional	copë	1	2	1	2	1	6	
9	Pelerina e shiut	copë	1	3	1	3	1	6	
10	Doreza lëkure	palë	1	6	1	6	1	6	
11	Pulover e trikotat me jakë 1/2 golf	copë	1	2	1	2	1	6	
12	Kapuç leshi	copë	1	2	1	2	-	-	opsion për zonat e flota
13	Maskë operacionale	copë	2	3	2	3	2	3	
b.	Uniforma verore								
1	Pantallona doku rip stop vere	palë	2	2	2	2	-	-	
2	Bluzë polo, me mëngë të shkurtra për femra/meshkuj	copë	3	1	3	1	-	-	
3	Kapele tip sport	cope	2	1	2	1	-	-	
II	Uniforma për stërvitje e shërbime								
1	Kostum doku stërvitje (Xhakëtë, pantallona+2 kapele tip sport).	komplet	2	1	2	1	1	5	
2	Këmishë doku (blu) me mëngë të shkurtra	copë	2	1	2	1	1	5	
3	Bluzë pambuku jakë rumbullakët m/ gjata	copë	2	1	2	1	1	5	
4	Bluzë pambuku jakë rumbullakët m/ shkurtra	copë	2	1	2	1	1	5	
III	Uniforma ceremoniale								
1	Këmishë ceremoniale me mëngë të gjata, femra/meshkuj	copë	1	6	1	6	1	6	
2	Kordonë ceremonial supi	copë	1	6	1	6	1	6	
3	Kordonë ceremoniali kapele	copë	1	6	1	6	1	6	
IV	Gradat, stema, shenjat								
1	Gradat spaleti shërbimi	palë	2	2	2	2	2	6	
2	Gradat spaleti CEREMONIALE	palë	1	6	1	6	1	6	
3	Gradat gjoksi	copë	2	2	2	2	2	6	
4	Stema e Policisë së Shtetit	copë	2	2	2	2	2	6	
5	Shenja e krahut sipas shërbimit	copë	2	2	2	2	2	6	
6	Shenjë Mbiemri	copë	2	2	2	2	2	6	Opsion vetëm për gradën Kryekomisar deri Drejtues Madhor
7	Shenja numer identifikimi RMIS	copë	2	2	2	2	2	6	
V	Këpuçë								
1	Këpuçë dimërore për femra dhe meshkuj	palë	1	4	1	4	1	6	
2	Këpuçë taktike dimërore	palë	1	1	1	1	1	4	
3	Këpuçë taktike verore me qafa	palë	1	1	1	1	-	-	
VI	Veshja Civile e cila konvertohet në vlerë monetare								
1	Palto/xhup	Copë	1	4	1	4	1	4	Për Njësitë e Sigurisë Publike (FKS) dhe Njësia Speciale për K&M DELTA" Opsion vetëm për gradën nënkomisar dhe lart.
2	Kostum civil (Xhakëtë, pantallona)	komplet	1	4	1	4	1	2	
3	Këmisha me mëngë të gjata	Copë	2	4	2	4	2	1	
4	Këmisha me mëngë të shkurtra	Copë	1	4	1	4	2	1	
5	Kravatë	Copë	1	4	1	4	1	2	
6	Këpuçë gjysma	palë	1	4	1	4	1	1	
VII	Veshje Sportive								
1	Kostum sportiv dimëror (tuta, bluzë dimërore)	komplet	1	2	1	2	1	2	
2	Kostum sportiv verore (1 palë pantallona të shkurtra, 1 bluzë)	komplet	2	1	2	1	2	1	
3	Këpuçë atletike	palë	1	1	1	1	1	1	

SEKSIONI IV

Nr.	Emërtimi i objektit të uniformës	Njimi	Njësia Speciale "RENEA"		Njësia Speciale "NEGOCIM"		Njësia Speciale "ANTIEKSPLOZIV"		Shënime
			Sasia	Afati vite	Sasi a	Afati vite	Sasia	Afati vite	
I	Uniforma operacionale								
a.	Uniforma operacionale dimërore								
1	Xhup dimri	Copë	1	4	1	4	1	4	
2	Xhup shiu	Copë	1	4	1	4	1	4	
3	Pantallona shiu	palë	1	4	1	4	1	4	
4	Xhup taktik	copë	1	4	1	4	1	4	



5	Xhakete taktike	copë	1	2	1	2	1	2	
6	Pantallona taktike	palë	1	2	1	2	1	2	
7	Bluzë taktike	copë	2	3	2	3	2	3	
8	Doreza taktike	palë	1	3	1	3	1	3	
9	Rrip operacional	copë	1	3	1	3	1	3	
10	Rrip taktik	copë	1	3	1	3	1	3	
11	Jelek multifunksional	copë	1	3	1	3	1	3	
12	Këpuce taktike dimërore	palë	1	1	1	1	1	1	
13	Këpuce me qafa	palë	1	1	1	1	1	1	
14	Kapuç leshi	Copë	1	2	1	2	1	2	
15	Maske operationale	Copë	2	2	2	2	2	2	
b. Uniforma për trajnime									
1	Xhup trajnimi	Copë	1	4	1	4	1	4	
2	Xhakete trajnimi	Copë	1	3	1	3	1	3	
3	Pantallona trajnimi	palë	1	3	1	3	1	3	
4	Bluzë trajnimi	copë	2	3	2	3	2	3	
5	Kapele trajnimi	Copë	1	3	1	3	1	3	
6	Këpuce trajnimi	palë	1	3	1	3	1	3	
c. Uniforma operationale verore									
1	Jelek operacional civil	copë	1	3	1	3	1	3	
2	Pantallona operationale civile	palë	1	3	1	3	1	3	
II Uniforma Ceremoniale :									
1	Kostum uniforme për femra/meshkuj(xhakete, 2 palë pantallona + 2 kapele)		1	6	1	6	1	6	
2	Kordonë ceremonial për kapele	copë	1	6	1	6	1	6	
3	Kordonë ceremonial supi	copë	1	6	1	6	1	6	
4	Grada Ceremoniale Supi	palë	1	6	1	6	1	6	
5	Këmishë ceremoniale me mëngë të gjata për femra/meshkuj	copë	2	6	2	6	2	6	
III Shenjat dalluese të uniformës së Policisë									
1	Stema e Policisë Shtetit	copë	2	2	2	2	2	2	
2	Grada spaleti shërbimi	palë	2	2	2	2	2	2	
3	Grada spaleti CEREMONIALE		1	3	1	3	1	3	
4	Gradat gjoksi	copë	2	2	2	2	2	2	
5	Shenja mbiemri	copë	2	2	2	2	2	2	opsion vetëm përgradën kryekomisar e lart
6	Numer identifikimi	copë	2	2	2	2	2	2	
7	Shenja sipas shërbimit	copë	2	2	2	2	2	2	
IV Uniforma Civile									
1	Pallko/xhup	Copë	1	4	1	4	1	4	
2	Kostum civil(Xhakete, pantallona)	komplet	1	4	1	4	1	4	
3	Këmisha me mëngë të gjata	Copë	2	4	2	4	2	4	
4	Këmisha me mëngë të shkurtra	Copë	2	4	2	4	2	4	
5	Kravatë	Copë	1	4	1	4	1	4	
6	Këpuce gjysma	palë	1	4	1	4	1	4	
V Uniforma Sportive									
1	Kostum sportiv dimëror (tuta bluzë dimërore)	komplet	1	2	1	2	1	2	
2	Kostum sportiv verore (1 palë pantallona të shkurtra, 1 bluzë)	komplet	2	1	2	1	2	1	
3	Këpuce atlete	palë	1	1	1	1	1	1	
4	Çantë Sporti	Copë	1	3	1	3	1	3	
5	Peshqirë të vegjël	Copë	2	1	2	1	2	1	
6	Peshqirë të mëdhenj	Copë	1	1	1	1	1	1	
VI Veshje speciale për punonjësit e policisë Antieksplziv									
1	Kostum antieksplziv	komplet	-	-	-	-	1	pa afat	
2	Jelek i lehtë mbrojtës antibombë	Copë	-	-	-	-	1	5	
3	Skafandra antibombë EOD	Copë	-	-	-	-	1	5	
4	Skafandra antibombë për jelek mbrojtës	Copë	-	-	-	-	1	5	
5	Doreza amianti	palë	-	-	-	-	1	pa afat	
6	Doreza të thjeshta mekaniku	palë	-	-	-	-	2	1	
7	Jelek pune doku	Copë	-	-	-	-	1	pa afat	
8	Çantë brezi për vegla	komplet	-	-	-	-	1	5	
9	Doreza plastike	palë	-	-	-	-	150	1	
10	Kostum pune i lehtësuar (Pambuku dhe material antizjarr)	komplet	-	-	-	-	1	1	
Uniformë për punonjësit e policisë të Njësisë Speciale të Negocimit									
VII									
1	Kapele prezantuese me mbishkrim "Negociator"	Copë	-	-	1	1	-	-	
2	Kostum anti- shi me mbishkrimin "Negociator"	komplet	-	-	1	2	-	-	
Veshje speciale për punonjësit e policies Seksioni Special i zhytjes									
VIII									
1	Kostum i gomuar zhytje veror (1 xhakete me kapuç, 1 palë pantallona)	komplet	1	pa afat	-	-	-	-	
2	Kostum i gomuar zhytje dimëror (1 xhakete me kapuç, 1 palë pantallona)	komplet	1	pa afat	-	-	-	-	
3	Xhakete ekuilibruese	copë	1	pa afat	-	-	-	-	
4	Rregullator ajri	palë	1	pa afat	-	-	-	-	
5	Bombola ajri	copë	1	pa afat	-	-	-	-	
6	Aspirator ajri	copë	1	pa afat	-	-	-	-	
7	Çorape për zhytje	Copë	1	pa afat	-	-	-	-	



8	Syze për zhytje	palë	1	pa afat	-	-	-	-	-
9	Jelek shpëtimi	palë	1	pa afat	-	-	-	-	-
10	Doreza gome për zhytje	copë	1	pa afat	-	-	-	-	-
11	Pelerinë shiu	copë	1	2	-	-	-	-	-

SEKSIONI V

Nr.	Emërtimi i artikujve të uniformës	Nj/m	STRUKTURAT E KUFIRIT DHE MIGARCIONIT						Shenime
			Roli parë, i mesëm drejtues dhe roli madhor		Roli Zbatues				
					Strukturat e Shërbimit dhe PKK		Strukturat trupë shërbimi për kufirin tokësor dhe detar		
Sasia	Afati vite	Sasia	Afati vite	Sasia	Afati vite				
I	Uniforma bazë në detyrë								
a.	Uniforma dimërore								
1	Xhup shërbimi (3/4)(me veshje të ngrohtë)	copë	1	3	-	-	1	4	Vetëm vetëm për gradën Kryekomisar e lart dhe strukturat e kufirit toksor në zonat e ftohta
2	Xhup shërbimi (me veshje të ngrohtë)	copë	1	2	1	2	1	2	Inspektor deri Komisar
3	Kostum uniforme Femra / Meshkuj (1 Xhakete, 2 pantallona, 2 kapele)	kompl	1	2	1	2	1	4	
4	Fund për femra	copë	1	2	1	2	1	4	Opsion për femrat në vend të pantallonave
5	Pulovër e trikotuar jakë “V”	copë	1	2	1	2	-	-	
6	Pulovër e trikotuar me jakë 1/2 golf	copë	-	-	-	-	1	2	
7	Këmishë bojçelli me mëngë të gjata femra/meshkuj	copë	3	1	3	1	3	1	
8	Kravatë blu uniforme	copë	2	2	2	2	2	2	
9	Rrip pantalloni	copë	1	2	1	2	1	2	
10	Rrip multifunksional	copë	1	4	1	4	1	3	
11	Jelek multifunksional	copë	1	5	1	5	1	3	
12	Pelërina e shiut	copë	1	5	1	3	1	3	
13	Doreza lëkure	palë	1	5	1	5	1	5	
14	Kapuç lëshi	copë	-	-	-	-	1	1	Opsion për zonat e ftohta
b.	Uniforma verore								
1	Pantallona vere femra/meshkuj	palë	3	2	3	2	2	2	
2	Fund për femra	copë	1	2	1	2	-	-	Opsion për femrat në vend të pantallonave
3	Këmishë me mëngë të shkurtra, për femra/meshkuj	copë	3	1	3	1	-	-	
4	Bluzë polo, me mëngë të shkurtra për femra/meshkuj	copë	2	2	3	1	3	1	
5	Pantallona doku ripstop vere		-	-	-	-	2	1	
6	Kapele verore femra/meshkuj	copë	2	2	2	2	2	2	
II	Uniforma për stërvitje e shërbime								
1	Kostum doku stërvitje (Xhakete, pantallona+2 kapele tip sport).	komplet	1	5	1	5	2	1	
2	Këmishë doku (blu) me mëngë të shkurtra	copë	1	5	1	5	2	1	
3	Bluzë pambuku jakë rumbullake m/ gjata	copë	2	5	2	5	2	1	
4	Bluzë pambuku jakë rumbullake m/ shkurtra	copë	2	5	2	5	2	1	
III	Uniforma e veçantë verore për punonjësit e policisë që kryejnë shërbimin në plazhe,								
1	Bluze polo e bardhë	copë	-	-	-	-	2	1	Opsion për punonjësit patrullë në plazhe dhe mjete ujore
2	Pantallona doku ripstop të shkurtra	palë	-	-	-	-	2	1	Opsion për punonjësit patrullë në plazhe dhe mjete ujore
3	Kapele tip sport	copë	-	-	-	-	2	1	Opsion për punonjësit patrullë në plazhe dhe mjete ujore
IV	Uniforma për punonjësit e Policisë të Mjeteve Ujore:								
1	Jelek shpëtimi në mjete ujore (salvaxhente)	copë	-	-	-	-	1	pa afat	Opsion për punonjësit në mjete lundruese
2	Kominohe vere me tekstil të posaçëm naval	copë	-	-	-	-	1	pa afat	Opsion për punonjësit në mjete lundruese
3	Kominohe dimri me tekstil të posaçëm naval	copë	-	-	-	-	1	pa afat	Opsion për punonjësit në mjete lundruese
4	Kostum i gomuar (1 xhakete me kapuç, 1 palë pantallona)	komplet	-	-	-	-	1	pa afat	Opsion për punonjësit në mjete lundruese
5	Doreza gome	palë	-	-	-	-	1	1	Opsion për punonjësit në mjete lundruese
6	Çizme gome	palë	-	-	-	-	2	1	Opsion për punonjësit në mjete lundruese
7	Kostum termik (per jetski)	copë					1	Pa afat	Opsion për punonjësit në mjete lundruese motor uji(jetski)
8	Jelek shpëtimi motor uji (jet-ski)	copë					1	Pa afat	Opsion për punonjësit në mjete lundruese motor uji(jetski)
9	Këpuçë gome	palë					1	Pa afat	Opsion për punonjësit në mjete lundruese motor uji(jetski)
V	Uniforma ceremoniale								
1	Këmishë ceremoniale me mëngë të gjata, femra/meshkuj	copë	2	4	1	6	1	6	
2	Kordonë ceremonial supi	copë	1	6	1	6	1	6	Për gradën madhore 2/2vite
3	Kordonë ceremoniali kapele	copë	1	6	1	6	1	6	Për gradën madhore 2/2vite
VI	Gradat, sllena, shenjat								



1	Grada spaleti shërbimi	pale	2	2	2	2	2	2	
2	Gradat spaleti CEMONIALE	pale	2	6	1	6	1	6	
3	Gradat gjoksi	copë	2	2	2	2	2	2	
4	Stema e Policisë së Shtetit	copë	2	2	2	2	2	2	
5	Shenja e krahut sipas shërbimit	copë	2	2	2	2	2	2	
6	Shënjtë Mbiemri	copë	2	2	2	-	2	2	Opsion vetëm për gradën Kryekomisar deri Drejtues Madhor
7	Shenja numer identifikimi RMIS	copë	2	2	2	2	2	2	
VII Këpuçë									
1	Këpuçë dimërore për femra dhe meshkuj	pale	1	1	1	1	1	1	
2	Këpuçë verore për femra/meshkuj	pale	1	1	1	1	-	-	
3	Këpuçë taktike dimërore	pale	1	5	1	5	1	1	
4	Këpuçë taktike verore me qafa		-	-	-	-	1	1	
5	Këpuçë taktike për patrullë në plazhe	pale	-	-	-	-	1	1	Vetëm për patrullat gjatë sezonit turistik në plazh
VIII Veshja civile e cila konvertohet në vlerë monetare									
1	Palto/rdhup	Copë	1	4	-	-	-	-	
2	Kostum civil(Xhakete, pantallona)	komplet	1	4	-	-	-	-	
3	Këmisha me mëngë të gjata	Copë	2	4	-	-	-	-	
4	Kravatë	Copë	1	4	-	-	-	-	
5	Këpuçë gjysma	pale	1	4	-	-	-	-	

SEKSIONI VI

Nr.	Emertimi i artikujve të uniforms	Nj/m	AKADEMIA E SIGURISË						Shënime
			Stafi Akademik me Gradë Policore	Studente dhe Kursantët					
				Studentët		Kursantët			
				Sasia	Afati vite	Sasia	Afati vite	Sasia	
I	Uniforma bazë në detyrë								
a.	Uniforma dimërore								
1	Xhup shërbimi (3/4)me veshje të ngrohtë	copë	1	3	-	-	-	-	Opsion vetëm për gradën kryekomisar deri Drejtues Madhor
2	Xhup shërbimi (me veshje të ngrohtë)	copë	1	2	1	2	1	2	Inspektor deri Komisar
3	Kostum uniforme Femra / Meshkuj (1 xhakete, 2 pantallona, 2 kapele)	kompl	1	2	1	3	-	-	
4	Pulover e trikotuar jakë "V"	copë	1	2	1	3	-	-	
5	Këmishë bojçelli me mëngë të gjata femra/meshkuj	copë	3	1	2	1	-	-	
6	Kravatë blu uniforme	copë	2	3	1	3	-	-	
7	Rrip pantalloni	copë	1	2	1	2	1	2	
8	Rrip multifunksional	copë	1	6	1	3	1	3	
9	Jelek multifunksional	copë	1	6	1	3	1	3	
10	Pelërina e shiut	copë	1	5	1	3	1	3	
11	Doreza lëkure	pale	1	5	-	-	-	-	
b.	Uniforma verore								
1	Pantallona vere femra/meshkuj	pale	3	2	2	2	-	-	
2	Fund për femra	copë	1	2	-	-	-	-	Opsion për femrat në vend të pantallonave
3	Këmishë me mëngë të shkurtra, për femra/meshkuj	copë	3	1	2	1	-	-	
4	Bluzë polo, me mëngë të shkurtra për femra/meshkuj	copë	2	2	2	2	2	1	
5	Kapele verore femra/meshkuj	copë	2	2	2	2	-	-	
II	Uniforma për stërvitje e shërbime								
1	Kostum doku stërvitje (Xhakete, pantallona+2 kapele tip sport).	komplet	1	2	2	1	2	1	
2	Këmishë doku (blu) me mëngë të shkurtra	copë	1	2	2	1	2	1	
3	Bluzë pambuku jakë rumbullake m/ gjata	copë	2	2	2	1	2	1	
4	Bluzë pambuku jakë rumbullake m/ shkurtra	copë	2	2	2	1	2	1	
III	Uniforma ceremoniale								
3	Këmishë ceremoniale me mëngë të gjata, femra/meshkuj	copë	2	4	-	-	-	-	
5	Kordonë ceremonial supi	copë	1	3	-	-	-	-	
6	Kordonë ceremoniali kapele	copë	1	3	-	-	-	-	
IV	Gradat, stema, shenjat								
1	Grada spaleti shërbimi	pale	3	2	-	-	-	-	
2	Gradat spaleti ceremoniale	pale	2	4	-	-	-	-	
3	Gradat gjoksi	copë	3	2	-	-	-	-	
4	Stema e Policisë së Shtetit	copë	3	2	2	2	2	2	
5	Shenja e krahut sipas shërbimit	copë	3	2	2	2	2	2	
6	Shenja Mbiemri	copë	3	2	-	-	-	-	Opsion vetëm për gradën kryekomisar deri Drejtues Lartë
7	Shenja numër identifikimi RMIS	copë	3	2	-	-	-	-	
8	Shenja spaleti për kursant/student		-	-	2	3	1	1	



9	Shenje gjoksi kursant/studenti	copë	-	-	2	3	1	1	
V	Këpuçë								
1	Këpuçë dimërore për femra dhe meshkuj	palë	1	1	1	1	-	-	
2	Këpuçë verore për femra/meshkuj	palë	1	1	1	2	-	-	
3	Këpuçë taktike dimërore	palë	1	5	1	1	1	1	
VI	Veshja Civile e cila konvertohet në vlerë monetare								
1	Palto/xhup	Copë	1	4	-	-	-	-	Opsion vetëm përgradën nënkomisar dhe lart
2	Kostum civil(Xhakete, pantallona)	komplet	1	4	-	-	-	-	Opsion vetëm përgradën nënkomisar dhe lart
3	Këmisha me mëngë të gjata	Copë	2	4	-	-	-	-	Opsion vetëm përgradën nënkomisar dhe lart
4	Kravatë	Copë	1	4	-	-	-	-	Opsion vetëm përgradën nënkomisar dhe lart
5	Këpuçë gjysma	palë	1	4	-	-	-	-	Opsion vetëm përgradën nënkomisar dhe lart
VII	Uniforma Sportive								
1	Kostum sportiv dimëror (nuta bluzë dimërore)	komplet	-	-	1	1	1	1	
2	Kostum sportiv verore (1 palë pantallona të shkurtra, 1 bluzë)	komplet	-	-	1	1	1	1	
3	Këpuçë atletike	palë	-	-	1	1	1	1	
VII I	Norme konsum personal								
1	Peshqirë të vegjël	Copë	-	-	2	1	2	1	
2	Peshqirë të mëdhenj	Copë	-	-	1	1	1	1	
3	Shapka	palë	-	-	1	1	1	1	
4	Solucion (shampo)femra	gr	-	-	500	muaj	500	muaj	
5	Solucion (shampo)meshkuj	gr	-	-	300	muaj	300	muaj	
6	Sapun tualeti	gr	-	-	300	muaj	300	muaj	

SEKSIONI VII

Nr.	Emertimi i artikujve të uniformes		STRUKTURAT ME VESHJE CIVILE					
			Nj/m	Policia Kriminale		Strukturat Mbështetëse dhe të tjera me grade policore		Shenime
				Sasia	Afati vite	Sasia	Afati vite	
I	Uniforma baze në detyrë							
1	Kostum uniforme Femra / Meshkuj (1 Xhakete, 2 pantallona, 2 kapele)	kompl	1	6	1	6		
2	Këmishë bojëqelli me mëngë të gjata femra/meshkuj	copë	1	6	1	6		
3	Kravatë blu uniforme	copë	1	6	1	6		
4	Rrip pantalloni	copë	1	6	1	6		
5	Jelek multifunksional	copë	1	6	-	-		
III	UNIFORMA për stervitje e shërbime							
1	Kostum doku stervitje (Xhakete, pantallona+2 kapele tip sport)	komplet	1	6	-	-		
2	Këmishë doku (blu) me mëngë të shkurta	copë	1	6	-	-		
3	Bluzë pambuku me jakë te rumbullakët m/ gjata	copë	2	6	-	-		
4	Bluzë pambuku me jakë te rumbullakët m/ shkurtra	copë	2	6	-	-		
d	Uniforma e Prezantimit të Policisë Kriminale							
1	Jelek prezantues policia e hetimit të krimit	copë	1	3	-	-		
2	Kapele doku prezantuese përhetimin e krimit	copë	1	3	-	-		
3	Maske operacionale	copë	2	3	-	-		
V	Uniforma ceremoniale							
1	Këmishë ceremoniale, femra/meshkuj	copë	2	6	2	6		
2	Kordonë ceremonial supi	copë	1	6	1	6		
3	Kordonë ceremoniali kapele	copë	1	6	1	6		
VI	Gradat, stema, shenjat							
1	Grada spaleti shërbimi	palë	1	4	-	-		
2	Gradat spaleti CEREMONIALE	palë	1	6	1	6		
3	Gradat gjoksi	copë	1	4	-	-		
4	Stema e Policisë së Shtetit	copë	2	4	1	6		
5	Shenja e krahut sipas shërbimit	copë	2	4	1	6		
6	Shenje Mbiemri	copë	1	4	1	6		
7	Shenjë numër identifikimi (RMIS)	copë	1	4	1	6		
VII	Këpuçë							
1	Këpuçë taktike dimërore	palë	1	6	-	-		
VIII	Veshja Civile e cila konvertohet në vlerë monetare							
1	Palto/xhup	Copë	1	2	1	2		
2	Kostum civil (Xhakete, pantallona)	komplet	1	2	1	2		



3	Këmisha me mëngë të gjata	Copë	2	1	2	1	
4	Këmisha me mëngë të shkurtra	Copë	2	1	2	1	
5	Kravatë	Copë	1	2	1	2	
6	Këpuçë gjysma	palë	1	1	1	1	

SEKSIONI VIII

Norma e veshjeve për punonjës të administratës					
Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Afati vite	Shënime
I	Uniforme civile për punonjësit në zyrat e pritjes së qytetarëve				
1	Kostum civil për femra/meshkuj (xhakete, pantallona)	komplet	1	1	
2	Fund për femra	copë	1	1	Opsion për femra
3	Kravatë	Copë	2	2	
4	Shall për femra	copë	2	2	Opsion për femra
5	Këmishë me mëngë të gjata për Femra/meshkuj	copë	3	1	
6	Këmishë me mëngë të shkurtra për Femra/ meshkuj	copë	3	1	

UDHËZIM

Nr. 17, datë 26.5.2025

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 21, DATË 15.10.2021,
“PËR KRITERET DHE PROCEDURAT
PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË
DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE,
GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE
AKADEMIKË, TË LËSHUARA NGA
INSTITUCIONE TË HUAJA TË ARSIMIT
TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË
TJERA TË AUTORIZUARA”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 6, të nenit 92, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe urdhrit nr. 113, datë 26.3.2024, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj”, i ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 21, datë 15.10.2021, “Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

a) Në fund të shkronjës “b”, të pikës 5, të kreut I, bëhet shtesa si më poshtë:

“... me përjashtim të diplomave/ certifikatave profesionale, diplomave, gradave shkencore të lëshuara nga institucione të arsimit të lartë të vendeve BE-së, SHBA-së, Britanisë së Madhe, Kanada, Japoni, Norvegji, Izrael, Zvicër, Islandë, Australi dhe Turqi.”.

b) Paragrafi i dytë i shkronjës “a” të pikës 1, të kreut III, ndryshon si më poshtë:

“Përjashtimisht, procedura përfundon brenda 5 ditëve pune nga data e aplikimit, për diploma/ certifikata profesionale të të gjitha formave të studimit të fituara në vendet e BE-së dhe SHBA-së, Britani e Madhe, Kanada, Japoni, Norvegji, Izrael, Zvicër, Islandë, Australi, si dhe Turqi, në rast se diploma/ certifikata profesionale dhe suplementi ose lista e notave të saj janë të pajisura me vulë apostile. Në rastet kur QSHA-ja evidenton parregullsi/ mangësi në dokumentacionin e paraqitur, mund të nisë procesin e verifikimit të tij, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

c) Në fund të fjalisë në shkronjën “a” të pikës 2, të kreut III, shtohen fjalët si më poshtë:

“... me përjashtim të programeve të studimit të përfunduara në institucionet e arsimit të lartë të vendeve BE-së, SHBA-së, Britanisë së Madhe, Kanada, Japoni, Norvegji, Izrael, Zvicër, Islandë, Australi dhe Turqi.”.

d) Shtojca nr. 3, zëvendësohet me shtojcën nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe komisionet përkatëse..

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT

Ana Kapaj

Faqe | 14203



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Shtojca nr. 3

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE**

Nr. _____ prot., Nr. _____ Regjistri Tiranë më _____._____

VËRTETIM NJOHJE DHE NJËSIMI

Vërtetohet njohja e diplomës/certifikatës së Z/Znj. _____ (emër atësi,mbiemër),
lëshuar nga _____ (institucioni që ka lëshuar diplomën/certifikatën), _____ (shteti),
më datë _____ (data e lëshimit të diplomës/certifikatës), me program _____ vjeçar
(kohëzgjatja e programit të studimit, _____ ECTS (numri i krediteve të fituara në rast kur këto
disponohen), me formë studimi _____ në (emërtimi i programit të studimit).

Kjo diplomë/certifikatë njehsohet si _____ në Republikën e Shqipërisë.

Ky vërtetim është i vlefshëm, i shoqëruar me diplomën/ certifikatën e njohur dhe njësuar.

Drejtor i Përgjithshëm

UDHËZIM**Nr. 2, datë 21.5.2025****PËR MIRATIMIN E FORMATIT QË DO
TË PËRDORET PËR RAPORTIMIN
VJETOR PËR VLERËSIMIN E CILËSISË
SË AJRIT NË MJEDIS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Miratimin e formatit që do të përdoret nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për raportimin vjetor për vlerësimin e cilësisë së ajrit në mjedis, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur dhe që është pjesë e këtij udhëzimi.

2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi

SHTOJCA 1**FORMATI I RAPORTIT VJETOR MBI
VLERËSIMIN E CILËSISË SË AJRIT
NË MJEDIS****PËRMBLEDHJE**

Formati i raportit vjetor mbi cilësinë e ajrit në mjedis mbështetet në dispozitat e ligjit nr. 162, datë 4.12.2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar, dhe VKM-në nr. 352, datë 29.4.2015, “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të”, ku sanksionohet detyrimi për të raportuar mbi vlerësimin e cilësisë së ajrit në mjedis në territorin e Republikës së Shqipërisë, mbi rrjetin e monitorimit, stacionet dhe matjet e grumbulluara për vlerësimin e cilësisë së ajrit.

Raportet vjetore bazohen në të dhënat e rrjetit të monitorimit kombëtar dhe lokal të territorit të Republikës së Shqipërisë.

Vlerësimi dhe menaxhimi i cilësisë së ajrit në mjedis është një nga çështjet kryesore, në fokus të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), e përcaktuar në ligjin nr. 162/2014. AKM-ja është një institucion publik qendror në Republikën e



Shqipërisë, i cili është në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM).

AKM-ja, në kuadër të kompetencave të saj, duhet të sigurojë kontrollin dhe monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes së cilësisë së ajrit në mjedis, në përputhje me kuadrin ligjor shqiptar.

Raporti vjetor duhet të përmbajë informacion të detajuar për të gjitha rastet, kur nivelet e ndotësve kanë kapërcyer vlerat kufi, ose ato të synuara, nivelet kritike, objektivat afatgjatë, pragjet e informacionit dhe pragjet e alarmit.

Ky informacion duhet të shoqërohet me një vlerësim përmbledhës të efekteve si rezultat i këtyre gjetjeve.

Informacioni i detajuar duhet të përfshijë edhe listën e zonave dhe aglomerateve (në raportin e parë), apo ndryshimet që u janë bërë atyre (nga raporti i dytë e në vijim);

Raporti duhet të përmbajë listën e zonave, aglomerateve dhe sipërfaqen e territorit ku ka pasur kapërcime shoqëruar me vlerat e përqendrimit të ndotësve në këto territore dhe, nëse është e rëndësishme, edhe datat e periudhat kur ato janë konstatuar.

Në raport të evidentohet popullsia e ekspozuar ndaj këtyre kapërcimeve, si dhe duhen trajtuar edhe arsyet pse ka ndodhur çdo kapërcim dhe burimet që kanë kontribuar.

Për çdo rast duhet të evidentohen edhe masat e marra për moskapërcimin e vlerave të synuara, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, referuar nenit 5 të ligjit nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar.

Raportet vjetore mund të përfshijnë edhe një vlerësim të niveleve të vlerësuara për të parë kontributet nga burimet natyrore dhe ripezullimin e lëndës pezull, si rezultat i shtrimit të rrugëve me rërë ose kripë, si dhe informacion të mëtejshëm dhe vlerësime për mbrojtjen e pyjeve.

KAPITULLI 1 PARATHËNIE – HYRJE

Në këtë kapitull duhet të paraqitet shkurtimisht rëndësia dhe roli i ajrit në mjedis, si një nga komponentët më të rëndësishëm mjedisor dhe që luan një rol të rëndësishëm në shëndetin e njeriut, në organizmat e gjallë, në biodiversitet dhe klimë.

Duhet të tregohen shkurtimisht ndotësit e ajrit në mjedis që janë përcaktuar si detyrim kombëtar për

vlerësim dhe monitorim, institucionet përgjegjëse, duke përfshirë institucionet dhe laboratorët që do të kryejnë procesin e monitorimit të ndotësve të veçantë në ajrin në mjedis.

Gjithashtu, duhet të përshkruhet shkurtimisht në një paragraf gjendja aktuale e cilësisë së ajrit në mjedis në nivel kombëtar, bazuar në vlerësimin e rrjetit të monitorimit vjetor.

Shkurtimisht të bëhet e ditur cilësia e ajrit në mjedis, sipas të dhënave të marra nga stacionet kombëtare dhe lokale të monitorimit të cilësisë së ajrit, duke paraqitur vlerat mesatare vjetore të përqendrimit të parametrave të gjetur gjatë monitorimit, të cilat rezultojnë mbi vlerat e lejuara. Nëse ka informacion për zonat ndërkufitare të përshkruhet në mënyrë të përmbledhur.

Të jepet shkurtimisht vlerësimi i cilësisë së ajrit në mjedis dhe klasifikimi i kategorive përkatëse të cilësisë së ajrit në mjedis në Republikën e Shqipërisë.

Të paraqiten shkurtimisht kushtet klimatike të vendit, bazuar në të dhëna që sigurohen nga dokumentet zyrtare në fushën e mjedisit apo dokumente të tjera në vend.

Të paraqiten marrëveshjet kryesore të ratifikuara të vendit tonë ose konventat në të cilat vendi ynë është anëtar, si CLRTAP etj.

Së fundi, të përshkruhet roli dhe angazhimi i qeverisë së Republikës së Shqipërisë në çështjet e promovimit dhe të mbrojtjes së shëndetit dhe mjedisit, si dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar.

KAPITULLI 2 KRITERET E VLERËSIMIT TË CILËSISË SË AJRIT

Kriteret e vlerësimit të cilësisë së ajrit janë vendosur për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis, mjedisit, klimës, vegjetacionit dhe shëndetit të njeriut.

Në këtë kapitull duhet të paraqiten vlerat maksimale të lejuara, kriteret kombëtare të pranueshme të vlerësimit të cilësisë së ajrit në mjedis, të specifikuar dhe të rekomanduara në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë, për mbrojtjen e vegjetacionit dhe shëndetit të njeriut.

Vlerat kufitare të ndotësve të ajrit në mjedis, sipas legjislacionit kombëtar për kushtet e monitorimit dhe kërkesat për cilësinë e ajrit duhet të paraqiten në



trajtë tabelle, ku për çdo ndotës të ajrit duhet të jepet: i. periudha mesatare; ii. vlera e pragut; iii. numri maksimal i tejkalimeve të lejuara në vit kalendarik; iv. vlera e tolerancës (vlerën e pragut + kufirin e tolerancës); v. pragu i ulët i vlerësimit; vi. pragu i sipërm i vlerësimit; vii. efektet në njerëz; dhe viii. efektet në bimësi.

2.1. Projektimi i rrjetit të monitorimit të ajrit në mjedis

Në këtë paragraf duhet të paraqitet projektimi i rrjetit kombëtar të monitorimit të cilësisë së ajrit në mjedis, i cili duhet të jetë gjithëpërfshirës. Ky rrjet i stacioneve të monitorimit duhet të jetë përfaqësues për të matur cilësinë e ajrit në zonat e banuara, zonat industriale, zonat me trafik të lartë, zonat e mbrojtura dhe zonat ndërkufitare, bazuar në ndarjen ideale territoriale të Republikës së Shqipërisë, në zona dhe aglomerate.

Duhet që të përcaktohet dhe të tregohet vendndodhja e rrjetit (koordinatat gjeografike) të stacioneve monitoruese dhe i pikave matëse për monitorimin e cilësisë së ajrit në mjedis, si dhe të paraqitet shpërndarja hapësinore e tyre.

Për çdo stacion monitorimi duhet kujdesur që të merren të dhënat e kushteve atmosferike dhe meteorologjike.

Të gjitha të dhënat meteorologjike të stacioneve të monitorimit duhet që të paraqiten dhe të përpunohen nëpërmjet një programi kompjuterik (*software*) të përshtatshëm në kohë reale.

2.2. Raportimi i të dhënave

Raporti vjetor të përfshijë të dhënat e dorëzuara në AKM nga institucionet që kryejnë matje dhe marrin pjesë në monitorimin e cilësisë së ajrit në nivel kombëtar dhe lokal. Pjesë përbërëse e këtij raporti duhet të jetë vlerësimi i cilësisë së ajrit sipas zonave dhe aglomerateve, në përputhje me legjislacionin.

Në këtë paragraf duhet të përshkruhen metodat dhe teknikat matëse të përdorura për analizimin e secilit ndotës në monitorim. Teknikat kryesore të përdorura për analizimin e ndotësve të mostrave të ajrit në mjedis mund të jenë: automatike, gjysmëautomatike dhe manuale. (Teknikat e matjeve alternative mund të kryhen, por nuk janë të besueshme për paraqitjen e të dhënave të marra në raportin e monitorimit kombëtar të cilësisë së ajrit në mjedis. *Mund të përdoren përurvejim.*)

Në këtë paragraf duhet të jepen dhe raportohen të dhënat e vlefshme të grumbulluara gjatë

monitorimit të ndotësve të ajrit në mjedis, të cilat duhet të paraqiten në formën e tabelave, grafikëve dhe shpërndarjes hapësinore.

Bazuar në legjislacionin kombëtar, modeli i tabelës së paraqitjes për raportimin vjetor të të dhënave të vlefshme të arritura, të grumbulluara nga monitorimi vjetor i çdo ndotësi të ajrit në mjedis duhet të përmbajë: i. zonat dhe aglomeratet; ii. stacionet e mostrimit; iii. indeksin e cilësisë së ajrit (AQI); iv. vlerat e përqendrimit vjetor të gjetura; dhe v. numrin e ditëve që janë tejkaluar vlerat e kriterëve të pranueshme të përcaktuara në kapitullin II.

KAPITULLI 3

VLERËSIMI I CILËSISË SË AJRIT

Vlerësimi i cilësisë së ajrit, bazuar në përqendrime vjetore të ndotësve të gjetur në ajrin në mjedis, kryhet duke zbatuar kriteret e vlerësimit, në përputhje me legjislacionin kombëtar për kushtet e monitorimit dhe kërkesat për cilësinë e ajrit, të përcaktuara në kapitullin II të këtij udhëzimi.

Duhet që të krahasohen vlerat mesatare vjetore të arritura nga procesi i kryer i monitorimit vjetor të ndotësve të ajrit në mjedis me vlerat kufitare të parametrave për mbrojtjen e shëndetit të njeriut, sipas kriterëve kombëtarë të pranueshme për kërkesat e cilësisë së ajrit dhe duhet të paraqiten në formë tabelare dhe grafike.

Pjesë përbërëse e këtij raporti duhet të jetë vlerësimi i cilësisë së ajrit sipas zonave dhe aglomerateve në përputhje me legjislacionin. Rezultatet e arritura të paraqiten në formë tabelare, grafike dhe sipas shpërndarjes hapësinore.

3.1. Kategoritë e cilësisë së ajrit

Rezultatet përfundimtare të monitorimit të cilësisë së ajrit në mjedis, të grumbulluara dhe të përpunuara statistikisht nga AKM-ja, janë bazë për miratimin e rregullores për përcaktimin e kategorive të cilësisë së ajrit në mjedis, e ndarë kjo sipas zonave dhe aglomerateve të territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në këtë nënkapitull duhet të paraqitet klasifikimi i kategorive të cilësisë së ajrit në mjedis për çdo vit kalendarik, që përkon me periudhën vjetore të procesit të monitorimit. Kategoritë e cilësisë së ajrit klasifikohen dhe përcaktohen në bazë të përqendrimeve totale dhe përmbajtjes vjetore të ndotësve të pranishëm në ajrin e mjedisit, të cilat



përfaqësojnë vlerësimin zyrtar të cilësisë së ajrit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Të paraqiten në trajtë tabelare vlerat e indekseve të cilësisë së ajrit (AQI) dhe përqendrimit korresponduese të ndotësve atmosferikë në monitorim, bazuar në legjislacionin kombëtar. Çdo kategori duhet të korrespondojë me një nivel të ndryshëm të shqetësimit shëndetësor dhe, gjithashtu, me një ngjyrë specifike.

3.2. Të dhënat e monitorimit të cilësisë së ajrit në vite

Në këtë nënkapitull duhet të paraqiten të dhënat e vlefshme të marra nga zbatimi i teknikave të matjeve sipas referencave, të realizuara gjatë procesit të monitorimit, të cilat duhet të përdoren për të vlerësuar cilësinë e ajrit në mjedis.

Të paraqitet në trajtë tabelare vlerësimi i cilësisë së ajrit bazuar në kategoritë e cilësisë së ajrit të përcaktuara për çdo vit monitorimi. Tabela duhet të përmbajë: i. zonat dhe aglomerate; ii. emërtimin e stacioneve të mostrimit; dhe iii. vlerën vjetore të përqendrimit të çdo ndotësi respektiv në monitorim.

Bazuar në të dhënat e vlefshme të arritura nga monitorimi i cilësisë së ajrit të kryer në vite dhe në kategorizimin e cilësisë së ajrit në vitet respektive të monitorimit, duhet të paraqitet në formë tabelare tendenca (*trendi*) e cilësisë së ajrit sipas zonave, aglomerateve, qyteteve dhe popullsisë së ekspozuar ndaj ndotësve të pranishëm në ajrin në mjedis gjatë kësaj periudhe. Të paraqitet shpërndarja hapësinore e rrjetit të stacioneve dhe pikat matëse për monitorimin e cilësisë së ajrit, rezultatet e të cilave përdoren për të vlerësuar cilësinë e ajrit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Duhet që rezultatet përfundimtare të monitorimit të kryer të jenë të disponueshme për publikun në faqen e AKM-së.

KAPITULLI 4

BURIMET E NDOTJES SË AJRIT NË MJEDIS NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

AKM-ja harton dhe menaxhon Regjistrin Kombëtar të Burimeve të Ndotjes së Ajrit. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për hartimin e raportit kombëtar të inventarit të shkarkimeve të marra për çdo vit, bazohet në metodologjinë e dhënë në udhëzues dhe Konventën Ndërkombëtare për Inventarin e Shkarkimit të Ndotësve të Ajrit.

Në këtë kapitull duhet që për çdo ndotës në monitorim, të paraqitet klasifikimi i burimeve sipas sektorëve kryesor të shkarkimit të ndotjeve dhe kontributi i secilit burim specifik të ndotjes në ajrin në mjedis, duke u bazuar në inventarin kombëtar të regjistrit të ndotjeve të ajrit.

Bazuar në të dhënat e dorëzuara në Regjistrin Kombëtar të Burimeve të Ndotjes për çdo vit kalendarik kryhet analiza e shkarkimeve të substancave ndotëse.

Kontributi i sektorëve të ndryshëm në shkarkimet totale vjetore të ndotësve në monitorim, në Republikën e Shqipërisë të paraqitet në formë tabelare dhe grafike.

Të paraqitet shpërndarja hapësinore e sasisë totale të shkarkimeve vjetore për çdo ndotës në monitorim.

KAPITULLI 5

GJENDJA E CILËSISË SË AJRIT

Në këtë kapitull duhet të paraqitet gjendja aktuale e ajrit në mjedis gjatë periudhës së monitorimit të kryer, bazuar në vlerat e vlefshme të arritura për çdo ndotës të matur në ajrin në mjedis.

Në bazë të kërkesës kombëtare për monitorimin e cilësisë së ajrit në mjedis dhe kushteve objektive të vendit, duhet të përcaktohet nga autoritetet lista e ndotësve që i nënshtrohen monitorimit vjetor.

Për çdo ndotës ajri të monitoruar, të listuar në paragrafët e mëposhtme (paragrafët 5.1–5.7), duhet të kryhet analiza e rezultateve të arritura, ku të përshkruhen vlerat e vlefshme të gjetura, vlerat maksimale të lejuara, kriteret e pranueshme të ndotësit përkatës, burimet kryesore dhe efektet negative që sjell prania e tij mbi kriteret e pranueshme kombëtare.

Paraqitja statistikore e përqendrimit total të ndotësve të ajrit në mjedis të gjetur, si dhe të gjitha rezultatet përfundimtare të vlefshme të arritura gjatë periudhës së monitorimit të kryer, duhet të jepen në formë tabelare dhe grafike për çdo ndotës të matur të dhënë në paragrafët 5.1–5.7.

Së fundi, në raport duhet të paraqitet shpërndarja hapësinore (në formatin GIS) e shkarkimeve totale vjetore për secilin ndotës të monitoruar e të listuar në paragrafët 5.1–5.7.

5.1 Dyoksidi i squfurit (SO₂)

Në këtë paragraf duhet të jepet paraqitja statistikore e totalit vjetor të SO₂ të gjetur gjatë



periudhës së monitorimit të kryer. Të dhënat të paraqiten në formë tabelare, grafike dhe nëpërmjet shpërndarjes hapësinore.

5.2 Dyoksidi i azotit (NO₂)

Paraqitja statistikore e totalit vjetor të NO₂ të gjetur gjatë periudhës së monitorimit të kryer të jepet në formë tabelare, grafike dhe nëpërmjet shpërndarjes hapësinore.

5.3 Grimcat e pluhurit PM 10 ose grimcat në suspension PM10.

Paraqitja statistikore e totalit vjetor të PM10 në aerosole, të arritur gjatë periudhës së monitorimit të kryer të jepet në formë tabelare, grafike dhe nëpërmjet shpërndarjes hapësinore.

Të jepet paraqitja grafike e numrit të ditëve që tejkalojnë kufirin e pragut të PM10 ditore sipas muajve gjatë periudhës së monitorimit.

Matjet gravimetrike të grimcave të pluhurit PM10

Krahas matjeve fikse në rrjetin kombëtar dhe lokal të monitorimit për cilësinë e ajrit, kryhen edhe matjet gravimetrike të grimcave të pluhurit në suspension të PM10.

Paraqitja statistikore e rezultateve të vlefshme të arritura të matjeve gravimetrike të grimcave në suspension të PM10, të arritur gjatë monitorimit vjetor, të jepet në formë tabelare, grafike dhe nëpërmjet shpërndarjes hapësinore.

Metalet e rënda në fraksionin PM10

Paraqitja statistikore e totalit vjetor mesatar të metaleve e rënda në fraksionin PM10 të grimcave të pluhurit dhe vlerat maksimale ditore të arritura gjatë periudhës së monitorimit të kryer, të jepet në formë tabelare, grafike dhe nëpërmjet shpërndarjes hapësinore.

Matjet e metaleve të rënda

Paraqitja statistikore e rezultateve të vlefshme të matjeve të metaleve të rënda, të arritura gjatë monitorimit vjetor të kryer të jepet në formë tabelare, grafike dhe nëpërmjet shpërndarjes hapësinore.

Benzo (a) pireni në fraksionin PM10 të grimcave të pluhurit ose grimcave në suspension

Paraqitja statistikore e rezultateve të vlefshme të benzo (a) pirenit në fraksionin PM10 të grimcave në suspension (përfaqësuesi i hidrokarbureve aromatike policiklike (PAH)), të arritura gjatë monitorimit vjetor të kryer të jepet në formë

tabelare, grafike dhe nëpërmjet shpërndarjes hapësinore.

Matjet e benzo (a) pirenit në fraksionin PM10 të grimcave të pluhurit në suspension

Paraqitja statistikore e rezultateve të vlefshme të matjeve të benzo (a) pirenit në fraksionin PM10 të grimcave (përfaqësues të hidrokarbureve aromatike policiklike (PAH)), të arritura gjatë monitorimit vjetor të kryer, të jepet në formë tabelare, grafike dhe nëpërmjet shpërndarjes hapësinore.

5.4 Grimcat e pluhurit me dimensione PM2,5

Paraqitja statistikore e vlerës mesatare vjetore të grimcave të ~~pezu~~ PM2,5 të gjetura gjatë monitorimit vjetor të kryer, të jepet në formë tabelare, grafike dhe nëpërmjet shpërndarjes hapësinore.

Matjet e grimcave me dimensione PM2.5

Paraqitja statistikore e rezultateve të vlefshme të matjeve të grimcave PM2,5 të arritura gjatë monitorimit vjetor të kryer të jepet në formë tabelare, grafike dhe nëpërmjet shpërndarjes hapësinore.

5.5 Monoksidi i karbonit (CO)

Paraqitja statistikore e rezultateve të vlefshme të monoksidit të karbonit, të arritura gjatë monitorimit vjetor të kryer të jepet në formë tabelare, grafike dhe nëpërmjet shpërndarjes hapësinore.

5.6 BTEX - Benzene, Toluene, Ethyl benzene dhe xylene; janë komponime me një unazë aromatike.

Paraqitja statistikore e rezultateve të vlefshme të BTEX-it, të arritura gjatë monitorimit vjetor të kryer të jepet në formë tabelare, grafike dhe nëpërmjet shpërndarjes hapësinore.

5.6.1. Benzeni (C₆H₆)

Paraqitja statistikore e rezultateve të vlefshme të benzenit, të arritura gjatë monitorimit vjetor të kryer të jepet në formë tabelare, grafike dhe nëpërmjet shpërndarjes hapësinore.

5.7 Ozoni tokësor (O₃)

Paraqitja statistikore e rezultateve të vlefshme të ozonit tokësor, të arritura gjatë monitorimit vjetor të kryer të jepet në formë tabelare, grafike dhe nëpërmjet shpërndarjes hapësinore.



KAPITULLI 6

PËRQENDRIMET E RREZIKSHME PËR
SHËNDETIN E NJERIUT DHE
PËRQENDRIMET E NJOFTUESHME PËR
PUBLIKUN

Bazuar në kriteret e pranueshme, për çdo ndotës të pranishëm në ajrin e mjedisit për të cilin publiku është i informuar, në këtë kapitull duhet të përcaktohen përqendrime të gjetura, të cilat në rast të veprimit të vazhdueshëm të tij mbi vlerat dhe kohëzgjatjen maksimale të lejuara, të specifikuar dhe të rekomanduara nga BE-ja dhe legjislacioni ynë kombëtar, paraqesin rrezik për shëndetin e njerëzve dhe të popullsisë.

Në këtë rast, të dhënat e arritura nga monitorimi i kryer për çdo ndotës, të paraqiten në trajtë tabelare grafike dhe të tregohet shpërndarja gjeografike.

KAPITULLI 7

VLERËSIMI I CILËSISË SË AJRIT

Vlerësimi i cilësisë së ajrit në mjedis është i parashikuar në legjislacionin kombëtar i cili duhet të zbatohet për çdo vit kalendarik. Vlerësimi i cilësisë së ajrit bazohet në tejkalimin e vlerave kufitare dhe tolerancës së përqendrimeve të ndotësve dhe është i vetmi vlerësim ligjor i përcaktuar dhe detyrues i shkallës së ndotjes së ajrit në mjedis.

Në këtë kapitull duhet të paraqitet vlerësimi i cilësisë së ajrit në mjedis në territorin e vendit, bazuar në të dhënat e vlefshme të monitorimit të ndotësve, të gjetura në vite dhe në zbatimin e kriterëve të vlerësimit, në përputhje me kushtet e monitorimit dhe kërkesat e cilësisë së ajrit në mjedis.

Të përshkruhet në lidhje me sistemin e monitorimit të kryer për ndotësit e ajrit të matur, për plotësimin e kushteve të sigurimit të cilësisë dhe përputhshmërinë me zbatimin e praktikave të rekomanduara nga BE-ja.

Bazuar në analizën e të dhënave të marra nga monitorimi i ndotësve në ajrin në mjedis të klasifikohen kategoritë e cilësisë së ajrit sipas zonave dhe aglomerateve respektive të Republikës së Shqipërisë. Të paraqiten kategoritë e cilësisë së ajrit në trajtë tabelare dhe shpërndarje hapësinore.

Bazuar në monitorimin e kryer për vlerësimin e cilësisë së ajrit në vite (3–5 vjetët e fundit), duhet të paraqitet tendenca (*trendi*) i cilësisë së ajrit sipas zonave, aglomerateve dhe qyteteve në Republikën e Shqipërisë.

Të paraqitet grafikisht cilësia e ajrit në mjedis në aglomerate sipas kategorive në vite.

7.1 Ekspozimi i popullsisë urbane ndaj grimcave të pluhurit PM10 dhe PM2,5

Shkurtimisht të paraqiten karakteristikat fiziko-kimike të grimcave PM10 dhe PM2,5, duke treguar efektet negative mjedisore dhe shëndetësore që mund të shkaktohen në shëndetin e popullatës së ekspozuar.

Duhet që të jepet paraqitja krahasuese e vlerës mesatare vjetore të përqendrimeve të PM10 dhe PM2,5, vlerat mesatare në sezonin e ftohtë dhe të ngrohtë të gjetura në stacionet e monitorimit të zgjedhura me kufirin e vlerës vjetore.

Në këtë paragraf duhet të paraqitet treguesi i llogaritur i ekspozimit të popullsisë urbane ndaj veprimit të grimcave të pluhurit PM10 dhe PM2,5 që tregon përqendrimin mesatar ndaj të cilit është i ekspozuar çdo banor i mjedisit urban në Republikën e Shqipërisë.

AKM-ja mund të kërkojë të dhëna nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë për të plotësuar raportin me statistikat e sëmundjeve të shkaktuara nga ndotja e ajrit në vend.

KAPITULLI 8

REZULTATET E MONITORIMIT TË
CILËSISË SË AJRIT ME METODA
MANUALE

Në këtë kapitull duhet që të paraqiten rezultatet e marra nga analiza e të dhënave vjetore të rrjetit të monitorimit, për parametrat e matur të cilësisë së ajrit. Ndër teknikat e ndryshme të matjeve ambientale, metodat manuale përdoren gjerësisht në vlerësimin e ndotësve ambientale gjatë monitorimit të mjedisit.

Rezultatet e arritura duhet të jenë të besueshme, ku procedurat e QA/QC-së janë të detyrueshme për zbatimin e teknikave manuale me kalibrim, në analizimin e ndotësve të caktuar në monitorim.

Duhet të përshkruhen shkurtimisht teknikat e përdorura për analizimin e mostrave përfaqësuese të ajrit në mjedis gjatë monitorimit. Prania e ndotësve në ajrin e mjedisit zakonisht është në rendin ppm; ppb dhe ppt, kështu që teknikat instrumentale të matjes duhet të jenë me ndjeshmëri shumë të lartë.

Të tregohet nëse kontrolli i cilësisë së matjeve të mostrave respektive nga zbatimi i teknikave instrumentale të matjeve manuale kryhet në



përputhje me standardin ISO 17025, apo me metoda të tjera referuese, bazuar në legjislacion.

KAPITULLI 9 PËRFUNDIME

Nga përpunimi statistikor i rezultateve të vlefshme të marra nga rrjetit i monitorimit kombëtar dhe lokal për vlerësimin e cilësisë së ajrit në mjedis, të paraqiten tejkalimet e vlerave kufitare për ndotësit e analizuar, nëse janë gjendur mbi vlerat maksimale të lejuara dhe të tregohen burimet respektive të tyre.

Bazuar në rezultatet e marra gjatë periudhës së monitorimit për çdo ndotës të matur, të tregohet cilësia e ajrit për çdo zonë, aglomerat dhe të bëhet vlerësimi i gjendjes së cilësisë së ajrit për gjithë territorin.

Të tregohet gjendja e cilësisë së ajrit në mjedis bazuar në matjet që janë kryer në rrjetin kombëtar dhe lokal të monitorimit.

Bazuar në përfundimet e arritura nga rezultatet e monitorimit, të paraqitet raporti i plotë dhe gjithëpërfshirës i vlerësimit të gjendjes aktuale të cilësisë së ajrit në mjedis në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Analiza e detajuar e gjendjes të cilësisë së ajrit në vend, bazuar në rezultatet e marra nga monitorimi i kryer (raporti vjetor i monitorimit të ajrit në mjedis), shërben për të hartuar dhe më pas për të miratuar planet e masave të marra për mbrojtjen dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis të territorit të Republikës së Shqipërisë.

URDHËR Nr. 189, datë 21.5.2025

PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË RAPORTIT TREVJEÇAR PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 162/2014, “PËR MBROJTJEN E CILËSISË SË AJRIT NË MJEDIS”, I NDRYSHUAR, DHE INFORMACIONIN QË DUHET TË PËRMBAJË KY RAPORT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 19, të ligjit nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formatit të raportit trevjeçar për zbatimin e ligjit nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar, dhe informacionin që duhet të përmbajë ky raport, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet drejtoria përgjegjëse për cilësinë e ajrit në ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi

SHTOJCA 1 FORMATI I RAPORTIT TREVJEÇAR PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 162/2014, “PËR MBROJTJEN E CILËSISË SË AJRIT NË MJEDIS”, I NDRYSHUAR, DHE INFORMACIONIN QË DUHET TË PËRMBAJË KY RAPORT

Ky format përcakton rregullat për përgatitjen e raportit 3-vjeçar për zbatimin e ligjit nr. 162, datë 4.12.2014, “Për Mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar.

PËRMBLEDHJE

Raporti 3-vjeçar, duhet të përfshijë informacion mbi rrjetin e monitorimit kombëtar dhe lokal në territorin e Republikës së Shqipërisë, cilësinë e ajrit në mjedis, masat e ndërmarra në kuadër të monitorimit, inspektimit, bashkëpunimit dhe koordinimit ndër institucional në nivel qendror dhe lokal, përgatitjen dhe zbatimin e planeve kombëtare dhe lokale për cilësinë e ajrit në mjedis.

Raporti 3-vjeçar bazohet kryesisht në informacionin dhe të dhënat e raporteve 1-vjeçare që Agjencia Kombëtare e Mjedisit përgatit në zbatim të nenit 11 të ligjit 162/2014, si dhe në informacione të tjera shtesë, që sigurohen nga koordinimi me institucionet përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi.

KAPITULLI 1 PARATHËNIE

Në këtë kapitull duhet të paraqitet shkurtimisht rëndësia dhe roli i cilësisë së ajrit në mjedis, si një nga

komponentët më të rëndësishëm mjedisorë dhe që luan një rol të rëndësishëm në shëndetin e njeriut, në organizmat e gjallë, në biodiversitet dhe klimë.

Duhet të tregohen shkurtimisht ndotësit e ajrit në mjedis që janë përcaktuar si detyrim kombëtar për vlerësim dhe monitorim, institucionet përgjegjëse, duke përfshirë institucionet dhe laboratorët që kryejnë procesin e monitorimit të ndotësve të veçantë në ajrin në mjedis.

Gjithashtu, duhet të përshkruhet shkurtimisht në një paragraf gjendja e cilësisë së ajrit në mjedis në nivel kombëtar për periudhën 3-vjeçare të raportimit, bazuar në vlerësimet e bëra nga AKM-ja (monitorimi dhe inventari shkarkimeve).

Të paraqitet në mënyrë të përmblendhur gjendja e cilësisë së ajrit në mjedis, sipas të dhënave të marra nga raportet vjetore që përgatiten nga AKM-ja.

Të jepet shkurtimisht vlerësimi i cilësisë së ajrit në mjedis dhe klasifikimi i kategorive përkatëse të cilësisë së ajrit në mjedis në Republikën e Shqipërisë.

Së fundi, mund të përshkruhet roli dhe masat e marra nga qeveria e Republikës së Shqipërisë në kuadër të promovimit dhe mbrojtjes së shëndetit dhe mjedisit, si dhe forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar.

KAPITULLI 2

VLERËSIMI I CILËSISË SË AJRIT PËR PERIUDHËN 3-VJEÇARE (viti xxxx–viti yyyy)

Vlerësimi i cilësisë së ajrit për periudhën 3-vjeçare bazohet në analizën përmblledhëse të përqendrimeve vjetore të ndotësve të gjetur në ajrin në mjedis, duke zbatuar kriteret e vlerësimit në përputhje me legjislacionin kombëtar për kushtet e monitorimit dhe kërkesat për cilësinë e ajrit.

Në këtë pjesë të raportit, krahasohen vlerat mesatare vjetore të arritura nga procesi i monitorimit gjatë periudhës 3-vjeçare të ndotësve të ajrit në mjedis me vlerat kufi të parametrave për mbrojtjen e shëndetit të njeriut, sipas kriterëve kombëtarë të pranueshme për kërkesat e cilësisë së ajrit, të cilat duhet të paraqiten edhe në formë tabelare dhe grafike.

Pjesë përbërëse e këtij raporti duhet të jetë dhe një përmblledhje 3-vjeçare mbi vlerësimin e cilësisë së ajrit sipas zonave dhe aglomerateve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këto të dhëna të paraqiten në formë tabelare, grafike duke përfshirë edhe të dhëna sipas shpërndarjes hapësinore.

2.1. Kategoritë e cilësisë së ajrit

Rezultatet e monitorimit vjetor të cilësisë së ajrit në mjedis, të grumbulluara dhe të përpunuara statistikisht çdo vit nga AKM-ja, janë bazë për përcaktimin e kategorive të cilësisë së ajrit në mjedis për periudhën 3-vjeçare, e ndarë kjo sipas zonave dhe aglomerateve të territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në këtë nënkapitull duhet të paraqitet në mënyrë të përqendruar klasifikimi i kategorive të cilësisë së ajrit në mjedis për çdo vit kalendarik, që përkon me periudhën 3-vjeçare të raportimit. Kategoritë e cilësisë së ajrit klasifikohen dhe përcaktohen në bazë të përqendrimeve totale dhe përmbajtjes vjetore të ndotësve të pranishëm në ajrin e mjedisit, të cilat përfaqësojnë vlerësimin zyrtar të cilësisë së ajrit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Për çdo vit kalendarik, të paraqiten në formë tabelare, vlerat e indekseve të cilësisë së ajrit (AQI) dhe përqendrimet korresponduese të ndotësve atmosferikë në monitorim, bazuar në legjislacionin kombëtar. Çdo kategori duhet të korrespondojë me një nivel të ndryshëm të ndikimit në shëndet dhe të paraqitet me një ngjyrë të veçantë.

2.2. Të dhënat e monitorimit të cilësisë së ajrit gjatë periudhës 3-vjeçare

Në këtë nënkapitull paraqiten të dhënat e vlefshme të marra nga zbatimi i teknikave të matjeve, sipas referencave, të realizuara gjatë procesit të monitorimit për periudhën 3-vjeçare, të cilat përdoren për të vlerësuar cilësinë e ajrit në mjedis.

Të paraqitet në formë tabelare vlerësimi i cilësisë së ajrit bazuar në kategoritë e cilësisë së ajrit të përcaktuara për çdo vit monitorimi. Tabela duhet të përmbajë: i. zonat dhe aglomerate; ii. emërtimin e stacioneve të matjes; dhe iii. vlerën vjetore të përqendrimit të çdo ndotësi përkatës në monitorim.

Bazuar në të dhënat e vlefshme të grumbulluara nga monitorimi i cilësisë së ajrit të kryer në vite dhe në kategorizimin e cilësisë së ajrit në vitet përkatëse të monitorimit që përfshihen në periudhën 3-vjeçare të raportimit, duhet të paraqitet në formë tabelare tendenca (*trendi*) e cilësisë së ajrit, sipas zonave, aglomerateve, qyteteve dhe popullsisë së ekspozuar ndaj ndotësve të pranishëm në ajër gjatë kësaj periudhe. Të paraqitet shpërndarja hapësinore e rrjetit të stacioneve dhe pikat matëse për monitorimin e cilësisë së ajrit, rezultatet e të cilave përdoren për të vlerësuar cilësinë e ajrit në territorin



e Republikës së Shqipërisë për periudhën 3-vjeçare të raportimit.

Paraqitja statistikore e përqendrimit total, të ndotësve të ajrit në mjedis të monitoruar gjatë periudhës kohore 3-vjeçare, si dhe të gjitha rezultatet përfundimtare të vlefshme të arritura gjatë periudhës së monitorimit të kryer, duhet të jepen në formë tabelare dhe grafike për çdo ndotës të matur të dhënë në raportimin vjetor për vlerësimin e cilësisë së ajrit në mjedis, që përgatitet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

2.3. Ekspozimi i popullsisë urbane ndaj grimcave të pluhurit PM10 dhe PM2.5

Shkurtimisht të paraqiten karakteristikat fiziko-kimike të grimcave PM10 dhe PM2.5, duke treguar efektet negative mjedisore dhe shëndetësore që mund të shkaktohen në shëndetin e popullatës së ekspozuar.

Në këtë pjesë të raportit, për periudhën 3-vjeçare të raportimit, jepet paraqitja krahasuese e vlerave mesatare vjetore të përqendrimeve të PM10 dhe PM2.5, vlerat mesatare në sezonin e ftohtë dhe të ngrohtë të regjistruara nga stacionet e monitorimit me kufirin e vlerës vjetore.

Në këtë nënkapitull duhet të paraqitet treguesi i llogaritur i ekspozimit të popullsisë urbane ndaj veprimit të grimcave të pluhurit PM10 dhe PM2.5, që tregon përqendrimin mesatar ndaj të cilit është i ekspozuar çdo banor i mjedisit urban në Republikën e Shqipërisë.

KAPITULLI 3

BURIMET E NDOTJES SË AJRIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË PËR PERIUDHËN 3-VJEÇARE

AKM-ja, në përputhje me dispozitat ligjore, harton dhe menaxhon regjistrin kombëtar të burimeve të ndotjes së ajrit. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për hartimin e raportit kombëtar të inventarit të shkarkimeve të marra për çdo vit, bazohet në metodologjinë e dhënë në udhëzues dhe Konventa ndërkombëtare për Inventarin e Shkarkimit të Ndotësve të Ajrit.

Të paraqiten shkurtimisht marrëveshjet kryesore të ratifikuara nga vendi ynë ose konventat në të cilat vendi ynë është anëtar, si CLRTAP etj., si dhe angazhimi institucioneve në vend për zbatimin dhe përmbushjen e detyrimeve dhe raportimeve që rrjedhin në kuadër të këtyre marrëveshjeve, bazuar

në sa më sipër në këtë kapitull të raportit, duhet që për çdo ndotës të monitoruar përgjatë periudhës 3-vjeçare të raportimit, të paraqitet klasifikimi i burimeve sipas sektorëve kryesorë të shkarkimit të ndotjeve dhe kontributi i secilit burim specifik të ndotjes në ajrin në mjedis, duke u bazuar në inventarin kombëtar të ndotjes së ajrit.

Bazuar në të dhënat e dorëzuara në Regjistrin Kombëtar të Burimeve të Ndotjes për çdo vit kalendarik kryhet analiza e shkarkimeve të substancave ndotëse.

Kontributi i sektorëve të ndryshëm në shkarkimet totale vjetore të ndotësve në monitorim, në Republikën e Shqipërisë të paraqitet në formë tabelare dhe grafike.

Të paraqitet shpërndarja hapësinore e sasisë totale të shkarkimeve vjetore për çdo ndotës në monitorim gjatë periudhës 3-vjeçare të raportimit.

KAPITULLI 4

REZULTATET E ZBATIMIT TË PLANEVE KOMBËTARE DHE LOKALE TË CILËSISË SË AJRIT

Të jepet informacion mbi përgatitjen dhe zbatimin e planeve kombëtare dhe lokale të cilësisë së ajrit gjatë periudhës 3-vjeçare të raportimit.

Të jepet informacion mbi masat e zbatuara gjatë periudhës 3-vjeçare të raportimit që kontribuojnë në mbrojtjen, përmirësimin e cilësisë së ajrit në vend.

KAPITULLI 5

REZULTATET E MONITORIMIT DHE INSPEKTIMEVE NGA INSTITUCIONET SIPAS FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË

Të paraqiten të dhënat e marra nga institucionet përgjegjëse për monitorimin dhe inspektimet e kryera gjatë periudhës 3-vjeçare, bazuar në fushën e përgjegjësisë institucionale, sipas legjislacionit për cilësinë e ajrit në mjedis.

Të jepet informacion mbi bashkëpunimet, koordinimet ndërinstitucionale në nivel qendror dhe lokal, gjatë periudhës 3-vjeçare të raportimit (viti x–viti y).

Të jepet informacion mbi bashkëpunime të tjera (shoqata mjedisore; të rinjtë etj.), që kanë ndodhur gjatë periudhës 3-vjeçare.



Të jepet informacion mbi bashkëpunimet rajonale dhe ndërkombëtare gjatë periudhës 3-vjeçare.

Të jepet informacion mbi projektet e zbatuara gjatë periudhës raportuese që kontribuojnë në cilësinë e ajrit.

Të jepet informacion mbi sfidat dhe hapat e mëtejshme për forcimin e monitorimit dhe kontrollit.

Nëse ndonjë nga të dhënat e cituara në kuadër të përgatitjes së raportit 3-vjeçar nuk mund të pasqyrohet në raport, jepen argumentet përkatëse.

KAPITULLI 6 PËRFUNDIME

Nga përpunimi statistikor i rezultateve të vlefshme të marra nga rrjeti i monitorimit kombëtar dhe lokal për vlerësimin e cilësisë së ajrit në mjedis gjatë periudhës 3-vjeçare të raportimit, paraqiten tejkallimet e vlerave kufitare për ndotësit e analizuar, nëse janë gjendur mbi vlerat maksimale të lejuara dhe të tregohen burimet përkatëse të tyre.

Bazuar në rezultatet e vjetore të monitorimit për çdo ndotës të matur, të tregohet cilësia e ajrit për çdo zonë, aglomerat dhe të bëhet vlerësimi i gjendjes së cilësisë së ajrit për gjithë territorin.

Të tregohet gjendja e cilësisë së ajrit në mjedis të gjetur, bazuar në matjet, që janë kryer në rrjetin kombëtar dhe lokal të monitorimit gjatë periudhës 3-vjeçare.

Analiza e cilësisë së ajrit në mjedis gjatë periudhës 3-vjeçare (bazuar në raportin vjetor të monitorimit të ajrit në mjedis dhe inventarin e shkarkimeve në ajër, si dhe masat e ndërmarra në vend apo për përmirësimin dhe mbrojtjen e cilësisë së ajrit), shërben për të hartuar, miratuar planet e masave që duhen ndërmarrë në vijim për mbrojtjen dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis në territorin e Republikës së Shqipërisë.

KËRKESË

Nr. 366/13, datë 28.5.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rikonstruksion i segmentit të parë të linjës 110 kV Ballsh–Memaliaj’”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit 39,232.50 (tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e tridhjetë e dy pikë pesëdhjetë) lekë.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Operatori i Sistemit të Transmetimit.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogarit, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasurinë e llojit “arë”, “ullishtë”, “pyll” dhe “kullotë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 39,232.50 (tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e tridhjetë e dy pikë pesëdhjetë) lekë.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI “RIKONSTRUKSION I SEGMENTIT TË PARË TË LINJËS 110 kV BALLSH–MEMALIAJ”

Nr. rendor	Nr. shtyllë	Pronari			Të dhëna kadastrale					Vlerësimet për shpronësim										Shënime	
		Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja Totale	Sipërfaqja e shtyllës (m²)	“Arë”		“Kullotë”			“Truall”			Vlera totale (lekë)		
1	1	Nuk ka informacion			Lavdan	2388	x			42.00			-			-			-	-	
2	2	Nuk ka informacion			Lavdan	2388	x			50.00						-			-	-	
3	3	Nuk ka informacion			Usojë	3689	33			38.00			-			-			-	-	
4	4	Nuk ka informacion			Usojë	3689	33			32.00									-	-	
5	5	Kimet	Haki	Veizaj	Usojë	3689	113	Ullishte	7400	38.00	38.00	123	4,674.00						-	4,674.00	
		Rauf	Islam	Çelaj																	
		Enver	Islam	Çelaj																	
		Tofik	Hekuran	Çelaj																	
		Yzedin	Tofik	Çelaj																	
		Bedri	Sabri	Çelaj																	
		Neim	Telo	Çelaj																	
		Qerem	Kasem	Hyka																	
		Servet	Sami	Shehaj																	
		Arben	Sami	Shehaj																	
		Dilaver	Veli	Shehaj																	
		Pajtim		Shehaj																	
		Bilbil	Cerçiz	Shehaj																	
		Nuri	Jonus	Shehaj																	
		Nuredin	Isa	Nuhaj																	
		Astrit	Zenel	Nuhaj																	
		Ridvan	Zenel	Nuhaj																	
		Ismail	Brahim	Nuhaj																	
		Sybi	Sami	Shehaj																	
		Bajram	Kadri	Kamaj																	
		Bari	Yzeir	Kamaj																	
		Xhevat	Asllan	Çelaj																	
		Ali	Asllan	Çelaj																	
		Feta	Sabri	Çelaj																	
		Astrit	Sabri	Çelaj																	
		Mynyr	Brahim	Nuhaj																	
		Arif	Telo	Çelaj																	
		Etem	Jaho	Nuhaj																	
		Bardhyl		Hyka																	
		Arif		Hyka																	
		Sherif	Shahin	Shehaj																	
		Hasan	Shahin	Shehaj																	
		Asqeri	Rauf	Sako																	
6	6	Nuk ka informacion			Usojë	3689	112			28.00			-					-	-		
7	7	Bashkim		Musaraj	Kash	2104	10/32	Arë	1814	56.00	56.00	123	6,888.00					-	6,888.00		
8		Agron		Musaraj	Kash	2104	10/34	Arë	3277	14.00	14.00	123	1,722.00					-	1,722.00		
9	8	Shtet			Kash	2104	58/21	Arë	1500	38.00	38.00		-					-	-		
10	9	Shtet			Kash	2104	100/6	Kullotë	3593	30.00	30.00		-					-	-		
11	10	Baço	Sadik	Dajlanaj	Kash	2104	93/16	Arë	2200	26.00	26.00	123	3,198.00					-	3,198.00		
		Beko	Petref	Dajlanaj																	
		Armir	Baço	Dajlanaj																	
		Arta	Baço	Yzbashi																	
		Behar	Baço	Dajlanaj																	
		Ylber	Baço	Dajlanaj																	
		Kujtim	Sadik	Dajlanaj																	



		Viko	Sadik	Xhemalaj															
		Arshin	Sadik	Dajlanaj															
		Violeta	Sadik	Hoxha															
12	11	Shtet			Kash	2104	89/4	Arë	4344	42.00	42.00		-		-		-	-	
13	12	Nuk ka informacion			Hekal	1945	136			26.00	26.00		-		-		-	-	
14	13	Tajar	Musa	Asllanaj	Hekal	1945	152/3	Kullotë	2650	26.00				26.00	111	2,886.00		-	2,886.00
		Barjam	Musa	Asllanaj															
15	14	Sajmir	Enver	Taraj	Hekal	1945	157/9	Arë	900	23.00	23.00	123	2,829.00		-		-	2,829.00	
		Manjola	Rrapo	Taraj															
16		Shtet			Hekal	1945	157/26	Arë	1441	3.00	3.00		-		-		-	-	
17		Shtet			Greshicë	1857	275	Rrugë	9451	22.00	22.00		-		-		-	-	
18	15	Bejaze		Abazi	Greshicë	1857	28/2	Ulli	31925	2.00	2.00	123	246.00					246.00	
		Ramadan	Novruz	Abazi															
		Tetem	Jashar	Abazi															
		Selman	Bekdash	Abazi															
		Muhamet	Raxhep	Abazi															
		Skender	Jashar	Abazi															
		Jashar	Bekdash	Abazi															
		Kujtim	Bajram	Abazi															
		Vladim	Bajram	Abazi															
		Nuri	Qerim	Abazi															
		Qemal	Qemal	Abazi															
		Muharrem	Jashar	Abazi															
		Qani	Fecorr	Abazi															
		Fatmir	Nuri	Abazi															
19	16	Shtet			Greshicë	1857	242	Ledh	2267	23.00	23.00		-		-		-	-	
Sokol		Hetem	Abazaj	Greshicë	1857	143/17	Arë	2145	23.00	23.00	123	2,829.00		-		-	2,829.00		
21	17	Shtet			Greshicë e Re	1858	148	Pyll	3096	50.00	50.00		-		-		-	-	
22		Shtet			Greshicë e Re	1858	524	Rrugë	4504	1.00	1.00		-		-		-	-	
23		Shtet			Greshicë e Re	1858	151/64	Ledh	160	5.50	5.50		-		-		-	-	
24		Melaize	Elmaz	Metaj	Greshicë e Re	1858	151/31	Arë	2900	31.50	31.50	123	3,874.50		-		-	3,874.50	
25	19	Shtet			Greshicë e Re	1858	526	Rrugë	3784	20.00	20.00		-		-		-	-	
26		Shtet			Greshicë e Re	1858	318/1	Pyll	33109	4.00	4.00		-		-		-	-	
27	20	Shtet			Greshicë e Re	1858	370	Pyll	28415	26.00	26.00		-		-		-	-	
28	21	Shtet			Greshicë e Re	1858	377	Kullotë	8597	38.00	38.00		-		-		-	-	
29	22	Shtet			Greshicë e Re	1858	382/34	Arë	5048	42.00	42.00		-		-		-	-	
30		Nuk ka informacion			Lavdan	2388	x			9.00			-		-		-	-	
31		Novruz	Haki	Barjamaj	Lavdan	2388	530/3	Arë	600	25.00	25.00	123	3,075.00		-		-	3,075.00	
32		Brahim	Haki	Barjamaj	Lavdan	2388	530/2	Arë	550	20.00	20.00	123	2,460.00		-		-	2,460.00	
33		Përparim	Haki	Barjamaj	Lavdan	2388	530/1	Arë	460	37.00	37.00	123	4,551.00		-		-	4,551.00	
34		Nuk ka informacion			Lavdan	2388	x			73.00				-		-	-	-	
35		Nuk ka informacion			Lavdan	2388	x			19.00							-	-	
36		Nuk ka informacion			Lavdan	2388	x			13.00			-		-		-	-	
SHUMA PARAPRAKE																		39,232.50	

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me vendimin nr. 2796-800, datë 26.9.2024, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Sokol Prendi me atësi Mark dhe amësi Mrikë, i datëlindjes 28.6.1970, lindur dhe banues në Rubik, Mirditë, duke caktuar si datë të shpallur si të zhdukur datën 30.6.1994.

KËRKESË

Shtetasja Marsela Troqe kërkon, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, shpalljen të zhdukur të shtetasit Elvis Troqe, me atësi Krenar dhe amësi Marsela, i datëlindjes 3.6.1994, lindur dhe banues në Vlorë, si dhe caktimin si kujdestar të pasurisë/pasurive të tij shtetasen Marsela Troqe.

KËRKUESE
Marsela Troqe

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 448 lekë

